REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT

MBI ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT

2023

TIRANË 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT
MBI ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT
2023

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE **2**

I. PLANIFIKIMI, REALIZIMI DHE AUDITIMI I BUXHETIT **9-12**

A. PLANIFIKIMI, REALIZIMI DHE AUDITIMI I TË ARDHURAVE **13-14**
1. Të ardhurat nga grantet 15
2. Të ardhurat tatimore 15-16
2.1 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat 16-17
2.1.1 Të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) 17-19
2.1.2 Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin 19-20
2.1.3 Të ardhura nga akcizat 20-21
2.1.4 Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale 21-22
2.1.5 Taksa nacionale dhe të tjera 22
2.1.6 Të ardhurat nga taksat doganore 22-23
2.2 Të ardhurat nga pushteti vendor **23-24**
2.3 Të ardhurat nga fondet speciale **24-25**
2.2.1 Kontributet e Sigurimeve shoqërore 25-26
2.2.2 Kontributet e Sigurimit shëndetësor 26
2.2.3 Fondi i kompensimit të pronarëve 26
3. Të ardhurat jotatimore 27

B. PLANIFIKIMI, REALIZIMI DHE AUDITIMI I SHPENZIMEVE **28-29**
1. Shpenzimet korrente 29-30
1.1 Shpenzimet për personelin 30-31
1.2 Shpenzimet për interesat 31-32
1.3 Shpenzimet operative mirëmbajtje 32
1.4 Subvencionet 32
1.5 Shpenzimet për fondet speciale 33-36
1.6 Shpenzimet për buxhetin vendor 36-38
1.7 Shpenzime të tjera 38
2. Shpenzimet kapitale 38-41
2.1 Fondi i rindërtimit 41-43
3. Fondi rezervë dhe kontigjenca 43-45
4. Risqet fiskale dhe Impakti buxhetor 45-54

C. DEFICITI BUXHETOR **55-56**

D. BORXHI PUBLIK: MENAXHIMI, RAPORTIMI DHE AUDITIMI I TIJ **57-60**

E. MBI KONTABILITETIN E SEKTORIT PUBLIK, SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE MENAXHIMIN FINANCIAR, SI DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM **61-70**

F. ANEKSE **71-84**
Aneksi a. Përmbledhje e rezultateve të auditimeve në fushën e buxhetit
1. Performanca fiskale e DPT dhe DPD 71-74
2. Auditimet në institucionet qendrore etj. 74-75
3. Auditimet në njësitë e vetëqeverisjes vendore 76-77
4. Auditimet e shoqërive publike dhe projekteve me investime të huaja 77-78
5. Auditimet e Teknologjisë së Informacionit 78
6. Auditimet e performancës 78-80
Aneksi b. Lista e auditimeve që kanë shërbyer për raportin e zbatimit të buxhetit **81-83**
Aneksi c. Përmbledhje e dëmit ekonomik dhe efektit financiar negativ për buxhetin 2023 **84**

Përmbledhje ekzekutive

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përgatitur dhe paraqet raportin "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2023" në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 164, pika 1, germat "a" dhe "b"; të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 10, pika 2 dhe neni 15 e 31; Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 62 e 63; ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 84/2022, datë 24.11.2022, "Për Buxhetin e vitit 2023", i ndryshuar.

Ky raport është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI), si: në Deklaratën e Limës, e cila është udhërrëfyesi i auditimit qeveritar, ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit në sektorin publik", ISSAI 4000 "Standardet e auditimit të përputhshmërisë", si dhe në parimet e standardet të tjera të auditimit të jashtëm të sektorit publik.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, me paraqitjen në Kuvend të "Raportit për zbatimin e buxhetit 2023", së bashku me konkluzionin përkatës përmbush detyrimin kushtetues e ligjor, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe afatin përkatës.

Raporti i KLSH-së për zbatimin e buxhetit të vitit 2023 është fokusuar në vlerësimin dhe shqyrtimin e Raportit të përgatitur nga Ministria e Financave "Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2023" dhe të raporteve të tjera që e shoqërojnë. Në këtë proces skanimi të treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar, Kontrolli i Lartë i Shtetit është bazuar kryesisht në auditimin e kryer në Ministrinë përgjegjëse për financat, si dhe në rezultatet e auditimeve që i përkasin aktivitetit ekonomiko-financiar të subjekteve për vitin 2023 dhe/ose vlerësimeve për këtë vit.

Për hartimin e raportit kanë shërbyer rezultatet e auditimeve për çështje të të ardhurave, shpenzimeve, detyrimeve të prapambetura, si dhe ato të lidhura me kontabilitetin, menaxhimin e financave publike etj., duke reflektuar shkallën më të lartë të zbatimit të standardeve profesionale ndërkombëtare të INTOSAI-t. Në këtë mënyrë, raporti përmbledh gjetjet kryesore në lidhje me çështjet e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të buxhetit, miradministrimit të fondeve publike, duke përfshirë dhe fondin rezervë e kontigjencën, borxhin publik, si dhe Kontrollin të Brendshëm Financiar Publik.

Konkluzioni mbi Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Vitit 2023

Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit konkluzionin për raportin e Këshillit të Ministrave për buxhetin e vitit të kaluar financiar, përpara se të miratohet nga Kuvendi, duke dhënë konkluzion për besueshmërinë e treguesve të të ardhurave, shpenzimeve, deficitit, borxhit publik etj., gjatë këtij viti.

Për dhënien e konkluzionit për raportin vjetor të zbatimit të buxhetit të konsoliduar, KLSH është bazuar në shqyrtimin e raporteve të KM, të përgatitura nga MF:

a) Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2023;
b) Mbi përdorimin e fondit rezervë të buxhetit të shtetit dhe kontigjencave gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2023;

c) Analiza e borxhit publik (viti 2023);
d) Raporti Vjetor i Përmbledhur "Performanca e Kontratave të Koncesionit dhe të Partneritetit Publik Privat -2023";
e) Raporti mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme të vitit 2023.

KLSH ka audituar përputhshmërinë e treguesve fiskal sipas buxhetit të konsoliduar, nëpërmjet auditimit të sistemeve qendrore të MF të tilla si: Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Thesarit, Borxhit Publik, Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik etj.; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe atë të Doganave; shpenzimet dhe të ardhurat e ISSH dhe të FSDKSH; si dhe të një numri të konsiderueshëm të institucioneve të tjera qendrore dhe enteve në varësi, institucioneve të pavarura, njësive të vetëqeverisjes vendore, shoqërive publike, projekte me financim të huaj etj., në total 101 auditime të ushtruar në 125 subjekte.

Në këtë kontekst, për hartimin e raportit kanë shërbyer edhe rezultatet kryesore të auditimeve financiare dhe/ose të përputhshmërisë, të teknologjisë së informacionit, të perfomancës, të ushtruar në institucione qendrore dhe ente të varësisë, institucione të pavarura, fonde speciale, njësi të vetëqeverisjes vendore, shoqëri publike, projekte me financime të huaj, etj.

Bazat e konkluzionit

Ne kemi audituar proceset dhe transaksionet brenda sistemit buxhetor nëse janë në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i detyrueshëm për zbatim për institucionet e audituara dhe kemi formuluar konkluzionin bazuar në shqyrtimin e raportit të konsoliduar për zbatimin e buxhetit të vitit 2023, raportit të menaxhimit të borxhit publik, përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës, performanca e kontratave koncesionare, përfshirë treguesit fiskal sipas buxhetit vjetor të konsoliduar, si dhe në raportet e auditimeve të kryera nga KLSH, në përputhje me kërkesat etike të përcaktuara në Parimin 130 të INTOSAI-t - Kodi i Etikës dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit(ISSAI). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona ligjore dhe profesionale në përputhje me këto kërkesa.

Objektivi ynë ka qenë vlerësimi i nivelit të zbatimit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme të parimeve dhe rregullave të menaxhimit të sistemit buxhetor, si transparenca, parashikueshmëria, gjithëpërfshirja, disiplina fiskale në përputhje me stabilitetin makroekonomik dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social, në të gjitha fazat e buxhetit: planifikimi, ekzekutimi, monitorimi dhe raportimi për vitin 2023.

Konkluzion mbi përputhshmërinë e buxhetit të vitit 2023

Ne besojmë se evidenca e auditimit e marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për konkluzionet tona të auditimit. Kriteret, gjetjet, dhe konkluzionet tona janë zhvilluar në mënyrë profesionale dhe të arsyetuar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, kombinimi i të cilave dhe me shqyrtimin raporteve që shoqërojnë zbatimin e buxhetit të vitit 2023, rezultojnë në përfundimin e përgjithshëm vijues:

Në konkluzionin tonë, me përjashtim të disa situatave të evidentuara në raportet përfundimtare të auditimeve individuale dhe në këtë raport të zbatimit të buxhetit, kontrollet e brendshme dhe

procedurat për hartimin, miratimin dhe ekzekutimin e Buxhetit janë përgjithësisht në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Përkatësisht, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave, shpenzimeve dhe transfertave, me disa problematika të evidentuara në këtë Raport, janë në përputhje me shumat dhe dedikimet e përcaktuara në buxhetet e miratuara të njësive shpenzuese buxhetore, si dhe është siguruar mbajtja nën kontroll e treguesve të deficitit buxhetor dhe borxhit publik.

Pavarësisht treguesve të përfshirë në Raportin e përgatitur nga Qeveria për zbatimin e buxhetit vjetor dhe situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2023, bazuar në gjetjet dhe rezultatet e auditimeve tona, KLSH vlerëson se:

- Në përgjithësi, transaksionet ekonomike të shtetit në të gjitha aspektet materiale janë kryer në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, Ligjin për Buxhetin e Shtetit të vitit 2023 dhe Aktet Normative për ndryshimet të tij. Megjithatë, nga rezultatet e auditimeve të kryera, në disa njësi shpenzuese janë konstatuar parregullsi dhe veprime të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi ose transaksionet financiare të kryera prej tyre nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator përkatës;
- Nga auditimi në Ministrinë e Financave ka rezultuar se ky institucion nuk ka arritur që të rregullojë me ligj të veçantë kontabilitetin dhe raportimin në sektorin publik, si dhe të nxjerrë udhëzim për standardet e kësaj fushe, i cili vijon të rregullohet me një udhëzim mbi procedurat e kontabilitetit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme;
- Siç ka konfirmuar procesi auditues në Ministrinë e Financave, nuk është realizuar detyrimi ligjor për të miratuar dhe përcjellë në Kuvend, pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit[1] dhe KLSH e ka të pamundur të kryejë auditim financiar për pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit dhe për pasojë shqyrtimin dhe çertifikimin e tyre. Në këto kushte, KLSH nuk mund të formulojë opinionin për auditimin financiar të pasqyrave të konsoliduara të buxhetit, për pasojë është vijuar me hartimin e konkluzionit të përputhshmërisë së buxhetit, sipas evidencës së mbledhur dhe të vlerësuar kundrejt kritereve të rëna dakord;
- Evidentohen raste të papajtueshmërisë apo shkelje të disiplinës fiskale në kuadër të gjithë subjekteve publike të audituara, për pjesën takuese të mbulimit me auditim për vitin 2023; jo të gjitha transaksionet dhe aktivitetet janë kryer në përputhje me kriteret që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektet e audituara në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare buxhetore; janë identifikuar në subjektet e audituara parregullsi e shkelje të vlerësuara të rëndësishme materiale në zbatimin e akteve të buxhetit të shtetit; risqe ekzistuese operacionale dhe strategjike, mungesë efikasiteti të masave për minimizimin e riskut për veprimet ekstra-buxhetore, si dhe atyre mbi shmangien e shpërdorimit, të parregullsive apo mashtrimit; dobësi në funksionimin e duhur dhe efektiv të kornizës së kontrollit të brendshëm të harmonizuar në njësitë buxhetore, për të parandaluar dhe zbutur risqet kryesore të subjekteve publike;

[1] Neni 63, germa "a", ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar

- Zbatimi i kontrolleve dhe masave parandaluese, zbuluese dhe korrigjuese që garantojnë disiplinën fiskale të sektorit publik nuk është i plotë dhe me mangësi, veçanërisht në institucionet e vetëqeverisjes vendore;
- Komponentët e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme vijojnë të konsiderohen 'pjësërisht efektiv', ku vetëm një nga 17 parimet e vlerësuara nga MF ka shënuar progres për vitin 2023;
- Nga auditimet që i përkasin aktivitetit të vitit 2023 të ardhura buxhetore të munguara në shumën 16,935 mijë lekë; në fushën e shpenzimeve dëm ekonomik në vlerën prej 104,374 mijë lekë; si dhe përdorim pa efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet i fondeve publike në vlerën gjithsej 5,205,396 mijë lekë.

Si përfundim, KLSH jep konkluzion të kualifikuar të përputhshmërisë [2] për buxhetin e vitit 2023, bazuar në devijimet materiale sasiore dhe cilësore (ISSAI 4000/125-130 dhe ISSAI 4000/194/a), dhe shpreh se: referuar veprimtarisë audituese, me përjashtim të çështjeve të evidentuara më sipër, veprimtaritë e subjekteve publike të audituara në drejtim të hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit të buxhetit, janë në përputhje në të gjitha aspektet materiale me kriteret e aplikuara për këtë qëllim.

Përgjegjësitë e Ministrisë së Financave dhe strukturave drejtuese të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme:

Ministria e Financave është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e sistemit të rregullave, standardeve dhe procedurave, që garantojnë në mënyrë të arsyeshme administrimin ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare publike.
Kjo strukturë është ngarkuar për drejtimin e proceseve të vlerësimeve e parashikimeve makroekonomike dhe buxhetore, si dhe drejtimin e procedurave për hartimin, ekzekutimin, monitorimin dhe raportimin buxhetor; nxjerrjen dhe garantimin e zbatimit të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre; kontrollin e procesit të raportimit të treguesve fiskal; administrimin e sistemit të thesarit, vlerësimin e risqeve fiskale dhe detyrimeve kontigjente, ndjekjen e stokut të detyrimeve të prapambetura; bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e shërbimit të auditimit të brendshëm publik, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi për periudhat e audituara.

Titullarët e Njësive të qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjës për procesin e hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit buxhetor për institucionet që drejtojnë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr. 84/2022, datë 24.11.2022 "Për buxhetin e vitit 2023" të ndryshuar; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar etj., si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

[2] *Opinion i kualifikuar*. Audituesi shpreh një opinion të kualifikuar, kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura.

Përgjegjësitë e KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivat e veprimtarisë audituese synojnë dhënien e sigurisë së arsyeshme për publikun, Kuvendin dhe instancat shtetërore, nëse treguesit e konsoliduar fiskalë të raportuar paraqesin anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një opinion mbi përputhshmërinë e hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2023, sipas parashikimeve në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.
Në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare Profesionale të fushës së auditimit të jashtëm publik (ISSAI-t), siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por që nuk garanton se auditimi i kryer në përputhje me standardet, të identifikojë çdo gabim apo anomali që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar të buxhetit.

Realizimi i treguesve fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar dhe menaxhimi financiar

Buxheti i vitit 2023 është miratuar me ligjin nr. 84/2022, datë 24.11.2022, dhe është ndryshuar gjatë vitit me Aktin Normativ (AN) nr.5, datë 18.10.2023 dhe AN nr.6, datë 14.12.2023.

Referuar ndryshimit përfundimtar të buxhetit të vitit 2023, rezulton se të ardhurat gjithsej janë realizuar në shumën 643,678 milion lekë në krahasim me planin prej 650,109 milion lekë ose 99 %. Në totalin e të ardhurave janë realizuar të ardhurat tatimore dhe paraqiten me mosrealizim të ardhurat nga ndihmat dhe jo tatimore.

Shpenzimet gjithsej janë realizuar 96 % ose 674,857 milion lekë nga 705,607 milion lekë të planifikuara. Rezultojnë me tejkalim shpenzimet për subvencionet (19%), personelin dhe buxhetin vendor nga (4 %), fondet speciale dhe shpenzime të tjera nga (1%), ndërsa nuk janë realizuar kategoritë e shpenzimeve kapitale (përfshirë dhe fondin e rindërtimit), për interesat, operative dhe mirëmbajtje, etj.

Financimi i deficitit buxhetor është realizuar 31,180 milion lekë nga 55,498 milion lekë të planifikuara, dhe në strukturë në vlera më të larta nga burimi i huaj në krahasim me burimin e brendshëm të financimit.

Stoku i borxhit publik për vitin 2023 ka rezultuar 1,362,828 milion lekë, brenda kufirit të vlerësimit në ligjin e buxhetit vjetor të ndryshuar në vlerën prej 1,454,139 milionë lekë dhe përbëhet pothuajse plotësisht nga stoku i borxhit të qeverisjes qendrore (përfshirë dhe stokun e borxhit të garantuar nga qeverisja qendrore) dhe shumë pak nga stoku i borxhit të qeverisjes vendore. Në vitin 2023 stoku i borxhit publik përbën 58.9 % të PBB, me një ulje prej 5.6 % në krahasim me vitin 2022 që ishte 64.5 %.

Performanca e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2023 konsiderohet “pjesërisht efektiv”, ndonëse vlerësohet progresi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Nga analiza e të dhënave mbi vlerësimin e jashtëm të veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm (AB) nga MF, lidhur me zbatimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit (SNA), evidenton se, janë konsideruar dhe grupuar në kategorinë “Veprimtaria e AB në mospërputhje të pjesshme ose të plotë me SNA”,

Nga shqyrtimi i raportit të MF "Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2023" dhe i raporteve të tjera që e shoqërojnë, si dhe nga rezultatet e auditimeve mbi bazën e të cilave është hartuar ky raport, KLSH konstaton se kryesisht:

- Ministria e Financave ka dërguar në qershor raportin mbi zbatimin e buxhetit të vitit 2023, ndërkohë që afati ka qenë brenda muajit maj 2024, si dhe ky raport ka mangësi të analizës për fusha apo për tregues te veçantë, duke u mjaftuar me pasqyrim të njëjtë me vitin e kaluar;
- Menaxhimi i financave publike në vitin 2023 është kryer në mungesë të një dokumenti strategjik, pasi Strategjia sektoriale për menaxhimin e financave publike 2023-2030 është miratuar në qershor 2024, duke krijuar shkëputje nga strategjia e mëparshme 2019-2022;
- Ndryshimi i ligjit të buxhetit 2023 ka vijuar të bëhet me dy Akte Normative, pa ndjekur procedura të zakonshme parlamentare, si dhe koha e ndryshimeve të tyre është në fund të vitit kryesisht në fushën e shpenzimeve, me pasoja në përdorimin racional dhe të balancuar të fondeve publike;
- Fenomeni i përqendrimit të shpenzimeve publike në muajin dhjetor, rrezikon të ndikojë negativisht në disa tregues të tjerë ekonomik si në kursin e këmbimit, presionet inflacioniste, si dhe rrit riskun e parregullsive në përdorimin e fondeve publike;
- Ndryshimet e konsiderueshme të treguesve gjatë fazave të hartimit dhe zbatimit të buxhetit shfaqin mangësi në aftësinë e parashikimit dhe planifikimit me saktësi të arsyeshme të tyre, e konstatuar në vijimësi nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Janë miratuar tre ligje tatimore me efekte në të ardhurat buxhetore në muajin dhjetor 2023, jashtë afatit të përcaktuar në ligjin organik të buxhetit për t'u miratuar, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal;
- Ministria e Financave nuk e shoqëron rritjen e të ardhurave nga TVSH me rritjen e shumave për rimbursimin e saj, duke rezultuar në vijimësi me tejkalim të këtij treguesi me ndikim në uljen e të ardhurave në dispozicion të buxhetit të shtetit për këtë lloj tatimi;
- Një numër i konsiderueshëm i njësive të qeverisjes qendrore por edhe ato vendore nuk kanë arritur plotësimin e strukturave të tyre, duke shfaqur jo vetëm mangësi planifikimi por duke rrezikuar dhe performancën institucionale, me riskun për ofrimin e shërbimeve publike pa cilësi dhe jo në afatin e duhur;
- Në vitin 2023 ka një nivel të ulët të realizimit të shpenzimeve kapitale me burim të huaj financimi krahasuar me planin dhe një vit më parë, duke shfaqur mangësi të ministrive të linjës lidhur me planifikimin e saktë të projekteve me financim të huaj.
- Fondi i rindërtimit vijon të mbetet një çështje emergjente, për vetë karakterin social por dhe peshën që zë në shpenzimet e buxhetit të shtetit. Ndryshimet e shpeshta dhe të konsiderueshme të buxhetit për rindërtimin shfaqin mungesë qartësie në objektiva dhe mangësi në monitorimin e ecurisë së këtij procesi;
- Fondi rezervë është denatyruar gjatë përdorimit të tij, pasi është akorduar dhe përdorur për rastet e financimit të shpenzimeve të njohura dhe mund të parashikoheshin gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit;

- Kontrolli i Lartë i Shtetit, vijon të konsiderojë risqe fiskale me impakt buxhetor çështjet që kanë të bëjnë me performancën e Ndërmarrjeve Shtetërore kryesore; shpenzimet për

kontratat koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP) me mbështetje buxhetore; detyrimet e prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme; dhe detyrime të tjera kontigjente për çështjet gjyqësore ndërkombëtare.

Kontrolli i Lartë i Shtetit vlerëson se, rritja e cilësisë së planifikimit dhe raportimit buxhetor, në funksion të përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe transparencës së shpenzimeve publike, si dhe përmirësimi i monitorimit të buxhetit në tërësi, menaxhimit dhe mirëadministrimit të risqeve fiskale në rritje, duke përfshirë dhe çështjet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, janë të rëndësishme për sigurimin e financave të shëndetshme publike dhe besueshmërisë së kuadrit fiskal.

Nëpërmjet paraqitjes në Kuvend të këtij Raporti[3], Kontrolli i Lartë i Shtetit, krahas zbatimit të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, synon të nxisë transparencën, parashikueshmërinë, gjithëpërfshirjen, unitetin dhe universalitetin në menaxhimin e sistemit buxhetor e të fondeve speciale; disiplinën fiskale; shpërndarjen e burimeve, në përputhje me objektivat strategjikë të Këshillit të Ministrave; përdorimin ekonomik, efiçent dhe efektiv i burimeve publike; përgjegjësi të qarta për menaxhimin operacional; respektimin me rreptësi të tërësisë së procesit etj., në shërbim të mirëqeverisjes dhe në funksion të përmirësimit të jetesës së taksapaguesve dhe qytetarëve shqiptarë.

[3] Ky raport është përgatitur duke marë në konsideratë rekomandimet e SIGMA-s, përcjellë në KLSH në datën 14.10.2024.

I. PLANIFIKIMI, REALIZIMI DHE AUDITIMI I BUXHETIT

Kontrolli i Lartë i Shtetit, çdo vit, informon Kuvendin mbi rezultatet e auditimeve në lidhje me buxhetin, ku jep opinion profesional të bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Jashtëm Publik (INTOSAI). Ky raport vjetor i zbatimit të buxhetit të konsoliduar është i bazuar dhe në rezultatet e auditimeve për çështje që kanë të bëjnë me përdorimin, administrimin dhe mbrojtjen e fondeve publike dhe pronës publike apo shtetërore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, sistemet e kontabilitetit, menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit të brendshëm në njësitë e sektorit publik etj.

Ligji për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor (neni 63) përcakton që, KLSH shqyrton dhe certifikon pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit dhe i paraqet Kuvendit një raport të plotë mbi ekzekutimin e buxhetit të vitit të mëparshëm fiskal.

Bazuar në sa më sipër, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka hartuar Raportin mbi përgatitjen, shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit; zbatimin, ndjekjen, rishikimin dhe monitorimin e tij; të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë, si dhe format e tjera, të rrjedhura prej tyre; kontrollin, kontabilitetin, raportimin, inspektimin dhe auditimin në tërësi të të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore e vendore dhe të fondeve speciale, deficitin dhe borxhin publik, të cilat miratohen me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë, ose me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

Raporti i Ministrisë së Financave "Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2023", është administruar në KLSH me shkresën nr.869 prot., datë 27.06.2024, megjithëse Ministria e Financave e konsideron të dërguar me shkresën nr. 7701/1 prot., datë 31.05.2024. Nga sa më sipër konstatohet se, Ministri i Financave nuk ka përcjellë një kopje të këtij raporti në Kontrollin e Lartë të Shtetit brenda afatit të parashikuar në paragrafin e fundit të nenit 62, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Gjithashtu, nga krahasimi i Raportit për zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2023 me atë të vitit 2022, konstatohet se kanë strukturë të njëjtë përmbajtjeje, të plotësuar me tabela dhe grafikë të së njëjtës formë dhe pothuajse në numër të njëjtë, me ndryshime të vogla në përmbajtje dhe me shifra të përditësuara, duke sjellë për pasojë mungesën e një qasjeje të re dhe të thelluar, si dhe të mungesës së analizës për fusha apo për tregues të veçantë, duke u mjaftuar me pasqyrim të njëjtë me vitin e kaluar, bazuar në sfidat e së ardhmes afatshkurtër dhe afatmesme, në funksion të një analize konkrete për të siguruar një nivel më të lartë transparence, përgjegjshmërie dhe llogaridhënieje ndaj taksapaguesve. Për disa tregues të shpenzimeve, siç janë ato për personelin, për subvencionet, për mirëmbajtje etj., në raport jepen tre tregues për përqindjen e planit vjetor sipas buxhetit fillestar; sipas planit të ndryshuar me AN nr.6, datë 14.12.2023 dhe sipas planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash, duke e bërë atë kompleks dhe vështirësuar një analizë e ndarje të qartë të performancës në këto drejtime.

Duke e konsideruar sistemin e menaxhimit të financave publike një grup rregullash dhe institucionesh, politikash dhe procesesh që disiplinojnë përdorimin e fondeve publike në të gjithë sektorët, nga mbledhja e të ardhurave deri te monitorimi dhe kryerja e shpenzimeve publike, si

dhe vijimësinë e Menaxhimit të Financave Publike, një çështje thelbësore për të rritur efektivitetin e shpenzimeve buxhetore dhe për të krijuar një mjedis më produktiv për shpenzime në afat të mesëm dhe afatgjatë, duhet theksuar se gjatë vitit 2023, menaxhimi i financave publike është kryer në mungesë të një dokumenti strategjik, si një mekanizëm që kontribuon në forcimin e transparencës, llogaridhënies, disiplinës fiskale, efikasitetit dhe barazisë në përdorimin e burimeve publike dhe ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara. Ministria e Financave nuk ka marrë masat e nevojshme dhe nuk ka arritur që të hartojë në kohë Strategjinë sektoriale për menaxhimin e financave publike për vitin 2023, pasi kjo strategji për periudhën 2023-2030 është miratuar me VKM nr.390, datë 12.06.2024[4], duke krijuar shkëputje nga strategjia e mëparshme 2019-2022.

Buxheti i vitit 2023 është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 84/2022, datë 24.11.2022, brenda afateve të vendosura në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili ka përcaktuar si kufi datën 15 dhjetor.

Gjatë vitit 2023 janë miratuar dhe dy Akte Normative (AN) "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.84/2022, "Për buxhetin e vitit2023": AN nr.5, datë 18.10.2023 dhe AN nr.6, datë 14.12.2023. Ndryshimi i ligjit vjetor të buxhetit me Akte Normative përgjithësisht nuk merr shpjegim të plotë mbi nevojën dhe urgjencën e procedurave të zakonshme parlamentare, për të krijuar linja të reja shpenzimesh pa miratim paraprak nga parlamenti, si dhe nuk shërben për marrjen e masave të përkohshme, por mbartin pasoja afatgjata në financat e shtetit.

Gjithashtu, në lidhje më këtë çështje janë shprehur dhe Komisioni Evropian, Fondi Monetar Ndërkombëtar etj., duke theksuar minimizimin e përdorimit të këtij instrumenti për ndryshimin e buxhetit vjetor.

Duhet theksuar se, merr shumë rëndësi dhe meriton vëmendje koha e kryerjes së ndryshimeve të buxhetit me Akte Normative. Kjo për faktin se AN nr.6, datë 14.12.2023 ka bërë rishpërndarjen midis zërave të shpenzimeve buxhetore, në pjesën më të madhe në shpenzimet kapitale me financim të huaj (- 53%), dhe më pas shpenzimet operative për mirëmbajtje të qeverisjes qendrore, shpenzime për kompensimin në vlere të pronarëve etj., të konsideruara nga MF si fonde të lira të rezultuara pas vlerësimit të realizimit në nivel 11 mujor të shpenzimeve të institucioneve buxhetore. Nga ana e tjetër janë rritur shpenzimet për disa zëra, në të cilin është përfshirë dhe një zë i ri: Hua e dhënë për AlbControl në vlerën 3,000 milion lekë. Vlera më e lartë është shtuar në shpenzimet kapitale me burim të brendshëm financimi, megjithëse në Raportin e zbatimit të buxhetit 2023 të përgatitur nga MF, cilësohet se, "*kursimet konsistonin kryesisht në zërat e shpenzimeve të personelit si rrjedhojë e mosplotësimit të vakancave në numrin e punonjësve, si edhe projekteve të investimeve publike me financim të brendshëm e të huaj si rrjedhojë e performancës më të ulët sesa planifikimi të disa prej tyre*" (faqe 34). Pra nga njëra anë konsiderohen kursime nga performanca e ulët e projekteve të investimeve publike me financim të brendshëm, nga ana tjetër akordohen shpenzime shtesë në vlerën 5,763 milion lekë. Gjithashtu janë shtuar shpenzimet për Transfertat e pakushtëzuara nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor, kontigjencën etj., ndryshime buxhetore që kanë sjellë për pasojë që në muajin

[4] Botuar në Fletoren Zyrtare nr.105/2024 datë 26.06.2024 dhe hyrë në fuqi pas botimit.

dhjetor të kryhet pothuajse 1/5 e shpenzimeve vjetore (18.7 %), duke afektuar përdorimin racional dhe të barazpeshuar të fondeve publike.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka bërë një analizë të çështjeve të planifikimit buxhetor 2023 në harkun kohor të dy viteve 2022-2023, që nga faza e PBA 2023-2025, projektbuxhetit, buxhetit dhe ndryshimeve me dy akte normative në tetor dhe dhjetor 2023 dhe kanë rezultuar ndryshime të theksuara në kategori e zëra të ndryshëm buxhetorë. Kështu p.sh, të ardhurat e planifikuara gjithsej lëvizin nga 569,737 milion lekë në PBA në 650,109 milion lekë në AN nr.6, dhe brenda tyre të ardhurat nga ndihmat nga 14,958 milion lekë në 30,588 milion lekë, me nënzëra të ardhurat nga tatimet dhe doganat nga 383,726 milion lekë në 423,800 milion lekë ose të ardhurat nga pushteti lokal nga 29,153 milion lekë bien në 27,742 milion lekë etj.
Gjithashtu, ndryshime të theksuara vërehen dhe tek planifikimi i shpenzimeve, ku në total lëvizin nga 627,636 milion lekë në 705,607 milion lekë, si dhe në kategoritë e shpenzimeve korrente nga 522,559 milion lekë në 548,482 milion lekë, me luhatje në faza të ndryshme, dhe brenda tyre shpenzimet operative e mirëmbajtje nga 59,492 milion lekë në 72,958 milion lekë; fondi rezervë nga 3,500 milion lekë në 18,890 milion lekë; shpenzimet kapitale me burim të brendshëm financimi nga 61,117 milion lekë në 91,826 milion lekë; shpenzimet për rindërtimin nga 5,000 milion lekë në ligjin e buxhetit vjetor në 17,000 milion lekë me Akte Normative etj.
Këto tregojnë se MF nuk ka arritur të realizojë procese plotësisht të harmonizuara dhe të bashkërenduara për hartimin e PBA-së, projekt- buxhetit, ashtu dhe ligjit të buxhetit vjetor e ndryshimet e tij, me cilësi të lartë në funksion të zbatimit të prioriteteve dhe politikave të qeverisë dhe ofrimit të shërbimeve publike, për të garantuar parimin e parashikueshmërisë në menaxhimin e sistemit buxhetor e të fondeve speciale.

Referuar ndryshimeve përfundimtare të ligjit të buxhetit vjetor me AN nr.6, datë 14.12.2023, bazuar në të dhënat e Raportit të MF "Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2023", si dhe auditimit të kryer nga KLSH në Ministrinë e Financave për vitin 2023, plani i të ardhurave buxhetore gjithsej prej 650,109 milion lekë është realizuar 643,678 milion lekë ose 99 %, me një mosrealizim në vlerën 6,431 milion lekë, megjithëse janë 70,888 milion lekë ose 12.4 % më shumë se në vitin 2022.
Referuar vlerësimit për PBB në vlerën prej 2,312,588 milion lekë rezulton se të ardhurat buxhetore faktike gjithsej janë rreth 27.8 % e PBB, në krahasim me 26.8 % në vitin 2022.
Sipas të dhënave të INSTAT, PBB-ja gjatë vitit 2023 u rrit me 3.4 %, ndërkohë që të ardhurat buxhetore në përbërje të PBB janë rritur vetëm me 1%, gjë që tregon indirekt për praninë e informalitetit në vend, si dhe mbështetje të performancës së ekonomisë nga sektorë që nuk reflektohen në të ardhura buxhetore, si ai i ndërtimit dhe pasurive të paluajtshme etj.

Shpenzimet buxhetore gjithsej për vitin 2023 janë realizuar 674,857 milion lekë nga 705,607 milion lekë të programuar ose 95.6 %, me një mosrealizim prej 30,750 milion lekë, por që në krahasim me vitin 2022 janë kryer 3.7 % më shumë shpenzime gjithsej. Ato përfaqësojnë 29.2 % të PBB (nivelin më të ulët të katër viteve të fundit) nga 30.4 % në vitin 2022.

Deficiti buxhetor ka qenë planifikuar - 55,498 milion lekë dhe është realizuar - 31,180 milion lekë ose 56.2 %, pra 24,318 milion lekë më pak se programimi, realizim i cili përfaqëson 1.3 % të PBB.

Tabela nr. 1 Të ardhurat, shpenzimet dhe deficiti buxhetor 2023

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2022	Plani 2023	Fakti 2023	Realizimi në %	Diferenca
1	Totali i të ardhurave	572,790	650,109	643,678	99.0	- 6,431
2	Totali i shpenzimeve	651,015	705,607	674,857	95.6	- 30,750
3	Deficiti	- 78,226	- 55,498	-31,180	56.2	24,318

Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

Kontrolli i Lartë i Shtetit analizoi ecurinë e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore në tre vitet e fundit (2021-2023) dhe rezulton se, megjithëse në vlerat nominale për këta tregues vijnë në rritje, ritmet vjetore të rritjes vijojnë tek të ardhurat (nga 12.1 % në 12.4 %), por janë në rënie tek shpenzimet gjithsej: nga 9.2 % në 3.7 %, gjë që tregon se politikat buxhetore gjatë kësaj periudhe kanë qenë në favor të uljes së deficitit fiskal.

Duke analizuar këto tre tregues në dinamikën vjetore 2023, rezulton se vetëm në muajin korrik dhe tremujorin e fundit, shpenzimet janë më të larta se të ardhurat, duke arritur kulmin në muajin dhjetor, ku arrijnë vlerën e 18.7 % të shpenzimeve vjetore, që përkon pikërisht edhe me miratimin e akteve normative nr.5 dhe nr.6 (tetor dhe dhjetor).
Nga analiza e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve për muajt nëntor – dhjetor, rezulton se deficiti midis tyre është -79,087 milion lekë.

Grafiku Nr .1 Ecuria mujore e të ardhurave, shpenzimeve dhe deficitit gjatë vitit 2023



Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

Fenomeni i përqendrimit të shpenzimeve publike në muajin dhjetor, tregon për mungesën e një shpërndarje të balancuar gjatë vitit, rrezikon të ndikojë negativisht në disa tregues të tjerë ekonomik si: në kursin e këmbimit, presionet inflacioniste, si dhe problematika të tjera në përdorimin e fondeve publike të vitit në lidhje me realizimin e programit në vlerë dhe në afat.

A. PLANIFIKIMI, REALIZIMI DHE AUDITIMI I TË ARDHURAVE

Në ligjin nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023" të ardhurat e planifikuara janë miratuar në shumën 642,619 milionë lekë dhe në Aktin Normativ (AN) nr.5, datë 18.10.2023 të ardhurat janë ndryshuar në 650,109 milionë lekë, mbetur në këtë vlerë dhe me AN nr.6, datë 14.12.2023. Referuar treguesve fiskal sipas buxhetit të konsoliduar 2023 të përgatitur nga Ministria e Financave, rezulton se të ardhurat gjithsej janë realizuar 643,678 milion lekë, ose 99 %, në krahasim me ndryshimin përfundimtar, pra 6,431 milion lekë më pak.

Nga auditimi në MF dhe sipas Raportit të përgatitur prej saj, rezulton se të ardhurat e realizuara gjithsej janë 27.8 % e PBB, në krahasim me 26.8 % që ishin në vitin 2022. Rritja e vlerës së të ardhurave në raport me PBB prej 1% është pothuajse e gjithë nga ndihmat e huaja dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (kryesisht nga rritja e pagave), pasi të ardhurat nga tatimet dhe doganat nuk janë rritur në raport me PBB.

Në krahasim me vitin 2022, janë grumbulluar më shumë 70,888 milion lekë ose 12.4 % më tepër, me të njëjtin ritëm vjetor rritjeje si një vit më parë, ndonëse në vlerë nominale më të lartë.

Tabela nr.2 Të ardhurat gjithsej sipas zërave kryesor të buxhetit 2023

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Ligji i buxhetit 2023	AN nr.5, 18.10.23	Fakti 2023	Diferenca me ligjin	Përqindja realizimit	Diferenca me 2022
I.	**Totali i të ardhurave**	**642,619**	**650,109**	**643,678**	**-6,431**	**99.0**	**70,888**
a	*Të ardhura nga grantet*	*30,558*	*30,558*	*22,431*	*-8,127*	*73.4*	*12,921*
b	*Të ardhura tatimore*	*588,453*	*595,942*	*598,662*	*2,720*	*100.5*	*57,320*
c	*Të ardhura jotatimore*	*23,608*	*23,608*	*22,585*	*-1,023*	*95.7*	*647*

Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Të ardhurat tatimore përbëjnë peshën më të madhe në të ardhurat e buxhetit me 93 %, dhe me përbërje pothuajse të barabartë me nga 3.5 % janë të ardhurat nga ndihmat dhe të ardhurat tatimore

Grafiku 2 Struktura e të ardhurave buxhetore gjithsej 2023



Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

Mos realizimi i të ardhurave të programuara gjithsej rezulton se është pasojë e diferencës së ndjeshme në të ardhurat nga grantet (me mosrealizim afër 27%) dhe të diferencës së vlerës së të ardhurave jotatimore (4.3 %), me ndikim pozitiv në zbutjen e këtij mosrealizimi është tejkalimi i të ardhurave tatimore të programuara me + 2,720 milion lekë.

Niveli më i lartë i të ardhurave mujore gjithsej të mbledhura për vitin 2023 është në muajin qershor dhe niveli më i ulët në muajin shkurt 2024.

Nga shqyrtimi i treguesve fiskal të planifikuar të dokumenteve të kuadrit makroekonomik fiskal për periudhën 2023 - 2025 (treguesit e PBA për vitin 2023), miratuar me VKM nr.19, datë 13.01.2022; të Projektbuxhetit të prezantuar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat më datë 26.10.2022; të buxhetit të vitit 2023 të miratuar me ligjin nr.84/2022 më datë 24.11.2022; të Aktit Normativ (AN) nr.5 datë 18.10.2023 dhe AN nr.6 datë 14.12.2023, konstatohet zëra dhe nënzëra të treguesve që shfaqin ndryshime të konsiderueshme programimi (shtesa dhe/ose pakësime) në harkun kohor të dy viteve. Kështu, totali i të ardhurave të planifikuara rritet me 14 % nga PBA në AN të fundit; të ardhurat nga ndihmat dyfishohen; të ardhurat tatimore rriten 12 %, fondet speciale 21 % etj.; shpenzimet ne total rriten 12 %, shpenzimet e personelit rriten dhe ulen në këto dokumente, po kështu dhe shpenzimet për interesa, për fondet speciale; shpenzimet kapitale me burim të brendshëm rriten 33 % dhe po në këtë masë zvogëlohen me burim të huaj; fondi i rindërtimit rritet 2.5 fish etj. Kjo tregon se Ministria e Financave e ka të nevojshëm përmirësimin e sistemit të planifikimit, zbatimin e këtij procesi me saktësi të arsyeshme, cilësi të lartë dhe të besueshme në shërbim të zbatimit të prioriteteve dhe politikave të qeverisë dhe ofrimit të shërbimeve publike, pasi mangësitë e procesit të planifikimit janë konstatuar në vijimësi nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të reflektuara këto dhe në prioritetet e Strategjisë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike 2022-2030 dhe Planit të Veprimit 2023-2026, për një parashikim të matur dhe realist të të ardhurave afatmesme në përputhje me parashikuesit e pavarur dhe ndërkombëtarë.

Buxheti i vitit 2023 është ndryshuar me Aktin Normativ nr.5 datë 18.10.2023, në të cilin janë rritur të ardhurat buxhetore me 7,490 milion lekë, e parashikuar kjo nga rritja e të ardhurave nga fondet speciale me 16,300 milion lekë dhe uljen e planit të të ardhurave nga tatimet dhe doganat, pushteti lokal, etj.
Gjithashtu, buxheti është ndryshuar dhe me AN nr.6 datë 14.12.2023. Raporti i Ministrisë së Financave "Mbi zbatimin e Buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2023", cilëson se ky AN ka për qëllim primar rishpërndarjen e një volumi prej rreth 20 miliard lekë mes zërave të shpenzimeve buxhetore, korrente e kapitale, me synimin e realizimit sa më të plotë të shpenzimeve publike për pjesën e mbetur të vitit 2023 (faqe 34 e këtij Raporti), në një kohë që pjesa e mbetur e vitit është më pak se dy javë.

Në dhjetor të vitit 2023, janë miratuar jo në përputhje me parashikimet e ligjit organik të buxhetit tre ligje tatimore me efekte në të ardhurat buxhetore: ligji nr. 94/2023, datë 7.12.2023, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligji nr. 95/2023, datë 7.12.2023, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe ligji nr. 95/2023, datë 7.12.2023, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, pasi nuk është respektuar afati i miratimit të tyre jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal.

Programimi, realizimi dhe auditimi i të ardhurave sipas strukturës së treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar

1. Të ardhurat nga grantet

Sipas tabelës së treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar të ardhurat nga grantet (ndihmat) për vitin 2023 janë programuar 30,558 milion lekë dhe realizuar 22,431 milion lekë ose 73,4 %, duke ndikuar ndjeshëm në mos realizmin e të ardhurave të përgjithshme buxhetore në vlerën prej 8,127 milion lekë.

Rreth 80 % e shumës faktike të të ardhurave nga ndihmat (17,870 milion lekë) janë të ardhura të mbështetjes buxhetore nga KE[5], e cila ka filluar që nga viti 2017 dhe përbën vlerën më të lartë të të gjithë kësaj periudhe.

Realizimi i të ardhurave nga ndihmat në vitin 2023 është 2.4 herë më i lartë se në vitin 2022 dhe në vlerë nominale më i larti i gjithë periudhës, si dhe përbën 1% të PBB-së.

Duhet theksuar se Raporti i MF për zbatimin e buxhetit 2023 cilëson se, të ardhurat nga ndihmat për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë në vlerën 22.2 miliardë lekë (*faqe 15 e Raportit*), pra 0.2 miliard lekë më pak se tabela shoqëruese e Raportit "Treguesit fiskal sipas buxhetit të konsoliduar" duke e reflektuar dhe në totalin e të ardhurave, si dhe rritjen nga një vit më parë në masën 133.1% (*faqe 15*), që në fakt është 2.4 herë.

Pra, Raporti i Ministrisë së Financave "Mbi zbatimin e Buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2023", ka mospërputhje në shifrat e realizimit dhe analizimit të të ardhurave nga ndihmat e pasqyruara në tabelën e treguesve fiskal sipas buxhetit të konsoliduar 2023.

Fakti i nivelit të lartë të mosrealizimit, si dhe i ndryshimit të vlerës nominale të të ardhurave mujore nga ndihmat në vitin 2023, të cilat lëvizin nga 10,193 milion lekë në qershor dhe zbresin në 166 milion lekë në muajin korrik, krahas dobësive në planifikim, tregon për mungesë të veprimtarisë sistematike dhe të aftësisë të administratës publike në përgjithësi për përfitimin e fondeve në formën e ndihmës nga qeveritë e shteteve të tjera dhe donatorë të ndryshëm.

2. Të ardhurat tatimore

Të ardhurat e këtij grupi, të cilat përbëhen nga të ardhurat që mblidhen nga tatimet dhe doganat, nga pushteti vendor, dhe nga fondet speciale, me AN nr.5, datë 18.10.2023 përfundimisht janë programuar 595,942 milion lekë dhe janë realizuar 598,662 milion lekë ose 100.5 %, pra 2,720 milion lekë më shumë se përcaktimi ligjor, si dhe 57,320 milion lekë më shumë se një vit më parë.

[5] https://financa.gov.al/statistika-fiskale-ne-vite/

Grafiku nr. 3 Programi dhe realizimi i të ardhurave tatimore sipas zërave 2023

Në milion lekë



Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

Të ardhurat tatimore faktike përbëjnë 93 % të të ardhurave publike gjithsej, me një rritje të konsiderueshme në peshë specifike në krahasim me vitin 2022 që ka qenë 84 %.

Niveli më i lartë i të ardhurave tatimore mujore është realizuar në mars (kryesisht nga të ardhurat nga tatimet dhe doganat) dhe niveli më i ulët në muajin shkurt 2023.

Të ardhurat tatimore përbëjnë 27.5 % të PBB për vitin 2023, me një rritje prej 2.1 % krahasuar me vitin 2022.

Sipas përbërjes strukturore, 70.6 % e të ardhurave tatimore e përbëjnë të ardhurat nga tatimet dhe doganat; 24.1% të ardhurat nga fondet speciale dhe 5.3% të ardhurat nga pushteti vendor, me një ndryshim të lehtë në zbritje të të ardhurave nga tatimet dhe doganat nga rritja e fondeve speciale, pa ndryshime të të ardhurave nga pushteti vendor.

2.1 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat

Sipas AN nr.5, datë 18.10.2023, të ardhurat nga tatimet dhe doganat janë programuar përfundimisht 423,800 milion lekë, në ulje nga ligji nr.84/2022, datë 24.11.2022 "Për buxhetin e vitit 2023" që ishte 431,200 milion lekë dhe sipas MF në treguesit e pasqyrës se konsoliduar fiskale janë realizuar 422,491 milion lekë ose 99.7 %, me një mosrealizim prej 1,309 milion lekë.

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat përbëjnë zërin kryesor të të ardhurave tatimore dhe të të ardhurave gjithsej të buxhetit të shtetit, pasi përfaqësojnë përkatësisht 70.6 % dhe 65.6 %, me rritje 5% në të ardhurat gjithsej dhe rënie të lehtë (1 %) në të ardhurat tatimore, krahasuar me përfaqësimin e tyre në vitin 2022.

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat përbëhen nga të ardhurat për tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi fitimin, akcizat, tatimin mbi të ardhurat personale, taksa nacionale dhe taksa doganore, programi sipas buxhetit të rishikuar dhe realizimi faktik i të cilëve paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga tatimet dhe doganat 2023

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakt 2022	Ligji i buxhetit	AN nr.5, 18.10.23	Fakt 2023	Difer	% realiz	Dif. me 2022
I	**Nga tatimet dhe doganat**	**390,893**	**431,200**	**423,800**	**422,491**	**(1,309)**	**99.7**	**31,598**
a	*Tatimi mbi Vlerën e Shtuar*	*191,412*	*210,900*	*200,000*	*192,322*	*(7,678)*	*96*	*910*
b	*Tatimi mbi fitimin*	*47,683*	*49,500*	*59,000*	*64,576*	*5,576*	*109*	*16,894*
c	*Akcizat*	*53,547*	*59,000*	*59,000*	*58,394*	*(606)*	*99*	*4,847*
d	*Tatimi mbi të ardhurat personale*	*44,983*	*49,000*	*56,000*	*57,878*	*1,878*	*103*	*12,894*
e	*Taksa nacionale dhe të tjera*	*44,821*	*54,300*	*41,000*	*40,188*	*(812)*	*98*	*(4,633)*
f	*Taksa doganore*	*8,447*	*8,500*	*8,800*	*9,133*	*333*	*104*	*687*

Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

Referuar Raportit "Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2023" të përgatitur nga MF, Akti Normativ Nr.5 datë 18.10.2023 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", cilësohet se, ka patur synim kryesor, midis të tjerave, reflektimin në kahun e të ardhurave të një rritje prej rreth 7.5 miliardë lekë, si rezultat i performancës pozitive në realizimin e të ardhurave tatimore për 9 mujorin 2022, kur në fakt, pikërisht me anë të këtij Akti Normativ të ardhurat nga tatimet dhe doganat janë ulur me 7.4 miliard lekë.

Duhet theksuar se të ardhurat nga tatimet dhe doganat janë në nivelin e 18.3 % të PBB, aq sa ishin dhe në vitin 2022, duke mos shfaqur prirje në rritje, për t'iu përgjigjur ritmeve të zhvillimit të ekonomisë, si dhe pa reflektuar një trend të qartë rritës krahasuar me rritjen ekonomike të vendit.

2.1.1 Të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Sipas programit përfundimtar buxhetor të përcaktuar me AN nr.5, datë 18.10.2023, kanë qenë 200,000 milion lekë TVSH për t'u mbledhur, shifër kjo me ulje në krahasim me ligjin vjetor të buxhetit që ishte 210,900 milion lekë, dhe janë realizuar 192,322 milion lekë ose 96 %, me një mosrealizim prej 7,678 milion lekë.

Duhet theksuar se të ardhurat e TVSH-së përbëjnë 45.5 % të të ardhurave faktike nga tatimet dhe doganat dhe pothuajse 1/3 e të ardhurave publike gjithsej në vitin 2023, si dhe përbëjnë 8.3 % të PBB.

Në vitin 2023 janë mbledhur 910 milion lekë TVSH më shumë se në vitin 2022, dhe vlera më e lartë e mbledhur është në muajin tetor dhe ajo më e ulët në muajin shkurt 2023.

Mbledhja e TVSH është detyrë e administratës tatimore dhe doganore, të cilat e kanë realizuar këtë detyrë sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela nr.4 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave të TVSH-së neto nga tatimet dhe doganat 2023

Në milion lekë

Nr	Emërtimi	Fakt 2022	AN nr.5, 18.10.23	Fakt 2023	Diferenca	% realiz	Dif. me 2022
1	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	156,898	152,677	146,386	-6,291	96	-10,512
2	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	34,514	47,323	45,936	-1,387	97	11,422
	Gjithsej	**191,412**	**200,000**	**192,322**	**- 7,678**	**96**	**910**

Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

Nga sa më sipër rezulton se, mosrealizimin më të ndjeshëm të mbledhjes së TVSH e ka krijuar administrata doganore me vlerën prej 6,291 milion lekë ose 82 % të mosrealizimit gjithsej, megjithëse përqindjen e realizimit të programit e kanë pothuajse të njëjtë (96%).

Diferenca qëndron në faktin se, ndërsa administrata tatimore ka realizuar 33 % më shumë të ardhura nga TVSH se vitit 2022, administrata doganore është 7 % nën nivelin e realizimit të këtij viti, duke ndikuar ndjeshëm në ritmet vjetore të rritjes së vlerës së TVSH-së e reduktuar në 0.5 %.

Duke analizuar strukturën e realizimit faktik sipas përgjegjësisë funksionale rezulton se 76 % është mbledhur nga administrata doganore dhe 24 % nga administrata tatimore, me një ndryshim prej + 6 % në favor të administratës tatimore në krahasim me vitin 2022. Ndryshimi i këtij raporti reflekton rënien e importeve, prirjen e rënies së çmimeve të mallrave të importit dhe rënien e kursit të këmbimit euro dhe dollar ndaj lekut.

Nga ana tjetër, fakti që nga administrata doganore arkëtohet rreth 75 % e TVSH-së tregon se, këto të ardhura janë të varura nga importet, përfshirë dhe një pjese të eksporteve, dhe jo nga aktiviteti prodhues dhe shërbimet brenda vendit, të cilat japin një kontribut më të vogël.

Sipas Raportit të MF, kontributi më i madh në TVSH bruto është nga sektori i shërbimeve me 33 %, tregtia me 29 %, ndërkohë që prodhimi ka kontribuar vetëm 20 %.

Sipas Raportit vjetor 2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, raportohet se TVSH e mbledhur nga ana e tyre është 46,034 milion lekë, ose 98 milion lekë më shumë se raportimi i MF në treguesit e konsoliduar fiskal të buxhetit të vitit 2023. Po ashtu dhe planin, DPT e raporton 47,334 milion lekë, nga 47,323 milion lekë, ose 11 milion lekë më të lartë.

Nga auditimi i KLSH në DPT, konstatohet se për efekt të realizmit të TVSH, janë përfshirë dhe 310 milion lekë kamatëvonesa dhe depozitime të përkohshme për deklaratën e TVSH-së.

Nga auditimi i KLSH të kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave rezulton se, me ndryshimin e planit të TVSH me ulje i bërë me AN nr.5 në tetor 2023, nga ana e saj është ndryshuar dhe plani mujor për periudhat paraardhëse, duke e kthyer monitorimin e realizimit të të ardhurave nga TVSH në një veprimtari formale.

Rimbursimi i TVSH-së, i cili është atribut i DPT, sipas MF të paraqitur në Raportin e zbatimit të buxhetit 2023 (Tabela 8 -Të ardhura nga tatimet dhe doganat) ka qenë programuar 18,000 milion

lekë dhe sipas saj është realizuar 22,615 milion lekë ose 125.6 %, pra 4,615 milion lekë më shumë se sa planifikimi.
Në krahasim me vitin 2022, janë rimbursuar 133 milion lekë më pak në vitin 2023, megjithëse janë realizuar 910 milion lekë më shumë TVSH bruto, por që nuk influencon ndryshimin e përqindjes së rimbursimit në këto dy vite.

Sipas Raportit vjetor 2023 të DPT, vlera e TVSH-së së rimbursuar është 22,624 milion lekë, gjë që do të thotë se në pasqyrat e treguesve të konsoliduar fiskal nga ana e MF janë paraqitur për 9 milion lekë më pak.

Sipas Raportit të zbatimit te buxhetit 2023 të MF, cilësohet se vijojnë të mos rezultojnë detyrime për rimbursimin e TVSH-së (faqe 53). Nga auditimi i KLSH-së në DPT ka rezultuar se janë 9 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuara, por të pa miratuara në vlerën totale për 101 milion lekë, për të cilat megjithëse ka kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar, duke sjellë për pasojë që kjo vlerë të konsiderohet stok i rimbursimit të TVSH më 31.12.2023.

Nga auditimi KLSH-së në DPT ka rezultuar se detyrimet tatimore për TVSH-në në fund të vitit 2023 janë në vlerën prej 55,268 milion lekë për 182,490 subjekte, nga të cilat detyrimi është 57 % ndërsa pjesa e tjetër gjoba dhe interesa. Detyrimi gjendje në fund të vitit për TVSH-në përbën 36 % të detyrimeve tatimore gjithsej ose 29 % e të ardhurave faktike të këtij viti. Ashtu siç kemi theksuar dhe në raportet e kaluara, mbetet problem mundësia e vjeljes së këtyre detyrimeve për shkak të: moshës së detyrimit, pasi 57 % e totalit i përket periudhës mbi 5 vjet; vetëm 26 % e vlerës së detyrimit tatimor i përket subjekteve aktive, ndërsa pjesa e tjetër nuk janë në funksion; në vitin 2023 detyrimet tatimore janë rritur me 3,183 milion lekë, pavarësisht vlerës nominale pak më të ulët në krahasim me vitin 2022; DPT në kuadër të ezaurimit të masave për vjeljen e detyrimeve të prapambetura tatimore nuk ka përdorur masat shtrënguese “Urdhër sekuestrimi”, ”Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë”, ”Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit” etj.
Duhet theksuar se, kanë rezultuar edhe 6 milion lekë detyrime për TVSH-në jashtë sistemit C@TS, e cila përbën detyrime të krijuara para vitit 2015.

Nga auditimi i KLSH-së në DPD kanë rezultuar 535 milion lekë detyrime nga TVSH-ja e shtyrë më 31 dhjetor 2023.

2.1.2 Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin

Nga auditimi në MF dhe Raportit të përgatitur nga ana e saj, për vitin 2023 janë realizuar 64,576 milion lekë nga tatimi mbi fitimin, nga 59,000 milion lekë të programuara përfundimisht me AN nr.5 (pasi në ligjin për buxhetin kanë qenë 49,500 milion lekë të planifikuara) ose 109.5 %, me 5,576 milion lekë më shumë se planifikimi. Ato përfaqësojnë 15 % të të ardhurave nga tatimet dhe doganat dhe 10 % të të ardhurave publike gjithsej.

Këto të ardhura që mblidhen nga DPT, në vitin 2023 janë realizuar 35.4 % më shumë se në vitin 2022, si dhe pothuajse ¼ e gjithë vlerës së tatimit mbi fitimin është mbledhur në muajin mars 2023.

Duhet theksuar se, në vitin 2023/2022, ka pothuajse një përgjysmim të masës vjetore të rritjes së tatimit mbi fitimin në vlerë nominale në krahasim me 2022/2021.
Sipas Raportit të MF (faqe 23), në nivelin e lartë të realizimit të këtij treguesi ka ndikuar dhe përfshirja e taksës speciale të energjisë elektrike në vlerën faktike prej 9,741 milion lekë, e cila nuk ka qenë më parë pjesë e kësaj strukture, si dhe kanë ndikuar të njëjtët faktor si edhe në vitin 2022: rikuperimi i ekonomisë dhe rritja e saj, performanca e mirë e të gjithë sektorëve ekonomik, si dhe forcimi i kontrollit të deklaratave bazuar në kriteret e riskut.

Gjithashtu, sipas raportit të MF, kontributin më të madh në të ardhurat nga tatimi mbi fitimin e ka dhënë sektori i shërbimeve, i ndjekur nga prodhimi, tregtia etj., megjithëse prodhimi ka rritjen më të madhe në krahasim me vitin 2022 në këtë lloj tatimi.

Nga auditimi i KLSH-së ka rezultuar se të ardhurat nga tatim fitimi realizohen më së shumti nga parapagimet e kësteve të tatimit mbi fitimit, të cilat paraqiten në vlerën rreth 40,027 milion lekë, krahasuar me 34,042 milion lekë që ishin vitin paraardhës. DPT nuk kryen nxjerrjen e rezultatit neto për çdo llogari të parapagimeve në momentin e dorëzimit të deklarimeve në fund të vitit sipas përllogaritjeve të detyrimeve faktike të tatimit mbi fitimit, si veprim rregullues për njohjen e kësaj të ardhure, problematikë kjo e konstatuar edhe në auditimet e mëparshme të KLSH.

Drejtoria e Programimit të Statistikës dhe Analizës në MF ka sqaruar se, në hartimin e projekt buxhetit, administrata tatimore nuk proceson parapagimet, pasi ato përcaktohen e vlerësohen në fillim të vitit dhe shërbejnë për analiza periodike gjatë vitit. Si përfundim, raportimi i tyre në realizimin e të ardhurave të tatimit mbi fitimin, në kushtet kur nga ana e MF konfirmohet se nuk përfshihen në planifikim, rezulton me mbi vlerësim të raportimit për këtë zë të të ardhurave.

Nga auditimi i KLSH-së në DPT ka rezultuar se, detyrimet për tatimin mbi fitimin të papaguara në fund të vitit 2023 janë 44,799 milion lekë, nga të cilat 60 % janë detyrime dhe pjesa e tjetër gjoba dhe penalitete, si dhe 48 % janë me moshë mbi 5 vjeçare, me një rritje prej 2,103 milion lekë në krahasim me vitin 2022.

2.1.3 Të ardhurat nga akcizat

Në vitin 2023 janë realizuar 58,394 milion lekë të ardhura nga akciza nga 59,000 milion lekë të programuara ose 99 %, me një mos realizim prej 606 milion lekë.
Nga auditimi në DPD është konstatuar se, realizimi i të ardhurave nga akciza është rezultat kryesisht nga rritja e sasisë së cigareve, importit të karburantit, të kafesë, birrës së importit etj., pothuajse të njëjtët faktor me vitin e kaluar, ku përfshiheshin dhe gazi lëngshëm dhe pijet alkoolike të importit. Megjithatë, importi i cigareve në vitin 2023 nuk është në nivelet më të larta të tij.

Duhet theksuar se, sipas auditimit në DPD dhe Raportit të MF, të ardhurat nga akciza në vlerën prej 2,410 milion lekë janë rezultat i ndryshimeve të paketës fiskale, çka do të thotë se të ardhurat gjithsej të akcizës të realizuara nuk janë rezultat vetëm i performancës së administratës doganore.

Të ardhurat nga akciza përbëjnë 13.8 % të të ardhurave nga tatimet dhe doganat, 9.8 % e të ardhurave tatimore, dhe 9.1 % të ardhurave publike gjithsej, si dhe 2.5 % të PBB.

Në krahasim me vitin e kaluar janë rritur këto të ardhura me 9 % ose 4,847 milion lekë.

Niveli më i lartë mujor i grumbullimit të të ardhurave nga akciza është në muajit korrik, gusht dhe dhjetor, si dhe niveli më i ulët në mars 2023.

2.1.4 Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale, sipas auditimit në MF dhe Raportit të zbatimit të buxhetit 2023 të MF, janë realizuar 57,878 milion lekë nga 56,000 milion lekë të planifikuara përfundimisht në AN nr.5 (pasi në ligjin e buxhetit ishin përcaktuar 49,000 milion lekë) ose 103 %, me rritje 1,878 milion lekë dhe kundrejt vitit të mëparshëm në masën 28.7% më shumë.

Tatimi mbi të ardhurat Personale përbën 14 % të të ardhurave nga tatimet dhe doganat, 10 % të të ardhurave tatimore dhe 9 % të të ardhura publike gjithsej.

Duhet theksuar se ritmi vjetor i rritjes në vlerë nominale 2023/2022 ka qenë dyfishi i periudhës 2022/2021.

Nga krahasimi i këtyre shifrave, me atë të Raportit vjetor 2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të auditimit të KLSH-së, konstatohet se tatimi mbi të ardhurat personale raportohet se është realizuar 57,999 milion lekë, pra 121 milion lekë më shumë, po kështu me ndryshime të dukshme dhe pasqyrimi i realizimit të këtyre të ardhurave për vitin 2022 midis këtyre dy institucioneve.

Tatimi mbi të ardhurat personale, në pjesën më të madhe përbëhet nga tatimi mbi pagë për listë pagesat në masën 58 %, tatimi mbi të ardhurat nga dividendët dhe aksionet dhe tatimi nga shitja e pasurisë së paluajtshme me nga afërsisht 10 %, etj.

Janë realizuar të gjithë zërat përbërës të tatimit mbi të ardhurat personale, me përjashtim të të ardhurave nga tatimi nga pjesëmarrësit në lojërat e fatit.

Niveli më i lartë i të ardhurave mujore nga tatimi mbi të ardhurat personale ka qenë në muajin gusht dhe niveli më i ulët në muajin shkurt 2023.

Struktura e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale ruan përgjithësisht strukturën e vitit 2022, me një rritje të përqindjes së të ardhurave nga të punësuarit e sektorit privat dhe atij publik, nga dividendët dhe aksionet etj., si dhe kanë ulje të përqindjes: tatimi nga shitja e pasurisë së paluajtshme, nga qiratë, të ardhurat nga interesat etj.

Nga auditimi i KLSH-së në DPT ka rezultuar se MF në fund të muajit tetor ka rishikuar planin mujor për periudhën paraardhëse, duke e zhvlerësuar të gjithë procesin e analizave të kryera nga DPT dhe drejtoritë rajonale, të cilat u janë referuar treguesve të planifikuar të dërguar më parë dhe për pasojë kthimin e procesit të monitorimit mbi realizimin e mbledhjes së tatimeve në një proces formal.

Gjithashtu, nga auditimi në DPT, rezulton se nga ana e saj janë raportuar vlerë e rakorduar me degën e thesarit Tiranë nga të punësuarit e sektorit buxhetor publik, kthim i tatimit nga DRT, raportim i saj për kamatëvonesat në vlerën 66.5 milion lekë dhe raportim nga ana e saj e gjobave në vlerën 55.4 milion lekë, vlera të cilat nuk përfshihen në raportimin e MF.
Veç sa më sipër, detyrimet tatimore mbi të ardhurat personale gjendje në fund të vitit 2023 kanë rezultuar në vlerën prej 2,294 milion lekë, duke u shtuar me 193 milion lekë gjatë këtij viti, nga të cilat 62 % mbi 5 vjet, si dhe 71 % e totalit e përbëjnë detyrimet dhe pjesa e tjetër janë gjoba dhe interesa.

Referuar tabelës "Detyrimet e prapambetura të gjeneruara nga moduli i SIFQ", për institucionet qendrore, të përgatitur nga MF, rezulton se janë 42.5 milion lekë të ardhura personale në stokun e detyrimeve në dhjetor 2023 të Ministrisë së Mbrojtjes (41.5) dhe Ministrisë së Brendshme (0.9), si dhe 17.1 milion lekë nga institucionet e qeverisjes vendore.

2.1.5 Taksa nacionale dhe të tjera

Të ardhurat nga taksa nacionale dhe të tjera, sipas ligjit të buxhetit 2023 kanë qenë programuar 54,300 milion lekë, me AN nr.5 kanë zbritur në 41,000 milion lekë dhe referuar auditimit të KLSH në MF dhe Raportit të përgatitur nga MF janë realizuar 40,188 milion lekë ose 98 %, me një mosrealizim prej 812 milion lekë, niveli më i ulët i realizimit faktik në tre vitet e fundit.

Referuar Raportit të përgatitur nga MF, rezulton se në strukturën e tyre janë përfshirë taksat nacionale të cilat janë atribut i mbledhjes nga DPT të programuara 37,800 milion lekë dhe të realizuara 37,297 milion lekë, si dhe *të ardhurat nga renta minerare që mblidhen nga DPD* të planifikuara 3,200 milion lekë dhe të realizuara 2,891 milion lekë. Analizuar secila prej tyre, rezulton se taksat nacionale në mosrealizimin e krijuar kanë 503 milion lekë dhe 309 milion lekë i përkasin rentës minerare, si dhe që te dyja nuk janë realizuar krahasuar me të ardhurat faktike të vitit 2022.

Ndryshe nga çfarë ka ndodhur me tatimet dhe taksat e tjera, të ardhurat nga taksa nacionale dhe të tjera janë programuar në nivel më të ulët edhe se realizimi i vitit 2022 dhe në fakt janë 4,633 milion lekë më pak të ardhura në 2023.

Të ardhurat faktike nga taksa nacionale dhe të tjera përbëjnë 9.5 % të të ardhurave nga tatimet dhe doganat, 6.7 % të të ardhurave tatimore dhe 6.2 % të të ardhurave gjithsej.

Nga auditimi në DPT ka rezultuar, se detyrimet e prapambetura tatimore gjithsej në zërin "Të tjera" në fund të vitit 2023 janë 30,295 milion lekë, me një rritje vjetore prej 863 milion lekë.

Nga auditimi në DPD ka rezultuar se, me ndryshimet e të ardhurave në AN janë ndryshuar dhe planet mujore të mbledhjes së rentës minerare për muajt paraardhës shkurt-tetor, duke sjellë për pasojë veprimtari formale në monitorimin e realizimit të të ardhurave.

2.1.6 Të ardhurat nga taksat doganore

Plani fillestar i të ardhurave nga taksat doganore ka qenë 8,500 milion lekë, i ndryshuar përfundimisht në 8,800 milion lekë dhe nga auditimi në DPD dhe Raporti i përgatitur nga MF,

rezulton se janë realizuar në fakt 9,133 milion lekë ose 104 %, me një tejkalim prej 333 milion lekë. Peshën më të madhe në taksën doganore e zënë cigaret, mishi i importit, veshjet e këmbës dhe elektroshtëpiaket, njëlloj si viti 2022 etj.

Të ardhurat nga taksat doganore janë përgjegjësi e grumbullimit të administratës doganore dhe përbëjnë 2.2 % të të ardhurave nga tatimet dhe doganat, 1.5 % e të ardhurave nga tatimet dhe 1.4 % e të ardhurave publike gjithsej, si dhe niveli më i lartë i taksës doganore të mbledhur është vërejtur në muajt maj, korrik dhe dhjetor dhe niveli më i ulët në janar 2023.

Në krahasim me vitin 2022 janë realizuar 8 % më shumë të ardhura nga taksa doganore.

2.2 Të ardhurat nga pushteti vendor

Të ardhurat nga pushteti vendor me ligjin e buxhetit janë planifikuar 29,153 milion lekë, janë ndryshuar me ulje në AN nr.5 në vlerën 27,742 milion lekë dhe sipas auditimit në MF dhe raportit të hartuar nga ana e saj, janë realizuar në fakt 31,686 milion lekë ose 114 % ose 3,944 milion lekë më shumë se programi.

Të ardhurat nga pushteti vendor përbëjnë 5.3 % të të ardhurave tatimore, 4.9 % të të ardhurave publike gjithsej, si dhe 1.5 % të PBB.

Tabela nr.5 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga pushteti vendor 2023

Në milion lekë

Nr	Emërtimi	Fakti 2022	Ligji buxhetit	AN nr.5	Fakti 2023	% realizim	Diferen
I.	**Të ardhura nga pushteti lokal**	**27,638**	**29,153**	**27,742**	**31,686**	**114**	**3,944**
a.	*Taksë mbi pasurinë (ndërtesat)*	*6,138*	*6,942*	*6,351*	*6,181*	*97*	*(170)*
b.	*Taksë mbi biznesin e vogël*	*72*	*0*	-	*60*		*60*
c.	*Taksa lokale*	*21,428*	*22,191*	*21,391*	*25,445*	*119*	*4,054*

Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

Niveli më i lartë mujor i të ardhurave nga pushteti vendor është realizuar në muajt prill dhe nëntor, dhe niveli më i ulët në janar dhe shkurt 2023.

Referuar strukturës së planifikuar të të ardhurave nga pushteti vendor rezulton se 77 % përbëhet nga të ardhurat nga taksa lokale dhe 23 % nga taksa mbi pasurinë (ndërtesat), ndërsa në fakt shtohet dhe taksa mbi biznesin e vogël e paplanifikuar. Megjithëse taksa mbi ndërtesat nuk është realizuar, ka pasur tejkalim të ndjeshëm në taksat lokale prej 19 %, duke shfaqur dhe mangësi planifikimi.

Taksa mbi biznesin e vogël (tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël dhe taksa vendore mbi biznesin e vogël) është bërë zero me ligjin nr.112/2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar", dhe për pasojë ka ardhur drejt uljes duke zënë vetëm 0.2 % të të ardhurave vendore, të cilat përfaqësojnë detyrime të paguara me vonesë.

Referuar Raportit të MF për Raportin e mesvitit të vlerësimit të situatës makroekonomike dhe fiskale për 5 mujorin e vitit 2023, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë

mbledhur të ardhura rreth 43% të planit vjetor, por rreth 1.659 milion lekë më pak ose rreth 12 % më e ulët se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2022, që tregon një performancë më të ulët se një vit më parë të kësaj periudhe.

Në krahasim me vitin 2022 janë realizuar 4,048 milion lekë më shumë, kryesisht në taksat lokale, megjithëse ritmi i rritjes vjetore të të ardhurave është 15 %, vijon të jetë nën nivelin e vitit 2021 (21 %).

Grafiku nr.4 Struktura e të ardhurave tatimore nga pushteti vendor 2023



Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

Sipas Raportit "Financat publike vendore 2023" të përgatitur nga MF, kapaciteti dhe performanca fiskale e bashkive ndryshon shumë në varësi të madhësisë së popullsisë dhe kontekstit ekonomik. Të ardhurat e veta vendore janë rritur në 38 bashki në krahasim me një vit më parë, por janë pakësuar në 23 bashki të tjera. Bashkitë me rënien më të madhe të të ardhurave të veta janë bashkitë Belsh, Skrapar, Kukës e Memaliaj (mbi 20% rënie vjetore); ndërsa bashkitë më rritjen më të madhe të të ardhurave të veta janë Poliçani dhe Pusteci.

Nga auditimet e KLSH në njësitë e vetëqeverisjes vendore, realizimi i të ardhurave gjithsej që mblidhen nga ana e tyre (përfshirë dhe të ardhurat që arkëtohen në buxhet) për vitin 2023, për 38 bashki është në nivelin 79%, deviacion që reflekton problematikë në lidhje me administrimin e taksave dhe tarifave vendore si e ardhur e munguar në buxhetet e këtyre bashkive.

Gjithashtu, ka rezultuar se në 38 njësi të vetëqeverisjes vendore vlera totale e të ardhurave të munguara, duke përfshirë pjesën e detyrimeve tatimore për vitin 2023, është në vlerën 1,160 milion lekë; ka llogaritje të pasakta të taksës së ndikimit në infrastrukturë; mangësi në drejtim të njohjes së detyrimeve për debitorët e qirave; nuk është kryer analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit Qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo ky buxhet etj.

2.3 Të ardhurat nga fondet speciale

Të ardhurat nga fondet speciale janë atribut i mbledhjes kryesisht të administratës tatimore, dhe në vlera të vogla nga ISSH dhe FSDKSH, si dhe përbëhen nga të ardhurat e kontributit të sigurimeve shoqërore, kontributit të sigurimeve shëndetësore dhe të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve.

Ligji i buxhetit 2023 kishte parashikuar të ardhura nga fondet speciale vlerën prej 128,100 milion lekë dhe më pas me AN nr.5, datë 18.10.2023 janë shtuar duke arritur 144,400 milion lekë. Sipas

MF të ardhurat nga fondet speciale janë realizuar në vlerën 144,485 milion lekë ose 100%, me 85 milion lekë mbi programin përfundimtar.

Të ardhurat e realizuara nga fondet speciale në vitin 2023 përbëjnë 24.1 % të të ardhurave tatimore dhe 22.5 % të të ardhurave publike gjithsej, si dhe 6.2 % të PBB.

Në krahasim me vitin e 2022 janë realizuar 17.6 % më shumë të ardhura nga fondet speciale ose 21,674 milion lekë më shumë, pothuajse dyfishi i rritjes së një viti më parë.

Në strukturën faktike të fondeve speciale 86.3 % e përbëjnë të ardhurat e kontributeve shoqërore, 13.2 % kontributet shëndetësore dhe 0.6 % të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve.

Niveli më i lartë i fondeve speciale të grumbulluara gjatë vitit 2023 ka qenë në muajin tetor dhe më i ulët në muajin shkurt.

Tabela nr.6 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga fondet speciale 2023

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakt 2022	Ligji buxhetit	AN nr.5	Fakt 2023	Difer	% real
I.	**Të ardhura nga fondet speciale**	**122,811**	**128,100**	**144,400**	**144,485**	**85**	**100**
a	*Sigurimi shoqëror*	*105,640*	*110,023*	*124,599*	*124,628*	*29*	*100*
b	*Sigurimi shëndetësor*	*16,266*	*17,077*	*18,801*	*19,018*	*216*	*101*
c	*Të ardhura për kompensim të pronarëve*	*905*	*1,000*	*1,000*	*839*	*(161)*	*84*

Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

2.2.1 Kontributet e Sigurimeve shoqërore

Nga auditimi në MF dhe sipas Raportit të MF mbi zbatimin e buxhetit të vitit 2023, të ardhurat nga kontributi i sigurimeve shoqërore me ligjin e buxhetit kanë qenë programuar 110,023 milion lekë, janë ndryshuar në rritje me AN nr.5 në 124,599 milion lekë dhe janë realizuar 124,628 milion lekë ose 100 %, me tejkalim 29 milion lekë.

Në krahasim me vitin 2022 janë grumbulluar 18,988 milion lekë më shumë ose + 18 %.

Niveli më i lartë mujor i kontributit të sigurimeve shoqërore të mbledhura i përket muajit tetor dhe niveli më i ulët shkurt 2023.

Mbledhja e kontributit të sigurimeve shoqërore është atribut i DPT dhe në një vlerë të vogël i përket ISSH, për kontributin shoqëror të të vetëpunësuarve në bujqësi dhe të siguruarve vullnetarisht.

Sipas auditimit të kryer nga KLSH në DPT rezulton se plani prej 121,256 milion lekë i të ardhurave për kontributin e sigurimeve shoqërore është realizuar 120,372 milion lekë ose 99.3%.

Nga auditimi në ISSH ka rezultuar se, nga 3,343 milion lekë kontribute të sigurimeve shoqërore të planifikuara, ka realizuar 4,639 milion lekë, duke zbutur ndjeshëm mos realizimin e krijuar nga DPT.

Duhet theksuar se, në raportimin e DPT në vlerën kontributeve shoqërore të mbledhura janë përfshirë dhe gjoba e kamatëvonesa, çka do të thotë se niveli i realizimit është i mbivlerësuar. Gjithashtu dhe në raportimin e të ardhurave kontributive të mbledhura nga ISSH janë përfshirë dhe të ardhura të tjera, të cilat kanë rritur nivelin e realizimit nga ana e këtij institucioni.

Referuar tabelës "Detyrimet e prapambetura të gjeneruara nga moduli i SIFQ", të përgatitur nga MF, rezultojnë detyrimet e prapambetura të sigurimeve shoqërore për institucionet e qeverisjes qendrore në vlerën gjithsej prej 154.5 milion lekë për Ministrinë e Mbrojtjes (151.4 milion lekë) dhe atë të Brendshme (3 milion lekë), në të njëjtin nivel me vitin 2022, si dhe 47.2 milion lekë për institucionet e qeverisjes vendore, me ulje në krahasim me një vit më parë (50.5 milion lekë).

2.2.2 Kontributet e Sigurimit shëndetësor

Sipas auditimit të KLSH në MF dhe Raportit të hartuar prej saj, programi i të ardhurave të kontributeve të sigurimeve shëndetësore përfundimtar me AN nr.5 ka arritur në 18,801 milion lekë, nga 17,077 milion lekë në ligjin e buxhetit dhe është realizuar 19,018 milion lekë ose 101 %, me një tejkalim prej 217 milion lekë.

Duhet theksuar se, fakti i tejkalimit të kontributit të sigurimeve shëndetësore dhe mos realizimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore, tregon më së paku mangësi në planifikimin e këtyre kontributeve nga ana e MF.

Kontributet e sigurimeve shëndetësore 99% mblidhen nga DPT, të cilat janë tejkaluar me 240 milion lekë, dhe ato që mblidhen nga ISSH janë tejkaluar 8 milion lekë. Kanë ndjekur të njëjtin trend mbledhjeje me kontributet shoqërore mujore: tetor niveli më i lartë dhe më i ulet shkurt 2023.

Në krahasim me vitin 2022, janë mbledhur 2,752 milion lekë më shumë ose + 16.9 %.

Nga auditimi në DPT për detyrimet tatimore të papaguara për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore rezultojnë në fund të vitit 2023 në vlerën prej 22,510 milion lekë, nga të cilat 50 % i përket periudhës mbi 5 vjeçare. Në vitin 2023 detyrimet tatimore të papaguara për kontributet e sigurimeve janë shtuar me 2,063 milion lekë. Duhet theksuar se, 5% e këtij detyrimi në vlerën 1,193 milion lekë i përket enteve buxhetore dhe ndërmarrjeve shtetërore, të cilat në vitin 2023 janë rritur me 25 milion lekë.

Referuar tabelës "Detyrimet e prapambetura të gjeneruara nga moduli i SIFQ", të përgatitur nga MF, për institucionet qendrore, rezultojnë detyrimet e prapambetura të sigurimeve shëndetësore për institucionet e qeverisjes qendrore 18.4 milion lekë për Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe 2.8 milion lekë për institucionet e qeverisjes vendore.

2.2.3 Fondi i kompensimit të pronarëve

Nga auditimi në MF dhe sipas Raportit të hartuar nga ana e kësaj ministrie, Fondi i kompensimit të pronarëve është realizuar 839 milion lekë nga 1,000 milion lekë, me një realizim prej 84 %, duke krijuar një diferencë prej 161 milion lekë, si dhe janë mbledhur 66 milion lekë më pak se në vitin 2022, me një tendencë në rënie nga viti në vit.

3. Të ardhurat jotatimore

Sipas auditimit të KLSH në MF dhe Raportit të hartuar prej saj, të ardhurat jotatimore në buxhetin e vitit 2023 kanë qenë programuar 23,608 milion lekë dhe janë realizuar 22,585 milion lekë, ose 95.7 %, me një mosrealizim prej 1,023 milion lekë.

Ato përbëjnë 3.5 % të të ardhurave publike gjithsej, si dhe 1 % të PBB.

Ecuria mujore e mbledhjes së të ardhurave tatimore më e lartë ka rezultuar në muajt prill dhe dhjetor dhe më i ulët në muajin shkurt 2023.

Rezulton se janë mbledhur 647 milion lekë më tepër se në vitin 2022.

Nga një analizë e detajuar e zërave përbërës të këtyre të ardhurave, sipas pasqyrës së treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar rezulton se, ndërsa është tejkaluar për 552 milion lekë zëri të tjera, nuk janë realizuar: transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë për 1,000 milion lekë; dividenti për 252 milion lekë; tarifa e shërbimeve për 291 milion lekë, të ardhurat nga institucionet buxhetore për 33 milion lekë.

Nga auditimi në DPT, rezulton se ky nivel realizimi për të ardhurat jotatimore është i nënvlerësuar, pasi në realizimin e të ardhurave tatimore sipas rakordimit me degën e thesarit mbi arkëtimet në sistemin e-tax janë përfshirë edhe arkëtimet për tarifat jo tatimore si: tarifë shërbimi për përdorimin e aparateve televizive, tarifë shërbimi për kalimin e kufirit me avion etj., në shumën gjithsej prej 2,786 milion lekë, të cilat nuk kanë një plan për t'u mbledhur nga ana e tyre, gjë e cila do të sillte për pasojë realizimin dhe tejkalimin e të ardhurave jotatimore për vitin 2023.

B. PLANIFIKIMI, REALIZIMI DHE AUDITIMI I SHPENZIMEVE

Shpenzimet gjithsej me ligjin vjetor të buxhetit 2023 janë planifikuar 698,117 milion lekë, shumë e cila është ndryshuar më pas me AN nr.5, datë 18.10.2023 përfundimisht në vlerën gjithsej 705,607 milion lekë. Sipas auditimit në MF dhe pasqyrës së treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar të vitit 2023 të hartuar nga MF, rezulton se shpenzimet janë realizuar 674,857 milion lekë ose 95.6 % e planifikimit, me një mosrealizim prej 30,750 milion lekë.

Shpenzimet publike në vitin 2023 përbëjnë 29.2 % të PBB, me rënie 1.3 pikë përqindje në krahasim me vitin e mëparshëm.

Krahasuar me vitin 2022, shpenzimet e përgjithshme publike rezultojnë 3.7% më të larta ose rreth 23,842 milion lekë më shumë, rreth 40 % e rritjes vjetore 2022/2021. Gjithashtu, rezulton një nivel më i ulët i realizimit të shpenzimeve publike (nga 97.6 % në 95.6 %) në krahasim me vitin 2022, dhe në vlerë nominale është dyfishi i mosrealizimit të atij viti. Rritjen më të madhe në krahasim me vitin 2022 e kanë shpenzimet korrente me 47,048 milion lekë, kjo si rezultat i uljes së shpenzimeve të tjera; fondi i rindërtimit është më i ulët 12,673 milion lekë, financimi i huaj ulet me 4,915 milion lekë, janë dhënë hua 3,000 milion lekë për AlbControl-in etj. Pra, në vitin 2023 në krahasim me një vit më parë konstatohet rënie e ritmeve të realizimit të programit të shpenzimeve në disa zëra, rënie e ritmit vjetor të rritjes në vlerë nominale me dyfishim të mosrealizimit zbatimit të kontratave për rindërtimin, si dhe të shpenzimeve kapitale me burim të huaj financimi, duke shfaqur mangësi në veprimtarinë e administratës publike, të aftësisë prokuruese dhe zbatuese të investimeve dhe të shpenzimeve në tërësi.

Gjatë vitit 2023 rezulton se niveli më i lartë i shpenzimeve mujore është në muajin dhjetor me afërsisht 20 % të shpenzimeve vjetore, dhe niveli më i ulët në janar me 5 % të totalit vjetor.

Nga krahasimi i ritmit vjetor të kryerjes së shpenzimeve në periudhën 2021-2023 rezulton se në masë relative kanë prirje të ulen nga 9.3 % në vitin 2022 ndaj vitit 2021 në 3.6 % në vitin 2023 ndaj vitit 2022, e shoqëruar kjo dhe me përgjysmimin e vlerës nominale të rritjes në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.
Plani dhe realizimi i shpenzimeve sipas treguesve të konsoliduar fiskal të MF paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku nr.5 Struktura e shpenzimeve sipas pasqyrës së treguesve fiskal të MF për vitin 2023

Në milion lekë



Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

Nga analiza e shpenzimeve vërehen ndryshime të theksuara në ulje dhe/ose në rritje të vlerës nominale të shpenzimeve, duke nxjerrë në pah mangësitë e planifikimit dhe të realizimit të objektivave të zakonshëm dhe strategjikë të qeverisë për vitin 2023, e lidhur kjo me aftësitë parashikuese dhe saktësinë në planifikim nga analiza e marrjes në konsideratë nga ana e MF të të gjithë faktorëve që ndikojnë në të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore gjatë një vitit fiskal.

Referuar të dhënave të treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar, rezulton se në strukturën e shpenzimeve publike gjithsej për vitin 2023, shpenzimet korrente përbëjnë 81.1 %, duke u rritur në krahasim me vitin e 2022, shpenzimet kapitale 17.6 % në të njëjtin nivel, të tjera shpenzime 0.4 % me rënie po ashtu dhe fondi i shpenzuar për shpronësimet me 0.7 %.

Veç kësaj, ritmet e rritjes së shpenzimeve nuk ndjekin ritmin e rritjes së të ardhurave, pasi nga 8 % rritje e të ardhurave në 2022/2021 janë rritur në 12 % në 2023/2022, ndërkohë që shpenzimet kanë prirje që ritmet e rritjes të ulen nga 9.3 % në 3.6 %, duke ndikuar në ritmin e uljes së kërkesave për konsum nga shpenzimet publike.

1. Shpenzimet korrente

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hartimit të buxhetit që nga PBA, projektbuxheti, buxheti dhe dy aktet normative, rezulton se shpenzimet korrente kanë njohur rritje të vazhdueshme nga 522,559 milion lekë në 548,481 milion lekë në programin përfundimtar të përcaktuar me Akte Normative.

Sipas auditimit në MF dhe Raportit të saj, shpenzimet korrente janë realizuar 547,039 milion lekë ose 99.7 %, me një mosrealizim prej 1,442 milion lekë dhe përbëjnë 81.1 % të shpenzimeve publike, si dhe 23.7 % të PBB.

Shpenzimet korrente nivelin mujor më të lartë e kanë njohur në dhjetor dhe nivelin më të ulët në janar 2023.

Në krahasim me vitin 2022, janë realizuar 47,048 milion lekë më shumë ose 9.4 %. Gjithashtu, shpenzimet korrente kanë shfaqur tendencë rritje në përbërjen e shpenzimeve publike gjithsej nga 77% në 81 %, duke vijuar me trendin e nisur që nga viti 2021.

Shpenzimet korrente kategorizohen në: Shpenzimet për personelin; Shpenzimet për interesat; Shpenzimet operative mirëmbajtje; Subvencionet; Shpenzimet për fondet speciale; Shpenzimet për buxhetin vendor dhe Shpenzime të tjera, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.7 Struktura e planifikuar dhe faktike e shpenzimeve korrente 2023

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakt 2022	Plan përfund. 2023	Fakt 2023	Diferenca me planin	Realizimi ne %	Diferenca me 2022
I.	**Shpenzime korrente**	**499,989**	**548,481**	**547,033**	**(1,448)**	**99.7**	**47,044**
I.1	*Personeli*	*84,696*	*96,158*	*100,476*	*4,318*	*104.5*	*15,781*
I.2	*Interesat*	*39,624*	*56,010*	*47,591*	*(8,419)*	*85.0*	*7,967*
I.3	*Shpenzime Operative Mirëmbajtje*	*68,505*	*72,958*	*70,489*	*(2,468)*	*96.6*	*1,985*
I.4	*Subvencionet*	*1,650*	*1,607*	*1,906*	*298*	*118.6*	*256*
I.5	*Shpenzime për fonde speciale*	*216,515*	*224,751*	*226,786*	*2,035*	*100.9*	*10,271*
I.6	*Shpenzime për Buxhetin Vendor*	*58,694*	*66,473*	*68,837*	*2,364*	*103.6*	*10,143*
I.7	*Shpenzime të tjera*	*30,306*	*30,524*	*30,948*	*424*	*101.4*	*642*

Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

MF, në Raportin e përgatitur prej saj cilëson një tregues "plan përfundimtar me ndryshime shpërndarje rezervash" për shpenzimet korrente dhe disa kategori brenda tyre si: *Shpenzimet për subvencione, Shpenzimet operative mirëmbajtje* dhe *Shpenzimet e personelit; për shpenzimet per fonde speciale dhe disa kategori brenda tyre: Shpenzimet për Sigurime Shoqërore, Shpenzimet për Sigurime Shëndetësore* dhe *Shpenzimet për kompensimin e pronarëve, si dhe Shpenzimet për Papunësinë, Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë, Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politik dhe Shpenzimet për bonusin e lindjeve*.

Nga auditimi i KLSH në MF rezulton se në totalin e shpenzimeve korrente janë përfshirë edhe shpenzimet kapitale të kryera nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, për vlerën 16,559 milion lekë, duke e mbivlerësuar këtë zë.

1.1 Shpenzimet për personelin

Shpenzimet për personelin, sipas auditimit dhe treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar, në planin përfundimtar kanë qenë 96,158 milion lekë dhe janë realizuar 100,476 milion lekë ose 104.5 %, duke i tejkaluar ato me 4,318 milion lekë. Ndërsa në Raport cilësohet dhe realizimi 98.7% të planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash, por që nuk gjen pasqyrim në tabelat e treguesve të konsoliduar fiskal.

Shpenzimet për personelin përbëjnë 18.4 % të shpenzimeve korrente, 14.9 % të shpenzimeve gjithsej, si dhe 4.6 % të PBB.

Niveli mujor më i lartë i këtyre shpenzimeve është konstatuar në muajin dhjetor dhe niveli më i ulët në janar 2023.

Në krahasim me vitin 2022, për personelin janë shpenzuar më shumë 15,781 milion lekë, e lidhur dhe me efektin financiar të rritjes së nivelit të pagave sipas VKM-ve përkatëse, ritmi vjetor më i lartë i rritjes së pagave në 15 vitet e fundit. Rreth 1/3 e shpenzimeve korrente të cilat janë shpenzuar më shumë se viti i 2022 i përkasin personelit për paga dhe kontribute. Megjithëse numri i punonjësve të planifikuar gjithsej në njësitë e qeverisjes qendrore në vitin 2023 ka qenë 83,688, ky tregues nuk është realizuar për 7,076 punonjës ose 8.5 % më pak se planifikimi, në

një kohë që rritet numri i punonjësve të planifikuar në krahasim me vitin 2022 (me 683 punonjës) dhe në fakt bie numri i të punësuarve (- 324).

Me Aktin Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023, i ndryshuar", mbështetur në vlerësimin 11 mujor të treguesve fiskalë, është bërë rishpërndarja e një volumi prej rreth 20 miliardë lekë midis zërave të shpenzimeve buxhetore, duke cilësuar dhe nga kursimet që konsistonin kryesisht në zërat e shpenzimeve të personelit si rrjedhojë e mosplotësimit të vakancave në numrin e punonjësve.

Referuar tabelës "Numri i punonjësve sipas ministrive dhe institucioneve" 2023, që shoqëron Raportin e zbatimit të buxhetit të MF, rezulton se nga 83,688 punonjës gjithsej të planifikuar, kanë qenë në marrëdhënie pune 76,612 ose 91,5 % e punonjësve të planifikuar. Fakti që në vitin 2023 një numër i konsiderueshëm i njësive të qeverisjes qendrore nuk i kanë plotësuar strukturat e tyre për 7,076 punonjës, si dhe trajtimi i tyre nga Ministria e Financave si kursime në shpenzimet e personelit, tregon se ose ka një planifikim me mangësi të numrit të punonjësve publik ose performanca institucionale e tyre ka qenë e mangët.
Në institucionet e qeverisjes vendore numri i vakancave të punonjësve është 2,537 ose 7%, me mungesa të konsiderueshme Bashkia Korçë (229), Tiranë (219), Fier (170) etj.

Shpenzimet e personelit në plan përbëhen nga shpenzimet për pagat, për kontributet e sigurimeve, fondi i veçantë i pagave, politika të reja pagash, si dhe shpenzimet e arsimit të lartë nga të ardhurat e veta, ndërsa në fakt në pasqyrën e treguesve fiskal nuk rezultojnë të pasqyruara shpenzimet e fondit të veçantë, si dhe fondi i planifikuar për politika të reja pagash.

Megjithatë, MF në raportin e saj sqaron se Fondi "Për politika të reja pagash", i planifikuar në masën 2.3 miliard lekë në Ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023" të ndryshuar", është përdorur për përballimin e efekteve financiare të ndryshimit të nivelit të pagave, si vijon: akorduar MSHMS në masën 1,249 milionë lekë dhe akorduar MAS në masën 1,051 milionë lekë (faqe 28).
Gjithashtu, sipas raportit të MF, për përballimin e efekteve financiare shtesë si rezultat i rritjes së pagave në zbatim të VKM përkatëse, janë përdorur nga Fondi i Kontigjencës në masën 9,006.2 milion lekë (faqe 35, raporti ka gabim në shifër 9 miliard lekë në Raportin mbi përdorimin e fondit rezervë dhe fondit të kontigjencës në 9 milion lekë në Raportin e zbatimit të buxhetit).

Sipas Raportit të MF "Mbi përdorimin e fondeve rezervë të buxhetit të shtetit dhe kontigjencave gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2023", rreth 536.4 milionë lekë ose 25% e planit të Fondit Rezervë për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme është akorduar për shpenzime personeli (faqe 1).

Afër 86 % të shpenzimeve të personelit e përbëjnë shpenzimet për pagat, rreth 13 % shpenzimet për kontributet dhe pjesa e tjetër prej 1% shpenzimet e arsimit të lartë nga të ardhurat e veta, strukturë kjo e njëjtë me atë të vitit 2022.

1.2 Shpenzimet për interesat

Shpenzimet për interesa kanë qenë planifikuar 56,010 milion lekë dhe sipas auditimit të KLSH në MF dhe Raportit të saj, janë realizuar 47,591 milion lekë ose 85 %, duke ulur shpenzimet për këtë zë me 8,419 milion lekë në krahasim me programin.

Shpenzimet për interesa përbëjnë 8.7 % të shpenzimeve korrente, 7.1 % të shpenzimeve publike gjithsej, si dhe 2.2 % të PBB.

Niveli me i lartë mujor i shpenzimeve për interesa ka qenë në janar, korrik dhe tetor e nëntor, si dhe niveli më i ulët në maj dhe dhjetor 2023.

Në krahasim me vitin 2022, shpenzimet për interesa janë rritur 20.1 %, me dyfishin e ritmit të rritjes së periudhës se mëparshme, ose në vlerë nominale 7,967 milion lekë, duke sjellë për pasojë dhe rritjen e tyre në strukturën e shpenzimeve.

Në strukturën e planifikuar të shpenzimeve për interesa bëjnë pjesë kategoritë e shpenzimet për interesa të brendshme, interesa të jashtme si dhe kontigjenca për risqet e borxhit, përkatësisht 53 %, 39 % dhe 8 %. Në fakt ka rezultuar se nuk është përdorur fondi i kontigjences për risqet e borxhit prej 4,900 milion lekë, dhe raporti midis shpenzimeve për interesa të brendshme me ato të jashtme është 61 % me 39 %, njëlloj si në vitin 2022, si dhe me mosrealizim më të madh ato për interesat e jashtme.

Duhet theksuar, se që nga viti 2020 shpenzimet për interesa njohin tendencë rritjeje, më e lartë kjo kryesisht në vitet e fundit.

1.3 Shpenzimet operative mirëmbajtje

Sipas auditimit të KLSH në MF dhe treguesve të konsoliduar fiskal të përgatitur nga MF shpenzimet operative mirëmbajtje të planifikuara përfundimisht 72,958 milion lekë, janë realizuar 70,489 milion lekë ose 96.6 %, me një mosrealizim prej 2,469 milion lekë.

Shpenzimet operative mirëmbajtje përfaqësojnë 12.9 % të shpenzimeve korrente, 10.4 % të shpenzimeve publike gjithsej, si dhe përfaqësojnë 3.2 % të PBB.

Pak më shumë se 1/5 (23 %) e shpenzimeve operative për mirëmbajtje janë shpenzuar në muajin dhjetor, në një kohë që në muajin janar janë shpenzuar vetëm 2.3 % e totalit vjetor 2023, pothuajse në të njëjtat nivele si në vitin 2022.

Në krahasim me vitin 2022 janë kryer më shumë shpenzime në vlerë nominale 1,985 milion lekë ose 2.9 % më shumë, ritmi më i ulët i rritjes vjetore që nga viti 2019.

1.4 Subvencionet

Shpenzimet për subvencione të planifikuara përfundimisht për vitin 2023 janë në vlerën 1,607 milion lekë (48 milion më pak se plani i vitit të mëparshëm) janë realizuar 1,906 milion lekë ose janë tejkaluar në vlerë nominale 299 milion lekë pra + 18.6 %, niveli më i lartë që nga viti 2019 dhe me rritje të vazhdueshme që nga viti 2021.

21 % e subvencionit vjetor është shpenzuar në muajin nëntor, ndërkohë që në janar vetëm 4 %.

Në krahasim me vitin 2022 janë shpenzuar më shumë 256 milion lekë (15.5 % më shumë) për subvencione.

1.5 Shpenzimet për fondet speciale

Referuar tabelës së treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar të përgatitur nga MF, situata për shpenzimet e fondeve speciale për vitin 2023 me përbërësit e saj është si më poshtë.

Tabela nr. 8 Shpenzimet për fonde speciale dhe struktura e tyre 2023

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakt 2022	Plan përf. 2023	Fakt 2023	Diferenca	% realizimit
I.	**Shpenzime për fonde speciale**	**216,515**	**224,751**	**226,788**	**2,037**	**100.9%**
1	Sigurime Shoqërore	163,037	160,585	170,239	9,654	106.0%
2	Politika të reja pensionesh	0	3,200	0	-3,200	
3	Fond shpërblimi për pensionistët	0	3,530	0	-3,530	
4	Sigurime Shëndetësore	52,244	54,536	55,213	677	101.2%
5	Shpenzime për kompensime në vlerë të pronarëve	1,234	2,900	1,336	-1,564	-53.9%

Burimi: Të dhëna të MF

Sipas MF shpenzimet për fondet speciale janë realizuar 100.9 %: nga 224,751 milion lekë të planifikuara janë shpenzuar 226,788 milion lekë ose 2,037 milion lekë mbi planifikimin.

Shpenzimet faktike për fondet speciale përbëjnë 41.5 % të shpenzimeve korrente, 33.6 % të shpenzimeve gjithsej (pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2022 që ishte 33 %), si dhe përfaqësojnë 10.4 % të PBB.

Niveli më i lartë i shpenzimeve për fondet speciale është regjistruar në muajin dhjetor dhe më i ulëti në janar 2023.

Në krahasim me vitin 2022 janë shpenzuar më shumë për fondet speciale 10,273 milion lekë ose në masën 4.9 % më shumë, që sipas Raportit të MF, kjo është e lidhur me fondet e akorduara shtesë për shpërblimin e pensionistëve dhe mbështetjen financiare të disa kategorive të personave që përfitojnë pension invaliditeti dhe pension familjar, si dhe akordimi i fondeve shtesë për sigurimet shëndetësore për shkak të rritjes së nivelit të pagave. Duhet theksuar se vlera nominale vjetore e rritjes në 2023 pothuajse është përgjysmuar (ishte + 17,058 milion lekë) në krahasim me 2022/2021.

Në shpenzimet për fondet speciale, pjesën më të madhe e përbëjnë shpenzimet për sigurimet shoqërore 75.1%, sigurimet shëndetësore 24.3% dhe 0.6 % shpenzimet për kompensim pronarësh, në të njëjtin nivel strukturor me vitin 2022.

Pavarësisht se politikat e reja të pensioneve dhe bonusi i pensionistëve, nga MF në Raportin e treguesve të buxhetit të konsoliduar janë paraqitur me realizim zero, nga auditimi në ISSH, dhe sipas Raportit të zbatimit te buxhetit 2023 të MF, rezulton se janë përfshirë në shifrën e realizimit në total, pra nuk janë reflektuar të detajuar në tabelën raportuese.

a) Shpenzimet për sigurime shoqërore sipas Raportit të MF për vitin 2023 janë realizuar 106 %: nga 160,585 milion lekë të planifikuara (përfshirë politikat e reja të pensioneve dhe bonusin), janë

kryer shpenzime për 170,239 milion lekë, me një shtesë prej + 9,654 milion lekë, si dhe 7,200 milion lekë më shumë se në vitin 2022.

Këto shpenzime përbëjnë 31.1 % të shpenzimeve korrente, 25.2 % të shpenzimeve gjithsej, si dhe 7.8 % PBB.

Duhet theksuar se ritmet e rritjes vjetore të shpenzimeve për sigurime shoqërore në vitin 2023 janë përgjysmuar në krahasim me 2022: nga 15,007 milion lekë në 7,202 milion lekë.

Sipas treguesve fiskalë të konsoliduar të përgatitur nga MF, shpenzimet e sigurimeve shoqërore janë planifikuar 167,315 milion lekë, duke kaluar shpenzimet për politika të reja pensionesh dhe bonusin e pensionistëve tek shpenzimet për sigurime shoqërore përkatësisht 3,200 milion lekë dhe 3,530 milion lekë.
Gjithashtu, sipas treguesve fiskal te konsoliduar janar-dhjetor 2023 te përgatitur nga MF, realizimi për shpenzimet për sigurimet shoqërore është 170,239 milion lekë, dhe paraqiten të pa realizuara shpenzimet për politika të reja pensionesh dhe bonusin e pensionistëve, çka do të thotë se janë pasqyruar në zërin e mësipërm. Sipas Raportit të zbatimit të buxhetit 2023 të MF, fondi "Për politika të reja pensionesh", është përdorur në rreth 3,184 milionë lekë, si dhe "Bonusi i pensionistëve", është akorduar për MF në zbatim të VKM nr.654 datë 30.11.2023 "Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fund vitit" në vlerën 3,548 milion lekë.

MF, ka zbatuar paragrafin e fundit të nenit 14 të ligjit nr. 82/2022 " Për buxhetin e shtetit të vitit 2023 në të cilin përcaktohet: "Shumat e shpërndara nga fondi rezervë, kontigjenca dhe kontingjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11 të këtij ligji" dhe që tabela 1 ka të bëjë me "Buxheti 2023 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore" dhe tabela 4 "Treguesit fiskale të buxhetit të konsoliduar 2020-2025".
Referuar AN nr.5, datë 18.10.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", neni 4 përcakton se shpenzimet për sigurimin e detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta janë 159,912 milionë lekë dhe për sigurimin suplementar janë 7,403 milionë lekë, gjithsej 167,315 milion lekë, në të cilin janë përfshirë dhe fondi për indeksimin e pensioneve i parashikuar 3,200 milionë lekë dhe bonusi i pensionistëve në vlerën prej 3,530 milion lekë.

Referuara auditimit të KLSH në MF është konstatuar se, nga ana e saj është përgatitur plani përfundimtar me ndryshime, duke përfshirë kontigjencë për: rritjen e pagave; mbështetjen e shtresave ne nevoje, si dhe për diferencën e magjistratëve, duke arritur shpenzimet për sigurimet shoqërore sipas MF në shifrën gjithsej prej 171,327 milion lekë, mbi bazën e të cilave ka vepruar dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Referuar auditimit te KLSH në Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH) ka rezultuar se, sipas tyre ka një nivel tjetër planifikimi dhe realizimi të shpenzimeve: totali i shpenzimeve të planifikuara ka qenë 171,327 milion lekë dhe atyre të realizuara 170,238 milion lekë ose 99 %, me një mos realizim prej 1,089 milion lekë, ndryshe nga plani dhe realizimi sipas treguesve fiskal të përgatitur nga MF: planifikuar 167,315 milion lekë (përfshirë politikat e reja të pensioneve dhe bonusin), dhe janë kryer shpenzime për 170,238 milion lekë.

Për sa më sipër kundrejt planit përfundimtar, shpenzimet për sigurimet shoqërore janë realizuar në masën 98.2%, ose realizuar më pak për vlerën 1,023 milion lekë.

Nga auditimi në ISSH rezulton se burimet e financimit të shpenzimeve në fakt për vitin 2023 janë 124,618 milion lekë nga të ardhurat kontributive (73%) dhe të tjera të DPT dhe ISSH, si dhe financime nga buxheti në vlerën 46,727 milion lekë (27%), të cilat në total janë 171,345 milion lekë, shpenzuar në fakt 170,238 milion lekë, me rezultat fiskal +1,107 milion lekë. Krahasuar me vitin 2022 ka një përmirësim raporti i burimit të financimit të shpenzimeve midis të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe mbështetjes buxhetore nga 65:35 në 73 me 27.

Krahasuar me vitin 2022 financimi nga buxheti i shtetit është ulur në total në shumën 16,145 milionë lekë. Sipas auditimit të KLSH të kryer në ISSH, ulja e transfertës nga buxheti i shtetit ka ardhur si rezultat i rritjes së të ardhurave nga kontributet dhe rritjes së numrit të kontribuesve duke përmirësuar lehtë raportin kontribuues - përfitues në 1.19 nga 1,18 që ishte në 2022. Nga ana tjetër, niveli mesatar i pensioneve të reja të lidhura gjatë vitit 2023 kanë qenë ndjeshëm më i ulët se pensioni mesatar mujor në shkallë vendi.

Nga auditimi në ISSH ka rezultuar se:
- Sipas VKM nr. 187, datë 31.03.2023 "Për shpërblimin e pensionistëve për vitin 2023", efektet financiare në shumën 3,537 milion lekë, janë mbuluar nga "Fondi i kontigjencës";
- Në VKM nr. 553, datë 28.09.2023 "Për Indeksimin e pensioneve", efektet financiare në shumën 3,184 mijë lekë janë mbuluar nga fondi për politikat e indeksimit të pensioneve të parashikuara në buxhetin e Instituti i Sigurimeve Shoqërore të vitit 2023;
- Në VKM nr. 819, datë 28.12.2023 "Për shpërblimin e kategorisë së personave që përfitojnë pension invaliditeti dhe pension familjar, për vitin 2023", efektet financiare në shumën 560.5 milion lekë janë nga "Fondi i kontigjencës", i miratuar në buxhetin e vitit 2023 dhe buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023.

b) Shpenzimet për sigurime shëndetësore, sipas treguesve fiskal të MF, kanë qenë planifikuar 54,536 milion lekë dhe janë realizuar 55,213 milion lekë ose 101.2 %, me + 677 milion lekë.

Shpenzimet për sigurime shëndetësore kanë njohur nivelin më të lartë të shpenzimeve në muajin dhjetor dhe nivelin me te ulët në janar 2023.

Shpenzimet për sigurime shëndetësore përbëjnë 10.1 % të shpenzimeve korrente, 8.2 % të shpenzimeve publike gjithsej dhe 2.5 % të PBB për vitin 2023,tregues pothuajse të njëjtë me vitin 2022.

Në krahasim me vitin 2022 janë kryer më shumë 2,968 milion lekë shpenzime ose 5.7 % më shumë, me ritëm vjetor rritjeje lehtësisht më të vogël nga vitit 2022 kundrejt vitit 2021 që ishte 3,114 milion lekë.

Sipas AN nr.5, burimi i financimit të shpenzimeve janë 18,801 milion lekë nga kontributet dhe 35,735 milion lekë nga transferimet nga buxheti i shtetit, me shifrën gjithsej të shpenzimeve 54,536 milion lekë, ose në raportin 34 %:66 % kontribute/buxheti i shtetit.

Nga auditimi i KLSH në MF, rezulton se plani përfundimtar me ndryshime i hartuar nga MF ka diferenca me planin e shpenzimeve të miratuar në AN nr. 5, datë 18.10.2023 dhe për zërin e

shpenzimeve të sigurimit shëndetësor. Kështu, planit të shpenzimeve 54,536 milion lekë të AN nr.5 i janë shtuar 451 milion lekë kontigjencë për: rritjen e pagave; mbështetjen e shtresave në nevojë, si dhe për diferencën e magjistratëve dhe politika për rritje pagash, duke arritur shifrën përfundimtare të shpenzimeve prej 56,236 milion lekë.
Për sa më sipër kundrejt planit përfundimtar, shpenzimet për sigurimet shëndetësore janë realizuar në masën 98.2% dhe në vlerë nominale 55,213 milion lekë, ose realizuar më pak për vlerën 1,023 milion lekë.

Nga auditimi i KLSH të kryer në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), rezulton se burimit e financimit të shpenzimeve janë përfundimisht 18,801 milion lekë nga kontributet dhe 37,435 milion lekë transferime nga buxheti i shtetit, duke arritur shumën 56,236 milion lekë.
Sipas këtij auditimi, shpenzimet gjithsej prej 55,213 milion lekë, kanë patur burim financimi në vlerën 19,045 milion lekë të ardhurat nga kontributet, dhe 37,043 milion lekë transferimet nga buxheti i shtetit, në raportin 33:67, aq sa ka qenë e planifikuar, por me një përmirësim në krahasim me vitin 2022 që ishte 30:70.

Nga krahasimi me vitin 2022 rezulton një rritje e ndjeshme e kontributeve prej rreth 15 % dhe rritje minimale e transfertave të buxhetit të shtetit prej 1% ose në vlerë nominale 405 milion lekë.

1.6 Shpenzimet për buxhetin vendor

Sipas pasqyrës së treguesve fiskal të përgatitur nga MF, shpenzimet për buxhetin vendor kanë qenë programuar 66,473 milion lekë dhe janë realizuar 68,841 milion lekë ose 103.6 %, me një tejkalim prej 2,368 milion lekë.

Shpenzimet për buxhetin vendor përbëjnë 12.6 % të shpenzimeve korrente, 10.2% të shpenzimeve buxhetore gjithsej, si dhe 3.2 % të PBB.

Niveli më i lartë i shpenzimeve mujore të buxhetit vendor është konstatuar në muajin dhjetor dhe niveli me i ulet në janar 2023.

Në krahasim me vitin 2022, janë shpenzuar më shumë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore 10,145 milion lekë ose 17.3 % më shumë.

Nga auditimi në MF është konstatuar se plani përfundimtar për shpenzimet e buxhetit vendor rezulton të jetë në shumën 67,702 milionë lekë ose 1,229 milionë lekë më shumë se plani i parashikuar me AN nr. 6, datë 14.12.2023, nga të cilat: 1,143 milionë lekë nga fondi i kontigjencës dhe 86 milionë lekë nga rishpërndarja e fondeve. Vlera 1,143 milion lekë përbëhet: 400 milion lekë nga mbështetja financiare për rritjen e pagave për punonjësit e funksioneve të arsimit parashkollorë (edukatorë dhe punonjës së Qendrave Kulturore të Fëmijëve), për funksionin e arsimit parauniversitar, funksionin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, për funksionin e ujitjes dhe kullimit dhe për funksionin e administrimit të pyjeve); dhe 743 milion lekë mbështetje financiare nga buxheti qendror për rritjen e pagave të pushtetin vendor sipas VKM nr. 328, datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër, kundrejt planit përfundimtar të MF, shpenzimet për pushtetin vendor janë realizuar në masën 101.7 %, ose realizuar më shumë për vlerën 1,139 milion lekë.

Konstatohet se në tabelën e treguesve fiskal, shpenzimet e realizuara nga pushteti vendor janë raportuar për vlerën total, pa u specifikuar se sa janë realizimet e kryera për transfertat nga buxhetit i shtetit, të ardhurat e veta tatimore, të ardhurat e veta jo tatimore etj.

Referuar bazës së të dhënat të Drejtorisë së Financave Vendore, shpenzimet e pushtetit vendor janë realizuar në vlerën 69,232.5 milion lekë, kundrejt 68,841 milion lekë të raportuar nga Drejtoria e Thesarit në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar, me diferencë në vlerën 391.5 milion lekë. Një pjesë e diferencës, në vlerën 143 milion lekë vjen nga vlera e llogarisë 1661 "Të dala, huamarrje të tjera afatgjatë", e cila në tabelën e treguesve fiskal është përfshirë tek "Borxhi i brendshëm/Huamarrje e brendshme".

Për vitin 2023, shpenzimet korrente të buxhetit vendor janë realizuar për vlerën 52,282 milion lekë, të cilat përbëjnë 76 % të totalit të shpenzimeve faktike, ndërsa shpenzimet kapitale janë realizuar për vlerën 16,559 milion lekë ose në strukturë 24 % të totalit të shpenzimeve të realizuara nga buxheti vendor. Peshën më të madhe të shpenzimeve vendore, e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime në vlerën 29,667 milion lekë ose 43% e totalit të shpenzimeve.

Në vitin 2023 shpenzimet për personelin dhe shpenzimet për investime të pushtetit vendor rriten në secilin zë pothuajse në të njëjtën vlerë prej 4,500 milion lekë në krahasim me vitin 2022.

Në fund të vitit 2023, stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas të dhënave të MF është 4,839.3 milion lekë, nga të cilat detyrimet e prapambetura për bashkitë janë 4,752.7 milion lekë dhe për qarqet janë në shumën 86.6 milion lekë. Në krahasim me vitin e mëparshëm, stoku i detyrimeve të prapambetura është ulur për shumën 590 milion lekë, megjithatë janë disa bashki si ajo e Durrësit, Dimalit, Elbasanit, Malësisë së Madhe etj., detyrimet e prapambetura të të cilëve janë rritur në vitin 2023. Me stokun më të lartë të detyrimeve rezulton bashkia Kavajë, në shumën 793.9 milion lekë ose 16.4% e totalit të detyrimeve të prapambetura, në vijim Bashkia Tiranë, Vorë, Durrës, Pogradec etj.
Sa i përket qarqeve, stokun më të lartë të detyrimit të prapambetur e ka qarku Durrës, në shumën 40.3 milion lekë ose 46.6% e totalit dhe në vijim qarku Berat, Gjirokastër, Vlorë etj.

Stoku i detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2023, përbën rreth 13.8% të të ardhurave të veta totale të njësive të vetëqeverisjes vendore, raport ky i zvogëluar me rreth 3.6% krahasuar me një vit më parë, për shkak të uljes së detyrimeve dhe rritjes së të ardhurave të veta. Për disa bashki si Klosi, Memaliaj, Dibra, Malësia e Madhe etj., kanë një raport mjaft mbi 100% të stokut të detyrimeve të vitit 2023 ndaj të ardhurave të veta, si pasojë e kapacitetit fiskal mjaft të ulët dhe menaxhimit joefektiv të mbledhjes së të ardhurave dhe planifikimit e realizimit të shpenzimeve.

Nga auditimi i kryer në MF është konstatuar se, detyrimet e prapambetura të raportuara në fund të vitit 2022 (fillim i vitit 2023) dhe fundi i vitit 2023, krahasuar me pagesat e kryera gjatë vitit 2023 për detyrime të prapambetura (2022 dhe më parë), për disa prej tyre pagesat e kryera gjatë vitit janë më të larta se stoku i raportuar në fund të vitit 2022, si për bashkinë Bulqizë, Divjakë, Mat etj., duke sjellë për pasojë mangësi të raportimeve të sakta në këtë drejtim.

Referuar auditimit të KLSH në MF dhe raportit të Drejtorisë së Financave Vendore në lidhje me statusin e gjendjes financiare të njësive të qeverisjes vendore, bazuar në detyrimet e regjistruara në SIFQ për vitin 2023 konstatohet se 48 bashki janë klasifikuar pa probleme financiare, 8 bashki janë klasifikuar me probleme financiare (Dibër, Delvinë, Rrogozhinë, Roskovec, Devoll, Pogradec, Peqin dhe Memaliaj) dhe 5 bashki janë klasifikuar në vështirësi financiare: Klos, Cërrik, Dimal, Vorë dhe Kavajë. Situata më serioze vazhdon të paraqitet për bashkinë Vorë, ku niveli i detyrimeve të prapambetura në raport me shpenzimet vjetore faktike paraqitet në nivelin 50.9% dhe bashkinë Kavajë, raport i cili është 76.7 %. Në nivel qarku rezultojnë në vështirësi financiare ai Beratit dhe Durrësit, ku niveli i detyrimeve të prapambetura në raport me shpenzimet vjetore faktike është përkatësisht 34.8 % dhe 45.7 %.

Njësitë e qeverisjes vendore, kanë trashëguar fonde në vitin 2023, në shumën gjithsej 28,827 milionë lekë, nga të cilat: "Çelje nga buxheti", në vlerën 10,685 milionë lekë; "Të ardhurat e veta" për 18,127 milionë lekë, si dhe për investimet e huaja janë trashëguar fonde në vlerën për 15 milionë lekë.

1.7 Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera në Tabelën e treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar janë paraqitur nga MF të planifikuar në vlerën 30,524 milion lekë dhe realizuar 30,948 milion lekë ose 101.4 %, me një tejkalim prej 424 milion lekë.

Shpenzimet e tjera përbëjnë 5.7 % të shpenzimeve korrente, 4.6 % të shpenzimeve publike gjithsej si dhe 1.4 % të PBB.

Në krahasim me vitin 2022 janë shpenzuar më shumë në zërin të tjera 642 milion lekë ose + 2.1 %.

Shpenzimet e tjera përbëhen nga ndihma ekonomike, bonusi i lindjeve, kompensimi për ish të përndjekurit politik dhe pagesa e papunësisë. Me përjashtim të bonusit të lindjeve i cili është tejkaluar 1.5 herë ose 1,106 milion lekë, shpenzimet e planifikuara për treguesit e tjerë nuk janë realizuar.

Nga auditimi i KLSH në MF rezulton se në planin dhe faktin e shpenzimeve të tjera, nuk është reflektuar rritja e limitit të shpenzimeve me burim financimi nga fondi rezerve dhe fondi i kontigjencës, për këto zëra shpenzimesh.

2. Shpenzimet kapitale

Sipas pasqyrës së treguesve fiskalë të konsoliduar të përgatitur nga MF, shpenzimet kapitale (përfshirë dhe fondin e rindërtimit) kanë qenë planifikuar 135,146 milion lekë dhe janë realizuar 119,053 milion lekë ose 88 %, me një mosrealizim prej 16,094 milion lekë, siç ka ndodhur në vijimësi që këto shpenzime nuk janë realizuar plotësisht në asnjë vit buxhetor.

Duhet theksuar se, megjithëse shpenzimet kapitale nuk janë realizuar për 16,094 milion lekë, janë përdorur 779.7 milionë lekë nga fondi rezervë, duke shfaqur mangësi të planifikimit buxhetor dhe në përdorimin e fondit rezervë.

Përqindja e realizimit të shpenzimeve kapitale është 8 % më e ulët se përqindja e realizimit të shpenzimet publike gjithsej (faqe 96-88), përbëjnë 17.6 % të tyre, si dhe 5.1 % të PBB, përqindja më e ulët e katër viteve të fundit.

Niveli më i ulët i shpenzimeve kapitale gjithsej është konstatuar në muajin janar, ndërsa në muajin dhjetor janë shpenzuar 38 % e tyre. Gjashtëmujori i parë është mbyllur me realizimin e 26 % të shpenzimeve vjetore kapitale, duke cenuar ndjeshëm efektivitetin e zbatimit të kontratave publike të lidhura gjatë vitit, me pasoja në afatin, koston dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit dhe punëve publike, krahas implikimeve të tjera fiskale lidhur me likuiditetin e shtuar në tregjet financiare në fund të vitit.

Duhet theksuar se, me ligjin nr.82/2022 "Për buxhetin e vitit 2023" shpenzimet kapitale ishin planifikuar 123,908 milion lekë, me AN nr. 5, datë 18.10.2023 janë rritur duke shkuar në 136,626 milion lekë në një kohë që si 9 mujor realizimi ka qenë vetëm 46,358 milion lekë ose 70% e planit të periudhës dhe 40 % faktit vjetor, dhe MF ka vijuar me rritjen e shpenzimeve të planifikuara për këtë qëllim. AN nr.6, datë 14.12.2023, pra pas rreth dy muaj më pas i ka ulur shpenzimet kapitale në 135,145 milion lekë, duke ndryshuar dhe strukturën e tyre: financim i brendshëm në 91,826 milion lekë nga 86,063 milion lekë dhe 72,248 milion lekë (pra rritje); si dhe me burim të huaj financimi në 25,320 milion lekë nga 32,563 milion lekë dhe 45,660 milion lekë (pra në ulje).

Në krahasim me vitin 2022 janë realizuar më shumë 6,936 milion lekë ose në masën 6.2 %, por me një rënie të ndjeshme në shpenzimet për rindërtimin dhe ato kapitale me burim të huaj financimi, përkatësisht 44 % dhe 36 %.

Nga auditimi në MF ka rezultuar se, në janar 2024 janë paguar për llogari të buxhetit të vitit 2023 rreth 25 % e vlerës totale të investimeve të realizuara vjetore.

Në shpenzimet kapitale përfshihen: financim i brendshëm, financim i huaj, fondi i rindërtimit dhe investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë.

Tabela nr.9 Plani dhe realizimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2023

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	AN nr.6 përfundimtar	Realizimi	Përqindja e realizimit	Diferenca + ose -
1	**Shpenzime Kapitale**	**135,146**	**119,053**	**88**	**- 16,093**
a	*Financim i brendshëm*	*91,826*	*88,489*	*96.*	*- 3,337*
b	*Financim i huaj*	*25,320*	*13,761*	*54*	*- 11,559*
c	*Fondi i rindërtimit*	*17,000*	*16,201*	*95*	*- 799*
d	*Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë*	*1,000*	*602*	*60*	*- 398*

Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

Duke analizuar shpenzimet kapitale sipas burimit të financimit, rezulton se krahas mosrealizimit të investimeve kapitale me burim të brendshëm, financimet e huaja janë realizuar vetëm 54 % dhe në vlerë nominale 4,915 milion lekë më pak se viti 2022, vlera më e ulët e 15 viteve të fundit. Kjo tregon se ministritë e linjës nuk kanë paraqitur një planifikim të saktë për projektet

me financim të huaj, si dhe nuk kanë marrë në konsideratë procedurat që aplikohen për këto projekte, duke sjellë vonesa e mosrealizimin në afat të tyre.

Sipas raportit për zbatimin e buxhetit të përgatitur nga Ministria e Financave nuk evidentohen problematika në shpenzimet kapitale me burim të huaj financimi, megjithëse nuk janë realizuar në nivel të konsiderueshëm, si dhe 54 % e këtyre shpenzimeve janë kryer në muajt nëntor-dhjetor 2023.

Nga auditimi i ushtruar në MF ka rezultuar se, janë paguar detyrime të prapambetura për investime nga 79 institucione të qeverisjes qendrore në vlerën 6,791 milionë lekë, ose rreth 7.7 % të investimeve kapitale me financim të brendshëm, duke deformuar treguesin e vëllimit të investimeve të realizuar për vitin fiskal 2023.
Gjithashtu, është konstatuar se, janë raportuar në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar investime kapitale me financim të brendshëm të realizuara nga të ardhurat dytësore në vlerën për 1,176 milion lekë, investime që nuk kanë plan buxheti të miratuar.
Krahas këtyre, konstatohet se në shpenzimet kapitale janë përfshirë edhe shpenzimet operative dhe transfertat ndaj të tretëve të kryera nga njësitë e qeverisjes vendore për fondin e rindërtimit në vlerën 2,507 milion lekë.
Në 17 projekte me burim financimi të ardhurat e arsimit të lartë, në vlerën 57.5 milion lekë me përshkrim "Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve" në disa njësi shpenzuese, është përdorur i njëjti kod produkti, duke mos identifikuar specifikisht investimet e kryera në nivel produkti, me impakt në cilësinë e informacionit të raportuar dhe vështirësi në monitorimin e ecurisë së tyre.
Nga auditimi në MF është konstatuar se për 4 kontrata të Fondit Shqiptar të Zhvillimit në vlerën totale 1,125 milion lekë, në 6 raste është bërë parapagim i kontratave në vlerën 133 milion lekë, në kushtet që këto kontrata nuk paraqesin elementët dhe dokumentacion shoqërues për të qenë të një rëndësie të veçantë.
Nga auditimi mbi detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve të investimeve në projekte investimi përgjatë vitit është konstatuar planifikim shpenzimesh për projekte të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA 2023 - 2025; detajimin e fondeve të investimeve për vetëm vlerën e 20 % të kostos së projektit pa buxhet në vitet pasardhëse buxhetore; detajimin e planit buxhetor në tre vite për investime që përfshijnë kontrata që parashikojnë periudhë faturimi më të vogël se një vit; shkurtimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin e këtyre fondeve drejt projekteve të tjera të investimit publik; projekte të fragmentizuar në disa nënprojekte; numri i lartë i rialokimeve, për të krijuar hapësirë buxhetore për fillimin e projekteve të reja; detyrime të prapambetura apo në proces nga vitet e kaluara; mos regjistrimin e kontratave dhe rrjedhimisht mos regjistrimin e obligimit në SIFQ duke lejuar ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura etj., veprime këto të miratuara nga Ministria e Financave në detajimin fillestar të fondeve të investimit dhe/ose rialokimet e kryera përgjatë vitit.
Kanë rezultuar 3 kontrata të punimeve civile me realizim nga 3.8 % në 54 % për një periudhë kohore nga 9 deri në 16 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Për 43 projekte në vazhdim nga vitet e mëparshme nuk janë çelur fonde në fillim të vitit, por fondet janë çelur gjatë vitit.
Janë konstatuar 18 projekte me plan vjetor fillestar të lartë (mbi 100 milion) dhe realizim të ulët ose pa realizim shpenzimesh; 66 projekte ku shpenzimet faktike të realizuara janë mbi 100 milion lekë në krahasim me planin fillestar të shpenzimeve; një numër projektesh të parashikuara

për t'u paguar pas vitit 2025 (PBA 2023-2025) etj. Këto ndryshime të fondeve përgjatë vitit, në programe të ndryshme buxhetore kërkojnë një planifikim më të kujdesshëm nga ana e njësive të qeverisjes së përgjithshme, si dhe monitorim më efektiv nga ana e MF.

Investimet me financim të huaj janë realizuar në vlerën 13,761 milionë lekë, nga të cilat njësitë e qeverisjes qendrore kanë realizuar 13,235 milionë lekë dhe ato vendore 526 milionë lekë. Ashtu si edhe për shpenzimet kapitale me burim të brendshëm financimi, konstatohet se muaji me realizimin më të lartë është dhjetori, me një vlerë prej 3,940 milionë lekë, ose 28.6% të totalit të investimeve me financim të huaj të realizuara.

Nga auditimi i investimeve kapitale me financim të huaj në formë kredie, u konstatua se 3 projekte, në vlerën 874 milion lekë dhe 36 projekte (grante) në vlerën 342 milion lekë janë realizuar pa pasur plan buxhetor të miratuar me ligjin e buxhetit, akte normative apo rishikime buxhetore; 47 projekte në vlerën 776 milion lekë janë realizuar në tejkalim të planit të buxhetit të miratuar; 81 projekte në vlerën totale 1,120 milion lekë, referuar përshkrimit të projektit dhe produkteve të pritshme prej projekteve janë keq klasifikuar kryesisht në llogarinë 231 "Investime për rritjen e aktiveve afatgjata materiale".

Në lidhje me raportimet që kanë kryer Njësitë e Zbatimit të Projekteve, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për muajin Dhjetor 2023 është konstatuar se: 27 institucione kanë raportuar për financimet e huaja jashtë afatit të përcaktuar në udhëzimin përkatës; 3 institucione, për 7 projekte nuk kanë plotësuar kodin e projektit, duke e bërë të pamundur regjistrimin e disburimeve dhe shpenzimeve të këtyre projekteve në SIQF; për 4 institucione në 11 projekte nuk rakordojnë disbursimet e raportuara me shumën e nxjerrë nga llogaritë bankare të Bankës së Shqipërisë.

Nga auditimi në MF, rezulton se treguesit fiskal të buxhetit të konsoliduar të investimeve publike janë të mbivlerësuar, pasi janë përfshirë në realizim shpenzime për vendime gjyqësore në proces (ARRSH), shpenzime korrente (FSHZH) dhe bashkëfinancime për të tretë (AZHBR) me vlerë gjithsej 1,704 milion lekë.

2.1 Fondi i rindërtimit

Fondi i rindërtimit, krahas luhatjeve të ndjeshme në planifikim nga 5,000 milion lekë në ligjin e buxhetit, në 17,000 milion lekë në AN nr. 5 dhe realizimi për 9-mujorin ka qenë 5,012 milion lekë, për periudhën e mbetur 3 mujore fondi është 3.4 fishuar, nuk është arritur që të realizohen as sa viti 2022 që ishte 28,877 milion lekë, por 16,201 milion lekë, çka do të thotë rënie e ndjeshme e financimeve në planifikim dhe realizim në këtë drejtim.

Fondi i planifikuar përfundimisht për rindërtimin në vlerën 17,000 milion lekë në AN nr.5, datë 18.10.2023, sipas treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar është realizuar 16,201 milion lekë ose 95%, me një mosrealizim prej 799 milion lekë. Nga fondi i shpenzuar gjithsej, 3,717 milion lekë janë shpenzuar për qeverisjen qendrore dhe 12,484 milion lekë për qeverisjen vendore ose në raportin 23 % me 77 %.

Duke analizuar në dinamikë ecurinë e shpenzimeve për rindërtimin në vitin 2023, rezulton se, në periudhën janar-shkurt janë vetëm 50 milion lekë të paguara (muaji janar është 0 lekë), pothuajse

e njëjta situatë me vitin 2022, gjë që tregon se normalisht nuk duhet të ketë patur fatura të prapambetura për likuidim nga vitet e mëparshme. Për 9 mujorin janar-shtator janë realizuar 31 % investimit vjetor, 7 % më ulët se shpenzimet kapitale, ndërsa në dhjetor janë shpenzuar 64 % e shpenzimeve vjetore gjithsej, duke mos ruajtur shpërndarjen e tyre në mënyrë të balancuar dhe në përputhje me objektivat strategjikë.

Fondi i shpenzuar për rindërtimin përbën 13.6 % të investimeve, 2.4 % të shpenzimeve gjithsej, si dhe 0.7 % të PBB.

Fondi i shpenzuar për rindërtimin është realizuar 12,673 milion lekë më pak se në vitin 2022 dhe akoma nuk ka përfunduar, edhe pse ka pasur synim përfundimin e tij brenda gjysmës së parë të vitit 2023[6].

Nga auditimi në MF konstatohet se, në vlerën e raportuar te tabela e treguesve fiskalë janë përfshirë edhe shpenzimet për rindërtimin që janë realizuar nga të ardhurat e veta të institucioneve, në vlerën totale 73.7 milion lekë, nga të cilat 29 milion lekë nga të ardhurat e veta të njësive të qeverisjes vendore dhe 44.7 milion lekë nga të ardhurat e veta të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Veç kësaj, në investimet për rindërtimin në vlerën e realizuar nga qeverisja vendore janë përfshirë dhe 20 % shpenzime operative dhe transferta të tretëve. Pra, rezulton se MF ka mbivlerësuar në raportim shpenzimet kapitale për rindërtimin për pjesën e të ardhurave të përdoruar nga burimet e veta të institucioneve dhe shpenzime të tjera operative të njësive vendore për këtë qëllim.

Referuar VKM-vë të dala për rindërtimin, gjatë periudhës 2020-2023, konstatohet se janë miratuar 120,726 milion lekë projekte rindërtimi për qeverisjen qendrore dhe vendore dhe janë realizuar sipas raportimeve të MF deri më 31.12.2023 financime në vlerën gjithsej prej 91,298 milion lekë, gjë që do të thotë që, financimi i pritshëm për periudhat e ardhshme (viti 2024 e në vijim) mbetet rreth 29,428 milion lekë. Ndërkohë në ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, fondet për rindërtimin janë planifikuar në vlerën 7,000 milion lekë dhe për vitin 2025 është 0 lekë. Pra, rezulton se, kosto totale e projekteve të deritanishme të miratuar me VKM, nuk është mbuluar me planifikimin e fondeve buxhetore të nevojshme për rindërtimin në vitet ardhshme është rreth 22,428 milion lekë.

Mos përfundimi i procesit të rindërtimit, sjell kosto shtesë për buxhetin e shtetit edhe si rezultat i subvencionimit të qirave për familjet që banesat e tyre janë ende në proces rindërtimi, që sipas kërkesave të muajit shkurt 2023 të bashkive të dëmtuara nga tërmeti janë 8,528 familje që e përfitojnë këtë bonus. Referuar bazës së të dhënave buxhetore për vitin 2023, janë alokuar 500 milion lekë për subvencionimin e qirave dhe janë realizuar 496 milion lekë, nga të cilat rreth 1 milion lekë janë detyrime të prapambetura. Theksojmë se, Ministria e Financave ka ndërprerë financimin e subvencionimit të qirasë nga buxhetit i shtetit që nga muaji prill 2023, duke ja kaluar këtë shpenzim për financim buxhetit të bashkive.

Duhet theksuar se fondi i rindërtimit ka një rëndësi të dyfishtë pasi, përveç se vijon të mbetet një çështje emergjente që kërkon menaxhim efektiv në kohë, ka një peshë të konsiderueshme në buxhetin e shtetit. Ndryshimet e shpeshta dhe të konsiderueshme të fondit të rindërtimit në vite

[6] https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/Buxheti-per-Qytetaret-2022.pdf

dhe mungesa e mbulimit me fonde buxhetore e projekteve të miratuara evidentojnë problematika në planifikimin dhe menaxhimin e procesit të rindërtimit, duke mos pasur objektiva të qarta dhe monitorim të ecurisë së këtij procesi, me pasoja në humbjen e trajtimit emergjent në këtë rast.

3. Fondi rezervë dhe kontigjenca

Fondi rezervë, ashtu si edhe shume tregues të tjerë, ka pësuar ndryshime në planifikim në rritje 15 % nga ligji vjetor i buxhetit 2023 me akte normative të mëvonshme.

Sipas Raportit të MF "Mbi përdorimin e fondeve rezervë të buxhetit të shtetit dhe kontigjencave gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2023", dhe aneksit "ç" që shoqëron këtë raport, fondi rezervë ka qenë planifikuar 4,000 milion lekë dhe është realizuar 3,974 milion lekë sipas vendimeve të KM, ose kanë mbetur pa u shpenzuar 26 milion lekë për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pasi 1,800 milion lekë të destinuara për përballimin e kostos së zgjedhjeve për organizimin e zgjedhjeve për organet e vetëqeverisjes vendore janë akorduar plotësisht me VKM nr.38 datë 07.01.2023.
Planifikimi dhe realizimi i fondit rezervë dhe kontigjencës sipas Raportit të mësipërm jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.10 Planifikimi dhe realizimi i përdorimit të fondit rezervë dhe kontigjencës 2023

Në milion lekë

Neni	Emërtimi	Ligji i buxhetit	AN nr.5	AN nr.6	Realizimi	Diferenca
11	**Fondi rezerve dhe kontigjenca**	**15,500**	**17,200**	**18,980**	**18,943**	**(37)**
14	a) Fondi rezerve	3,500	3,800	4,000	3,974	(26)
	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	*1,700*	*2,000*	*2,200*	*2,174*	(26)
	Përballimi i kostos së zgjedhjeve	*1,800*	*1,800*	*1,800*	*1,800*	-
	b) Kontigjenca	12,000	13,400	14,980	14,969	(11)

Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

Duhet theksuar se, referuar tabelës "Treguesit fiskal sipas buxhetit të konsoliduar 2023" që shoqëron Raportin "Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2023" të Ministrisë së Financave, këta tregues raportohen me realizim 100 %, pra me diferenca në krahasim me situatën faktike të përdorimit të burimit të këtyre shpenzimeve.

Në vitin 2023, nga 18,890 milion lekë të programuara për t'u shpenzuar nga fondi rezervë dhe kontigjenca, janë akorduar 18,943 milion lekë, me fonde të mbetura prej 37 milion lekë. Janë përdorur 1,689 milion lekë fonde më pak krahasuar me vitin 2022.

Nga auditimi në MF ka rezultuar se, ndërsa në nenin 11 të ligjit të buxhetit vjetor 2023 është parashikuar fondi rezervë dhe kontigjenca, si dhe kontingjencë për risqet e borxhit, në një kohë që Ligji Organik i Buxhetit ka përcaktuar që fondi i kontingjencës krijohet për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave dhe efektet e paparashikuara të normave të interesit[7]. Fakti që të ardhurat kanë ndryshuar në rritje me AN nr.5 dhe janë realizuar 101.6 % në krahasim me ligjin vjetor të buxhetit tregon se nuk ka lindur nevoja e përdorimit të këtij fondi.

[7] Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 5

Nga të dhënat e buxhetit të vitit 2023, miratuar me ligjin 84/2022 dhe të ndryshimeve me Aktet Normative nr. 5 dhe nr.6, rezulton se, fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës duke përfshirë dhe kontigjencën për borxhin në raport me vlerën totale të fondeve të miratuara është përkatësisht 2.9 %, 3.13 % dhe 3.38 %. Masa e fondeve të cilësuara më sipër e rezultuar nga ndryshimi i buxhetit me AN nuk është në përputhje me kufirin e përcaktuar në paragrafin e dytë të nenit 5 të Ligjit Organik të Buxhetit, që "*Buxheti i Shtetit përfshin një fond rezervë dhe një fond kontingjence të pashpërndarë, i cili miratohet nga Kuvendi në ligjin të buxhetit vjetor, deri në masën 3 për qind të vlerës totale të fondeve të miratuara*".

Sipas Raportit të MF "Mbi përdorimin e fondeve rezervë të buxhetit të shtetit dhe kontigjencave gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2023" dhe auditimit të KLSH-së në këtë institucion, rezulton se fondi rezervë është akorduar me 19 vendime të KM-ve në vlerën gjithsej 2,174 milion lekë nga 2,200 milion lekë të programuara ose 99 %, ndërsa nga kjo shumë nuk janë përdorur nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme 85,5 milion lekë.
Fondi rezervë rezulton se në masën 39% është përdorur për shpenzime operative dhe transferta të brendshme/të jashtme; 36 % për shpenzime kapitale dhe 25 % për shpenzime personeli. Sipas VKM-ve, konstatohet se 25 % e këtij fondi është akorduar pas datës 26 dhjetor 2023, i cili përdoret në vitin 2024.

Nga auditimi në MF ka rezultuar se, detajimi i fondit rezervë sipas nenit 14 të ligjit vjetor të buxhetit 2023 për përballimin e kostos së zgjedhjeve vendore e denatyron qëllimin e krijimit dhe të përdorimit të këtij fondi, të përcaktuar në Ligjit Organik të Buxhetit që, fondi rezervë që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit (neni 5 i Ligjit Organik të Buxhetit).

Fakti që, 779.7 milion lekë nga fondi rezervë janë përdorur për shpenzime kapitale, pra për shpenzime të përhershme; si dhe në tre raste për shumën 223 milion lekë i janë akorduar fonde Ministrisë së Kulturës për financimin e shpenzimeve të mundshme për parashikimin e tyre në buxhetin vjetor (ndërhyrjet në urën e Matit, Festivalin Folklorik Kombëtar), si dhe mbulim shpenzimesh kapitale në Gjykatën kushtetuese, tregojnë për përdorim të fondit rezervë në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit të dytë të nenit 5 të Ligjit Organik të Buxhetit.

Gjithashtu, ka rezultuar që, megjithëse me dy VKM janë akorduar 82 milion lekë institucioneve të qeverisjes qendrore nga fondi rezervë, nuk janë përdorur prej tyre, çka tregon për mangësi në zbatimin e procedurës së miratimit si nga ana e njësisë kërkuese, ashtu edhe nga mangësitë e analizës nga MF lidhur me mungesën e argumentimit të arsyeve të mosplanifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit; për produktet, që përfitohen nga veprimtaritë, që do të financohen nga kërkesat shtesë; kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave; zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë. Veç sa më sipër, në dy raste të tjera, njësitë përfituese nuk kanë arritur të shpenzojnë 3.5 milion lekë nga fondi rezervë i buxhetit.

Sipas Raportit të MF "Mbi përdorimin e fondeve rezervë të buxhetit të shtetit dhe kontigjencave gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2023", Fondi i kontigjencës në vitin 2023 është përdorur me

anë të 21 VKM-ve në vlerën gjithsej 14,969 milion lekë nga 14,980 milion lekë të planifikuara, pra fondi i mbetur i kontigjencës është në vlerën prej 11 milion lekë.

Nga auditimi në MF, ka rezultuar që gjatë zbatimit të VKM nr. 114, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e Fondit të Kontigjencës për kompensimin financiar të rritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për çdo të punësuar me pagë minimale, për shkak të rritjes së kësaj page në shkallë vendi", në sektorët ekonomikë të nomenklaturës së veprimtarive ekonomike në industri përpunuese, bujqësi, pyje dhe peshkim kanë përfituar punonjës të sektorëve që nuk kanë qenë përcaktuar në këtë VKM si të punësuarit në spitale, të drejtorive rajonale të FSDKSH etj.

Gjithashtu, është konstatuar se, për VKM nr.238 - 245 datë 20.04.202, për miratimin e ndryshimit të nivelit të pagave dhe VKM nr.324 - 327 datë 31.05.2023, për miratimin e niveleve të reja të pagave për kategoritë e tjera të punonjësve, fondet e të cilave janë përballuar edhe nga fondi i kontigjencës, nuk kanë të përcaktuara efektet financiare në buxhet që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve, si dhe vlerën e fondeve që do të akordohen sipas institucioneve dhe nga fondet e kontigjencës, duke cenuar parimet e funksionimit të sistemit buxhetor, si atë të përgjegjësive të qarta për menaxhimin operacional, ashtu edhe transparencën për verifikimin e integritetit në mënyrë të pavarur.

Veç sa më sipër, fondi i kontigjencës është akorduar dhe përdorur për shpërblimin e pensionistëve, në vlerën 3,537 milion lekë me VKM nr.187 datë 31.03.2023, në kundërshtim me përcaktimin e paragrafit të parafundit të nenit 14 të ligjit nr.84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", që kontigjenca përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për raste të paparashikuara, ndërsa bonusi (shpërblimi) i pensionistëve është parashikuar në nenin 4 të këtij ligji në vlerën prej 3,530 milion lekë.

Fondi i Kontigjencës për risqet e borxhit i planifikuar në vlerën 4,900 milion lekë, konstatohet se nuk është përdorur gjatë vitit 2023, ashtu siç ka ndodhur dhe vitin e mëparshëm, ndonëse është programuar 100 milion lekë më shumë se në vitin 2022.

4. Risqet fiskale dhe Impakti buxhetor

Risqet fiskale janë faktorë që mund të shkaktojnë devijim nga parashikimet fiskale dhe buxhetore gjatë ciklit të buxhetit, si rrjedhojë e disa ngjarjeve të paparashikuara, të cilat mund të lindin si pasojë e supozimeve dhe zhvillimeve makroekonomike, vendimeve mbi politikën fiskale dhe/ose materializimin e detyrimeve kontingjente.

Për vitin 2023, sipas Ministrisë së Financave është vijuar me monitorimin e risqeve kryesore buxhetore që kanë të bëjnë me performancën e Ndërmarrjeve Shtetërore kryesore të cilat ndikojnë financat publike dhe buxhetin e shtetit; shpenzimeve për kontratat koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP) me mbështetje buxhetore; detyrimet e prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme; dhe detyrime të tjera kontigjente për çështjet gjyqësore ndërkombëtare.

4.1 Ndërmarrjet shtetërore.

Sipas të dhënave të INSTAT janë 30 ndërmarrje publike, nga të cilat 2 financiare, një pjesë e të cilave janë përfituese të fondeve buxhetore dhe/ose garancive shtetërore. Sipas MF, mbi bazën e ndikimit të tyre në financat publike, monitorimi është fokusuar kryesisht në performancën financiare dhe jofinanciare të tre kompanive të sektorit energjetik, si edhe në performancën financiare të disa ndërmarrjeve shtetërore me relevancë të konsiderueshme si: Ujësjellës-Kanalizime Tiranë (UKT) SHA, Hekurudha Shqiptare SHA, AlbGaz SHA, Albcontrol SHA, Albpetrol SHA dhe Posta Shqiptare SHA, krahas edhe dy entiteteve të tjera (jo me status SHA) si Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) dhe Autoriteti Portual Durrës (APD).

a) Në Raportin e zbatimit të buxhetit, cilësohet se gjatë vitit 2023, Ndërmarrjet e Sektorit Energjetik kanë shënuar një përmirësim të ndjeshëm të performancës financiare, pasi kanë pasur rezultat pozitiv më të mirë se viti 2022, rënie të nivelit të humbjeve të energjisë, rritje e nivelit të arkëtimeve në nivele relative, pasi në vlerë nominale ka rënie të arkëtimeve të OSHEE-s rreth 790 milion lekë etj. Kjo ka sjellë si pasojë që, megjithëse, në ligjin vjetor të buxhetit ishte planifikuar fondi prej 12,000 milionë lekësh për mbështetjen e sektorit energjetik, e cila më pas është hequr nga buxheti me AN nr.5, datë 18.10.2023 dhe rishpërndarja e tij fondi në zëra të tjerë të shpenzimeve publike.

Në terma të riskut fiskal, impakti i sektorit si kosto financiare apo të ardhura të munguara në financat publike për vitin 2023, vlerësohet 5,286 milion lekë nga 33,017 milion lekë në vitin 2022, vlerë e cila i referohet kryesisht garancive të paguara nga MFE në shumën 1,149 milion lekë dhe projekteve me financim të huaj të nënhuazuara në vlerën prej 4,136 milion lekë.

Gjithashtu, element i riskut fiskal të ndërmarrjeve të sektorit energjetik me peshë të konsiderueshme në financat publike janë edhe detyrimet e prapambetura të ndërsjella, si midis tyre ashtu edhe ndërmjet sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike. Megjithëse në Raportin e zbatimit të buxhetit të përgatitur nga MF, cilësohet se janë monitoruar periodikisht dhe raportohet se një pjesë e detyrimeve është shlyer sipas planit të masave për reduktimin e tyre, rezulton se këto detyrime në vitin 2023 janë rritur me 17,020 milion lekë, kryesisht të OSHEE ndaj të tjerëve dhe ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve ndaj ndërmarrjeve të sektorit energjetik. Një tregues i tillë i rritjes së detyrimeve të ndërsjella të ndërmarrjeve të sektorit energjetik dhe ndaj institucioneve të tjera me 10 % në krahasim me vitin 2022, tregon për dobësi monitorimi nga ana e Ministrisë së Financave, si dhe mangësi efikasiteti në zbatimin e Urdhrit të Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr.379/2021 datë 30.09.2021 “Mbi zbatimin e planit të masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”.

b) Ndërmarrjet e Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve, sipas Raportit të MF, edhe për vitin 2023 vijojnë me të njëjtën gjendje financiare dhe vështirësi në pagimin e detyrimeve dhe mbledhjen e të ardhurave, duke sinjalizuar probleme potenciale të likuiditetit në periudhën afatshkurtër, megjithëse Ministria e Financave ka monitoruar disa tregues kryesorë financiarë të tyre.

Për vitin 2023, buxheti i shtetit ka alokuar një vlerë totale subvencioni prej 310 milionë lekë në MIE për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve të cilat nuk arrijnë të mbulojnë

koston/shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes, subvencion 50 milion lekë më i ulët se në vitin 2022.

Një problematikë e rëndësishme mbetet edhe stoku i detyrimeve të akumuluara nga ndërmarrjet UK SHA ndaj sektorit të energjisë. Kështu, deri në dhjetor 2023, OSHEE Group SHA raporton se detyrimet e akumuluara të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve rezultojnë të jenë në vlerën rreth 30.9 miliardë lekë, nga të cilat rreth 16 miliardë lekë janë detyrime të faturuara dhe pjesa e tjetër kamatëvonesa. Në krahasim me vitin 2022, rezulton se detyrimet principale janë rritur me rreth 2 miliard lekë, me të njëjtën vlerë nominale rritje vjetore dhe 2022 kundrejt vitit 2021.

Kjo tregon se MFE dhe MIE, në vlerësimin e KLSH kanë shfaqur mangësi në zbatimin e dy urdhrave të përbashkët të viteve 2020 dhe 2021 “Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, pasi detyrimet në fund të vitit 2023 janë shtuar me 14 %. Po ashtu, nuk kanë qenë rezultative as monitorimi i MFE dhe as intensifikimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimi me institucionet dhe aktorët kryesorë të fushës: ndërmarrjet e Ujësjellës - Kanalizimeve me MIE, si dhe me ndërmarrjet e sektorit të energjisë.

Me treguesit e mësipërm, konstatohet se, Procesi i reformimit dhe riorganizimit të sektorit të Ujit nëpërmjet rigrupimit të ndërmarrjeve të ujësjellësve dhe kanalizimeve në 15 shoqëri, nuk po jep rezultatet e veta rritjen e mirëmenaxhimit dhe performancës së tyre financiare, në dobi të mbarëvajtjes së proceseve të punës, shlyerjes së detyrimeve të akumuluara dhe parandalimit të krijimit të tyre në të ardhmen.

Sipas të dhënave të MF, Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Durrës ka detyrimin ndaj OSHEE SHA në vlerën 5.46 miliard lekë pa përfshirë kamatëvonesat (+0.53 miliard lekë më shumë se në vitin 2022) ose 31 % të detyrimeve gjithsej të këtyre ndërmarrjeve, dhe me detyrimet më të larta vijojnë Ndërmarrja e Ujësjellës kanalizimeve Vlorë, Patos, Fier etj.

Nga auditimi i KLSH-së në Ministrinë e Financave, konstatohet se detyrimet e akumuluara të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve të raportuara në fund të vitit 2023 në vlerën rreth 30.9 miliardë lekë, të jenë të nënvlerësuara.

Varësia e ndërmarrjeve shtetërore të energjisë dhe të ujësjellës-kanalizimeve nga garancitë dhe kreditë e rregullta publike mbetet një burim rreziqesh fiskale. Nga auditimi i KLSH në MF është konstatuar se, në vitin 2023 janë krijuar detyrime të reja nga ndërmarrjet e sektorit energjetik si subjekte nënhuamarrëse përgjatë vitit 2023, si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve përkatëse në vlerën gjithsej 2,285 milion lekë.

4.2 Kontratat koncesionare

Pagesat vjetore për kontratat koncesionare/ PPP-të nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për vitin 2023 kanë rezultuan në shumën 12,660 milion lekë ose 2.34 % e totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2022, me vlerë prej rreth 541,340 milion lekë, duke qenë brenda kufirit të pagesave prej 5% të të këtyre të ardhurave të përcaktuar në nenin 4/2 të LOB.

Për vitin 2023 rezultojnë 11 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, në 10 prej të cilave janë realizuar pagesa faktike në vlerën prej 12,660 milion lekë nga 12,875 milion lekë të planifikuara ose pagesat e realizuara në masën 98.3 %.

Tabela nr.11 Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për koncesionet/PPP 2023

Në mijë lekë

Autoriteti Kontraktor		Emërtimi i Kontratës PPP	Fillim	Mbarim	Fakt 2022	Plan 2023	Fakt 2023	% realizim
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë		Përmirësimi, Ndërtimi, Operimi dhe Mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit	2018	2031	2,940,000	2,844,000	2,844,000	100%
		Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradës Milot – Morinë	2017	2047	740,978	666,600	666,563	100%
		Përmirësim, Ndërtim, Operim, Mirëmbajte e Rrugës Porti i Jahteve – By Pass Orikum – Dukat (Ura e Shën Elizës)	2019	2032	224,698	726,787	726,787	100%
		Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot – Balldren	2020	2033	-	-	-	-
		Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë	2023	2032	-	-	-	-
Ministria e Financave		Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë	2013	2030	1,925,903	1,541,732	1,540,310	99.9%
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale		Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë (Check-up)	2015	2025	876,083	876,090	876,083	100%
		Konçesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)	2016	2026	1,699,975	1,750,000	1,749,982	100%
		Konçesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës)	2016	2026	802,583	875,000	849,129	97%
		Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore	2020	2030	1,612,914	1,799,800	1,718,879	95.5%
Bashkia Tiranë/Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë		Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës "Për projektimin, Financimin, Ndërtimin,Mobilimin,Mirëmbajtjen,Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1 dhe për 4 objektet arsimore në zonën Tirana 4"	2018	2026	395,074	729,994	698,074	95.6%
MIE / Bashkia Tiranë		Ndërtimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike"	2017	2047	1,046,397	1,065,093	989,797	92.9%
TOTAL					**12,640,990**	**12,875,096**	**12,659,602**	

Burimi: Ministria e Financave, Autoritetet Kontraktore

Në auditimin e ushtruar në MF, KLSH bëri një analizë të ecurisë së shpenzimeve vjetore në total për periudhën 2020-2023, nga ku rezulton se janë rritur 31.4 % për 10 - 12 kontratat koncesionare me mbështetje buxhetore, për më tepër që në mungesë të treguesve të matshëm të performancës së tyre, nuk mundëson një vlerësim të qartë për arritjen në kohë të objektivave të tyre me eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet.

Grafiku nr. 6 Shpenzimet faktike për kontratat koncesionare/PPP 2020-2024

Në mijë lekë



Burimi: Të dhëna të Ministrisë së Financave të përpunuara nga KLSH

Sipas Raportit vjetor përmbledhës ecurinë dhe performancën financiare dhe jofinanciare të Kontratave të Koncesionit dhe Partneritetit Publik Privat në Republikën e Shqipërisë, të përgatitur nga MF, deri në vitin 2023 rezultojnë të nënshkruara 230 kontrata koncesionare, nga të cilat 215 janë pa mbështetje buxhetore dhe 15 me mbështetje buxhetore dhe prej këtyre të fundit janë aktive 10 kontrata koncesionare/ PPP. Ky raport shprehet se ka autoritete kontraktore që nuk janë ngritur struktura monitoruese për çdo kontratë koncesioni edhe kur kontrata specifike nuk e përcakton një strukturë të tillë, me qëllim që informacioni i raportuar pranë Ministrisë së Financave të jetë i plotë, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me përcaktimet ligjore; nuk jep detaje të mjaftueshme lidhur me ecurinë e investimeve të dakortësuara dhe zbatimin ose jo në afat të kushteve kontraktuale etj, duke shfaqur mangësi monitorimi në identifikimin, vlerësimin, matjen dhe marrjen e masave për shmangien e këtyre risqeve fiskale.

Nga auditimi në MF, rezulton se në pagesat e kontratës koncesionare "Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit" për vitin 2023 janë 1,020 milion lekë ose 36 % që i përkasin shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të vitit 2020; për kontratën "Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Orikum – Dukat" 519 milion lekë ose 71 % i përkasin shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të vitit 2021; për kontratën "Shërbimi i Skanimit në Dogana" janë 133 milion lekë ose 9 % që i përkasin detyrimeve të prapambetura të periudhës 2022.

Nga krahasimi i raportit të mes vitit me atë vjetor të zbatimit të buxhetit konstatohet se është ndryshuar plani vjetor i shpenzimeve në ulje për koncesionin "Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradës Milot – Morinë", "Përmirësim, Ndërtim, Operim, Mirëmbajte e Rrugës Porti i Jahteve – By Pass Orikum – Dukat", koncesioni i skanimit në dogana, ndërsa është rritur plani i shpenzimeve për koncesionin e ofrimit të shërbimit laboratorik spitalor dhe ndërtimi i landfillit të Tiranës, me bilanc përfundimtar rritjen me 396,492 mijë lekë.
Gjithashtu, nga analiza e ecurisë së realizimit të shpenzimeve për kontratat koncesionare në raportin e mesvitit, konstatohet se kontrata "Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Orikum – Dukat" për 5 mujorin 2023 është realizuar 9 %; "Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit" realizimi është 18 % ndërsa për "Ndërtimi i Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës" nuk është kryer asnjë pagesë, ndërkohë që për koncesionin e landfillit të Tiranës raportohet se janë paguar 70 % e totalit të pagesave.
Të gjitha sa më sipër, shfaqin nevojën e rritjes së vëmendjes së institucioneve shtetërore dhe të autoriteteve kontraktore për një planifikim të studiuar dhe monitorimin të vazhdueshëm dhe të kujdesshëm të shpenzimeve gjatë zbatimit të kontratave koncesionare.

Nga auditimi në FSDKSH, ka rezultuar se në financimin e Kontratës së Koncesionit të Kontrollit Mjekësor Bazë (Check-up), janë shpenzuar 876 milion lekë për 475,000 kontrolle të projektuara. Edhe në vitin 2023 vijojnë të kryhen pagesa për shërbim të pakryer për 6,577 raste, me një vlerë prej 12 milion lekë, ndërkohë që treguesit e shëndetit të popullatës përkeqësohen, pasi sëmundjet kronike janë shtuar me 93,776 raste, recetat e rimbursuara janë rritur me 37,407 copë, shpenzimet për rimbursimin e barnave janë rritur me 26 milion lekë apo 2,852 lekë më shumë për pacient; numri i shtrimeve në spitale është rritur me 29,927 pacientë më shumë se një vit më parë etj., të cilat tregojnë se efektet e kësaj mase profilaktike nëpërmjet këtij koncesioni, nuk janë reflektuar në uljen e sëmundshmërisë së popullatës, gjë e cila duhet t'i nënshtrohet një analize me tregues të matshëm të faktorëve dhe ndikimit të tyre.

Koncesioni i sterilizimit, i cili ofron shërbimin e furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile dhe furnizim me materiale mjekësore sterile ka marrë financime për vitin 2023 gjithsej në vlerën prej 1,750 milion lekë, 100 % të planifikimit vjetor, i cili është parashikuar në rritje edhe për vitet 2024 dhe 2025.
Konstatohet se në 8 spitale (4 spitale universitare dhe 4 spitale rajonale) ka tejkalim të numrit të ndërhyrjeve të planifikuara sipas kompleksitetit dhe mosrealizim në spitalet bashkiake, për shkak të mosfunksionim të shërbimit të kirurgjisë së pergjithshme dhe sherbimit të obsetrik gjineokologji nga mungesa e mjekeve specialistë në këto spitale.
Në krahasim me vitin 2022, konstatohet se përveç rritjes prej 3.1 % të ndërhyrjeve kirurgjikale, janë në trend rritës tre llojet e kompleksiteteve, me përparësi ndërhyrjet sipas kompleksitetit të lartë, të cilat ndikimin më të madh në shpenzimet koncesionare për shkak të çmimit lartë.
Nga auditimi i pagesave nga fillimi i koncesionit (2016) dhe deri në vitin 2023 rezulton se është shpenzuar 97 % e fondit limit të përcaktuar në Aneksin 1, Kapitulli IV.1.1 të kontratës koncesionare në një kohë që janë edhe dy vjet për mbylljen e kontratës. Sipas kontratës, nga fondi limit kanë ngelur edhe 384 milion lekë për dy vite në një kohë që shpenzimet mesatare vjetore të viteve të fundit janë mbi 1,700 milion lekë.

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, në lidhje me financimin e Kontratës Koncesionare "Për ofrimin e hemodializës", ka rezultuar se, pagesat në vlerën prej 849 milion lekë janë kryer mbi bazë e projeksionit dhe mbi projeksionit sipas rajoneve. Për vitin 2023, koncesionari është paguar për shërbim të pakryer dhe mbi projeksionin mujor për 9,241 raste nën projeksion dhe 1,557 raste mbi projeksion, në shumën gjithsej 103.5 milion lekë, për shkak se planifikimi i projeksioneve (parashikuar në kontratë) për rajonet Shkodër, Vlorë dhe Korçë nuk plotësohet, ndërsa për rajonet Lezhë dhe Elbasan tejkalohen, gjë që do të thotë se nuk është në përputhje me nevojat reale për kryerjen e shërbimit. Duhet theksuar se shpenzimet e kësaj kontrate koncesionare janë rritur 46 milion lekë.

Për kontratën koncesionare të laboratorëve, sipas FSDKSH në vitin 2023 janë shpenzuar 1,725 milion lekë (1,719 milion lekë paraqitur nga MF, pra me një diferencë 6 milion lekë më pak), 112 milion lekë më shumë se në vitin 2022. Referuar të dhënave mbi shpenzimet e kryera dhe ecurisë së planifikimit afatmesëm të buxhetit për financimin e këtij shërbimi rezulton se, vlera e tij do shkojë më tepër se parashikimi, duke kërkuar çdo vit më shumë angazhim fondesh buxhetore.
Nga analiza e të dhënave mbi numrin e ekzaminimeve dhe shpenzimeve të kryera rezulton se ka prirje për rritjen e përvitshme të ekzaminimeve me tarifa të larta, kundrejt atyre me tarifa të ulëta.

Njëlloj si edhe vitin e kaluar, kontrata koncesionare për Ndërtimin e Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës e nënshkruar në datën 17.10.2018 ndërmjet MAS dhe Bashkisë Tiranë me BOE në shumën 2,364 milion lekë, është ndërmarrë angazhimi pa fonde buxhetore për kryerjen e pagesës së kësaj shumë për shtatë vjet nga momenti i marrjes në dorëzim, regjistruar në modulin e kontratave në datën 31.05.2022 e copëzuar në vlerën 197 milion lekë.

Gjithashtu, rezulton se për dy kontrata koncesionare (Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës dhe Inceneratori i Tiranës), janë kryer pagesa nga njësia e vetëqeverisjes vendore në vlerën prej 1,268 milion lekë, të cilat janë raportuar në MF.

4.3 Detyrimet e prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme

Sipas raportit të zbatimit të buxhetit 2023 të përgatitur nga MF dhe tabelave "Detyrimet e prapambetura të gjeneruara nga moduli i SIFQ", deri në fund të muajit Dhjetor 2023 është regjistruar një stok kumulativ i detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes së përgjithshme prej 7,852 milion lekë, nga të cilat 38 % përkasin detyrimeve qendrore dhe 62 % atyre vendore.
Stoku i detyrimeve të prapambetura të raportuara në krahasim me vitin 2022 është rreth 4,347 milion lekë më i ulët ose me një rënie prej 35.6%, kryesisht në detyrimet e prapambetura qendrore, si dhe sipas këtij Raporti, vijon të mos rezultojnë detyrime për rimbursimin e TVSH-së.

Nëse detyrimet e prapambetura janë ulur për MIE, MB, MSHMS etj., nuk ka ndodhur e njëjta gjë për Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Turizmit dhe Prokurorinë e Përgjithshme për të cilat detyrimet e prapambetura janë rritur. Po kështu detyrimet e prapambetura janë rritur dhe për disa nga njësitë vendore si Durrës, Elbasan, Klos, Memaliaj, Maliq etj.

Nga analiza e strukturës së detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes qendrore rezulton se 40% i përket detyrimeve për vendime gjyqësore në pjesën më të madhe Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Shëndetësisë etj.; 31 % janë detyrime të prapambetura për investimet kryesisht në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë; 18 % të tjera me një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitin 2022, këto tek Ministria e Mbrojtjes, Ministrisë së Shëndetësisë etj.
Ndërsa tek njësitë e qeverisjes vendore 47 % e përbëjnë detyrimet e prapambetura për investime, kryesisht bashkia Vorë, Durrës, Tiranë, Dibër etj.; 25 % zëri të tjera në bashkinë Tiranë, Kavajë, Pogradec; 11 % detyrimet për shërbimet në bashkinë Kavajë, Kamëz, Pogradec etj.

Nga auditimi i kryer në Ministrinë e Financave konstatohet se në Raportin "Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2023" të MF, nuk janë paraqitur detyrimet e prapambetura të Ujësjellës-Kanalizime dhe Universiteteve, të cilat sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në MF janë gjithsej 253.2 milion lekë, duke bërë që detyrimet e prapambetura të arrijnë në fund të vitit 2023 në shumën prej 8,105.3 milion lekë.

Gjithashtu, nga testimi në SIFQ dhe raportit të pagesave të detyrimeve të prapambetura është konstatuar se, janë evidentuar 99 njësi të qeverisjes së përgjithshme që kanë raportuar pagesa më të mëdha në vlerën 5,391 milion lekë sesa pagesat faktike në SIFQ, 71 njësi që kanë raportuar

pagesa më të vogla në vlerën 9,376 milion lekë sesa pagesat faktike në SIFQ, si dhe janë 253 njësi që nuk kanë raportuar por që kanë paguar 5,423 milion lekë detyrime të prapambetura, si dhe janë 36 njësi të tjera të cilat kanë raportuar pagesën e 234 milion lekë detyrime të prapambetura, por që nuk janë në SIFQ. Nga kjo rezulton se ka diferenca raportimi midis pagesave të kryera nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe pasqyrimit të tyre në SIFQ, duke shfaqur mangësi regjistrimit në kontabilitet të detyrimeve të prapambetura nga nëpunësit zbatues, pagesa të kryera jashtë skemës së likuidimit të detyrimeve të prapambetura; mungesë evidentimi i të gjithë detyrimeve të prapambetura etj.

Nga analiza dhe testimi i të dhënat të vëna në dispozicion nga MF në lidhje me gjendjen e detyrimeve të prapambetura, duke krahasuar vlerën e raportuar të gjendjes neto për stokun më 31.12.2022, shtesave të llogaritura, pakësimeve sipas raportit të pagesave dhe pagesave sipas Thesarit, KLSH arrin në konkluzionin se ekzistojnë fatura të prapambetura të padeklaruara më parë nëpërmjet skemës së parashikuar në Udhëzimin nr. 5 datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", në vlerën 9,174 milion lekë, shumë e cila do të rriste balancën fillestare të vitit 2023.

Detyrimet e prapambetura në vitin 2023 vijojnë të jenë një fenomen shqetësues, pasi konstatohet ende nivel i lartë i stokut ekzistues dhe gjithashtu krijim i detyrimeve të reja nga institucione të ndryshme publike, pavarësisht se evidentohet një ulje e konsiderueshme nga viti i kaluar. Duke parë ecurinë gjatë tremujoreve të vitit rezulton se detyrimet e prapambetura vijnë në rritje të konsiderueshme gjatë 9-mujorit dhe zbresin ndjeshëm në tremujorin e fundit. Gjithashtu, mungesa e monitorimit, raportimit dhe e analizës së detyrimeve të prapambetura mbi kohën e krijimit, shtesat dhe pakësimet përgjatë vitit (luhatjet), transparenca mbi respektimin e parimit FIFO në shlyerje, si dhe konstatimi i parregullsive në këtë drejtim gjatë auditimit të KLSH, tregojnë se Ministria e Financave nuk ka qenë e suksesshme në monitorimin, raportimin dhe parandalimin e detyrimeve të prapambetura gjatë zbatimit të Udhëzimit nr.37 datë 06.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme".

4.4 Detyrime të tjera kontigjente për çështjet gjyqësore ndërkombëtare.
Në këtë kategori risku përfshihen Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ) çështje që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët, si dhe Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit që kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë për zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy/shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar.

a. Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)

Sipas raportit të MF gjatë vitit 2023, Këshilli i Ministrave ka miratuar 2 VKM me një vlerë totale prej rreth 5.3 milionë lekë, të cilat janë përballuar nga Fondi Rezervë i buxheti i shtetit, pasi janë detyrime mbi dhjetë mijë euro. Gjithashtu, Ministria e Financave ka ekzekutuar edhe 14 vendime të GJEDNJ, për vlerën gjithsej rreth 6.1 milionë lekë, pra gjithsej kryer pagesa për vendime të GJEDNJ 11.4 milion lekë.

MF raporton se totali i detyrimit (detyrimet sipas vendimit te gjykatës dhe kontigjenca) për 11 vendimet e GJEDNJ rezultojnë 18,082,500 euro, referuar të dhënave të Avokaturës së Shtetit 2024.

Nga ana e Avokaturës së Shtetit për periudhën janar-qershor është raportuar totali i detyrimit faktik dhe kontingjent në vlerën prej 3,675,995 euro, më i lartë se raportimi i këtij detyrimi në fund të vitit 2023, gjë që tregon për mangësi bashkëpunimi me Ministrinë e Financave, me pasoja në monitorimin e këtyre detyrimeve, me qëllim marrjen e masave për zbutjen e këtij risku fiskal.

Nga auditimi në MF, ka rezultuar se tre vendime të KM në vlerën 17,880,650 euro i përkasin viteve 2015, 2016 dhe 2018, të cilët janë në tejkalim të afatit 3 mujor dhe rrezikojnë pagesa interesi për likuidim të vonuar të vendimeve; për një çështje, MF vijon të mbajë qëndrim bllokues për projektvendimin e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë, çka do të thotë kosto financiare shtesë për buxhetin e shtetit; për një çështje tjetër nuk janë kaluar fondet në një llogari të ngurtësuar, duke riskuar për kërkesa për interesa dhe kamatëvonesa, si dhe kostot nga mosekzekutimi vullnetar (kontraktimi i përmbaruesve privat). MFE me mos ekzekutimin në afat të vendimeve gjyqësore krijojnë risk të lartë me efekte shtesë në dëm të buxhetit të shtetit, si rrjedhojë e kamatë vonesave të kërkueshme për moszbatim në afat të vendimeve të GJEDNJ-së.

b) Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit

Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë për zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy/shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar, me efekte të konsiderueshme financiare dhe për pasojë me risk të lartë për buxhetin e shtetit.

Sipas Raportit të zbatimit të zbatimit të buxhetit të MF, për vitin 2023, vlera totale e kostove të paguara nga buxheti i shtetit në kuadër të: përfaqësimit ligjor, mbrojtjes sipas shkallëve të gjykimit, shpenzimeve gjyqësore apo të tjera lidhura me vendime të arbitrazhit ndërkombëtar, ka rezultuar në vlerën 562.7 milionë lekë, në pjesën më të madhe pagesa të MF, të MIE, Autoritetit Portual Durrës, Albpetrol SHA etj. Ndërkohë nga detajimi i pagesave analitike të paraqitura në këtë raport, rezulton se vlera e paguar nga buxheti i shtetit është 582.2 milionë lekë, pra me një diferencë prej 19.5 milion lekë.

Ministria e Financave ka paraqitur një tabelë për detyrimet për vendimet e arbitrazhit ndërkombëtar për 8 institucione dhe shoqëri publike, në të cilën totali i detyrimit (detyrimi i mbetur nga vendimi i arbitrazhit/kosto ligjore dhe detyrime kontigjente) raportohet 183,252,095 euro, me shënimin që informacioni i përket muajit prill 2024 të raportuara nga Avokatura e Shtetit dhe ministritë e linjës dhe institucionet buxhetore. Fakti që tagrin e validimit të të dhënave ja kalon Avokaturës së Shtetit, Ministria e Financave ka ngelur në kuadër të rekomandimeve për forcimin e rolit negociues, pa ndikim në monitorimin dhe disiplinimin e procesit të shlyerjes financiare të përfituesve, me qëllim final lehtësimin, reduktimin dhe shmangien e barrës financiare mbi buxhetin e shtetit.

Nga auditimi në MF ka rezultuar se, sipas informacionit të depozituar nga shoqëria Albcontrol SHA, të ardhurat e realizuara nga shërbimet e ofruara nga kjo shoqëri pranë Eurocontrol janë bllokuar. Për periudhën 9 dhjetor 2020 deri 15 dhjetor 2023, fondi i akumuluar dhe bllokuar pranë Eurocontrol është në vlerën 90,539,688 Euro. Këto fonde referuar çështjes së Arbitrazhit

Ndërkombëtar parashikohet të vijojnë të jenë të bllokuara deri në mbledhjen e shumës prej 140 milion Euro, e cila sipas parashikimeve të shoqërisë mund të arrihet në muajin Mars 2025. Kjo çështje nuk është referuar as nga ana e Avokaturës së Shtetit dhe as nga ana e MF duke shtuar risqet për financat publike.

Megjithëse, Ministria e Financave ka hartuar Udhëzimin nr.35 datë 29.12.2022 "Për procedurat standarde të raportimit dhe monitorimit të risqeve fiskale nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe njësi të tjera të sektorit publik", i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2023, nuk ka arritur të hartojë dhe të publikojë Deklarata e Risqeve Fiskale për vitin 2023, si një dokument i mirëfilltë dhe gjithëpërfshirës mbi vlerësimin dhe monitorimin e risqeve fiskale që karakterizojnë menaxhimin e financave publike, në linjë me kriteret dhe rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë.

Ministria e Financave, në raportin e zbatimit të buxhetit ka paraqitur matricën e riskut me llojet e tij dhe skenarët e mundshëm (njëlloj si në 2022), por nuk ka përcaktuar masat përkatëse për zbutjen e tyre në rastet e devijimeve të tilla të mundshme. Kështu, Ministria e Financave, megjithëse evidenton ekzistencën e risqeve fiskale, nuk ka kryer një vlerësim apo matje periodike të tyre, për të mundësuar zbatimin e masave konkrete për zbutjen e risqeve fiskale.

C. DEFIÇITI BUXHETOR DHE AUDITIMI I TIJ

Defiçiti buxhetor konsiston në diferencën midis të ardhurave të shtetit dhe shpenzimeve, kur shpenzimet publike për një vit janë më të larta se të ardhurat publike, pra bilanci i financave publike është negativ.

Për vitin 2023 vijon të zbatohet neni 4/1, pika (4) i LOB që masa e defiçitit buxhetor nuk ka tejkaluar masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Sipas nenit 10 të ligjit nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", defiçiti faktik i buxhetit të shtetit nuk duhet të rezultojë më tepër se 55,498 milion lekë, i cili realizohet nëpërmjet rritjes së huamarrjes totale neto nga burime të brendshme dhe të huaja. Me aktet nr.5, datë 18.10.2023 dhe nr.6, datë 14.12.2023 ka pësuar ndryshime të konsiderueshme struktura burimit të financimit brenda kufirit të deficitit, duke shfaqur dobësi të MF në procesin e planifikimit të nënzërave të këtij treguesi.

Grafiku nr. 7 Ecuria e planifikimit dhe realizimi i deficitit 2023



Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga grupi i auditimit

Në treguesit fiskal të buxhetit konsoliduar 2023 konstatohet se defiçiti fiskal është planifikuar 55,498 milion lekë dhe është realizuar 31,180 milion lekë ose 24,318 milion lekë më pak. Në krahasim me vitin 2022, rezulton se ka një rënie në masën rreth 60 %. Kështu, bilanci buxhetor vijon të rezultojë negativ por me situatë në përmirësim, pasi defiçiti shfaqet me trend rënës, përmirësim i rezultuar kryesisht nga rritje më e lartë e të ardhurave buxhetore në krahasim me shpenzimet.

Duhet theksuar se mbështetja buxhetore është përdorur pothuajse tërësisht në muajin dhjetor dhe pak në nëntor 2023, dhe muajt e tjerë ka pasur sufiçit buxhetor për shkak se, qeveria nuk ka arritur që të kryejë shpenzimet mujore të planifikuara.

Sipas Raportit të zbatimit të buxhetit 2023 të përgatitur nga MF, defiçiti fiskal arriti në 1.3 % të PBB në vitin 2023, nga një mesatare prej afro 5.0 % në tre vitet e mëparshme.

Tabela nr. 12 Defiçiti, struktura e financimit e planifikuar dhe e realizuar 2023

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Plani	Fakti
I	**Financimi deficitit (A+B)**	**55,498**	**31,180**
A	I brendshëm (1-3)	10,431	-7,323
1	*Të ardhura nga privatizimi*	*0*	*47*
2	*Huamarrje e brendshme*	*25,000*	*20,671*
3	*Të tjera*	*-14,569*	*-28,042*
B	I Huaj (1-4)	45,067	38,503
1	*Hua afatgjatë (e marrë)*	*83,315*	*72,475*
2	*Ndryshimi i gjendjes së arkës*		*51*
3	*Ripagesat*	*-65,026*	*-53,238*
4	*Mbështetje buxhetore*	*26,779*	*19,215*

Burimi: Të dhëna të MF

Nga auditimi në MF është konstatuar se, Huamarrja e brendshme që ka shërbyer për financimin e defiçitit, ndryshe nga treguesit fiskale të konsoliduar, sipas raportimit nga Drejtoria e Përgjithshme Borxhit (DPB) paraqitet në shumën 20,812 milion lekë, e konfirmuar edhe në akt rakordimin ndërmjet strukturave të thesarit dhe strukturave të borxhit, pra me diferencë 141 milion lekë. Kjo pasi, huamarrja e pushtetit lokal publikohet e konsoliduar duke ju bashkuar vlerave të huamarrjes nacionale.

Huamarrja afatgjatë e jashtme, sipas DPB është 19,438 milionë lekë më e lartë se raportimi në pasqyrën e treguesve fiskal, e konvertuar sipas kursit të këmbimit të datës 31.12.2023 referuar Bankës së Shqipërisë në euro/lekë prej 103.88 lekë.

Në lidhje me pagesat e mbështetjes buxhetore për vitin 2023, nga auditimi në MF është konstatuar se fakti i raportuar në sistemin e DPB paraqitet më shumë për vlerën 195 milion lekë, në krahasim me raportimin në treguesit fiskalë.

Financimi i deficitit është më i ulëti nga viti 2018. Devijimet në procesin e hartimit, ekzekutimit dhe raportimit të buxhetit nga njësitë publike, si dhe vendosja e limiteve buxhetore për njohjen, raportimin dhe kryerjen e pagesave të shpenzimeve, sjellin për pasojë një nivel deficiti që nuk reflekton situatën reale buxhetore për këtë vit. Si konkluzion, raportimi i zërave në pasqyrën e konsoliduar të treguesve fiskalë, vijon të mos reflektojë saktë dhe në mënyrë të plotë nivelin real të shpenzimeve buxhetore dhe si pasojë edhe të deficitit vjetor.

D. BORXHI PUBLIK: MENAXHIMI, RAPORTIMI DHEAUDITIMI I TIJ

Sipas nenit 19 të ligjit vjetor të buxhetit të ndryshuar me AN nr.5, datë 18.10.2023, stoku i borxhit publik në vitin 2023 vlerësohet të arrijë në 1,454,139 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i përbërë 96.8 % stoku i borxhit të qeverisjes qendrore, 3.2 % stoku i borxhit të garantur nga qeverisja qendrore dhe vetëm 0.1 % stoku i borxhit të qeverisjes vendore. Duhet theksuar se, me AN nr.5 ka ndryshuar në ulje stoku i borxhit publik: është rritur stoku i qeverisjes qendrore, është ulur stoku i borxhit të garantur dhe nuk ka ndryshuar stoku i borxhit të qeverisjes vendore.
Sipas Raportit "Analiza e borxhit publik (viti 2023)" të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Shtetëror në Ministrinë e Financave, rezulton se stoku i borxhit publik për vitin 2023 është 1,362,828 milion lekë (sa 2.1 herë të ardhurat vjetore gjithsej), pra brenda kufirit të vlerësimit në ligjin e buxhetit vjetor të ndryshuar dhe përbëhet pothuajse plotësisht nga stoku i borxhit të qeverisjes qendrore (përfshirë dhe stokun e borxhit të garantuar nga qeverisja qendrore) dhe shumë pak nga stoku i borxhit të qeverisjes vendore (*rreth 101 milion lekë, dhe gjatë vitit 2023 nuk ka pasur asnjë kërkesë për huamarrje të re*), si dhe janë brenda kufijve të vendosur në ligjin e buxhetit vjetor të ndryshuar.

Duhet theksuar se, Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Shtetëror në Ministrinë e Financave ka raportime me tregues të ndryshëm për këtë qëllim midis publikimit të prillit dhe majit 2024, duke ndikuar dhe në rezultatet e analizave nga shqyrtimi i tyre.

Në krahasim me vitin 2022, stoku i borxhit ka një rënie prej 15,798 milion lekë ose 1.1 %, e reflektuar kjo në stokun e borxhit të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, me vlerë nominale vjetore rënie gati 4 herë më të madhe se sa ajo e periudhës 2022/2021.

Në vitin 2023 stoku i borxhit publik përbën 58.9 % të PBB, me një ulje prej 5.6 % në krahasim me vitin 2022 që ishte 64.5 %, ulje kjo mjaft më e vogël se ajo e periudhës 2022/2021 që ishte në masën 10 %.

Në krahasim me vitin 2022, rënia në stokun e borxhit të qeverisjes qendrore i atribuohet kryesisht rënies së stokut të borxhit të jashtëm në rreth 24,820 milion lekë, e ndikuar nga huamarrja e huaj e cila është ulur për shkak se gjatë vitit 2023 edhe pse u emetua Eurobond, niveli i mbështetjes buxhetore ishte më e ulët se vitin e kaluar, dhe gjithashtu vlera e huave të disbursuara për financimin e projekteve është më e ulët se në vitin 2022.

Nga auditimi në Ministrinë e Financave dhe Raporti i Drejtorisë së Borxhit rezulton se, ulja në terma nominal e stokut të borxhit publik gjatë vitit 2023 është në pjesën më të madhe si efekt i kursit të këmbimit në portofolin e borxhit të shprehur në valutë, i cili llogaritet me rreth 3 % të PBB, pra nga faktor që janë jashtë kontrollit menaxherial të MF. Gjithashtu, rritja nominale e PBB në raport me një vit më parë, e cila vlerësohet në rreth 178,124 milion lekë ose rreth 8% më shumë, e cila sjell si pasojë rënien relativisht të ndjeshme të stokut të borxhit publik ndaj PBB.

Sipas Raportit të zbatimit të buxhetit 2023 të MF, ecuria e borxhit publik konsiderohet përgjithësisht pozitive, duke qenë në përputhje me objektivat makro-fiskale, buxhetin e planifikuar dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB).

Sipas Raportit "Analiza e borxhit publik (viti 2023)", huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 466 miliard lekë, nga të cilat 80.3% (ose 374.1 miliard lekë nëpërmjet titujve shtetërorë të MF, nga të cilët 60 % Bono Thesari dhe 40 % obligacione) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 19.7% (ose 91.9 miliard lekë nëpërmjet emetimit nga qeveria të Eurobondit, disbursimit të huave për projekte dhe mbështetje buxhetore) nëpërmjet burimeve të huaja.

Tabela nr. 13 Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 2022-2023

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	2022	2023
1	Stoku i borxhit të brendshëm	732,654	741,778
a	*Stoku i brendshëm shtetëror*	*712,779*	*725,399*
b	*Stoku i brendshëm i garantuar*	*19,875*	*16,379*
2	Stoku i borxhit të jashtëm	645,768	620,949
a	*Stoku i jashtëm shtetëror*	*613,421*	*595,991*
b	*Stoku i jashtëm i garantuar*	*32,346*	*24,958*
	Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore (1+2)	1,378,421	1,362,727

Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

Stoku i borxhi i brendshëm, i cili është rritur rreth 2% krahasuar me vitin e mëparshëm, dominohet kryesisht nga instrumentet afatgjatë të obligacioneve me vlerë në fund të vitit 2023 në masën 70%, përkundrejt 30 % të stokut të instrumenteve afatshkurtër. Duke analizuar ecurinë e këtyre dy përbërësve konstatohet rritje e stokut të borxhit afatgjatë në masën rreth 8%, dhe ulje instrumenteve afatshkurtër me rreth 12 % totalit të stokut të bonove të thesarit. Tendenca përgjatë vitit 2023, ka shkuar në drejtim të rikompozimit të portofolit me instrumente më afatgjatë duke qenë në përputhje me objektivat strategjike afatmesëm për rritjen e maturitetit të portofolit të borxhit.
Borxhi i brendshëm i garantuar ka pësuar rënie me rreth 18 % në fund të vitit 2023, rezultat i zvogëlimit të dy garancive sovrane, konkretisht: Garancia Sovrane Nr.1 dhe Nr.2, si rezultat i pagesave të bëra nga bizneset përfituese, si dhe nuk ka pasur disbursime të reja gjate vitit 2023.

Rënia e stokut të borxhit të jashtëm në masën rreth 4 % reflekton edhe ndikimin favorizues të kursit të këmbimit. Për nga kompozimi borxhi i jashtëm shtetëror sipas tipit të instrumenteve në masën 39.5 % përbëhet nga: mbështetje buxhetore (me rritje 6 % në krahasim me 2022), 33 % kredi (me ulje 4.9 %); Eurobond 24 % (me ulje rreth 1%) dhe garanci e emetuar e BB 3.5 %.

Duhet theksuar se, nga auditimi në MF të Eurobondit është konstatuar se, është siguruar në tregjet ndërkombëtare nëpërmjet procedurës 'buyback' shuma prej 133.2 milion Euro, krahasuar me shumën e planifikuar prej 150 milion Euro në "Planin e Huamarrjes vjetore për 2023".

Gjithashtu, nga shuma prej 600 milion Euro e siguruar nëpërmjet procedurës së daljes në tregjet ndërkombëtare me Eurobond në Qershor të vitit 2023, pjesa prej 133.29 milion Euro u përdor për blerjen mbrapsht të një pjese të Eurobondit (2018) i cili maturohet në vitin 2025. Pjesa e mbetur prej 466.71 milion Euro ka kaluar si mbështetje buxhetore, për rrjedhojë nuk ka mundësuar që të ulë riskun e rifinancimit i cili është i lartë për vitin 2025, vit i cili maturohet stoku i mbetur i Eurobondit të vitit 2018 në shumën 366.71 milion Euro dhe pjesa e mbetur e një kredie nga "Deutsche Bank" prej 200 milion Euro, e siguruar në vitin 2015.

Konstatohet se ky eurobond është marrë me normë interesi 5.9 %, në një kohë që tre eurobonde-t e tjera (2018-2021) janë marrë me normë 3.5 %, dhe afat maturimi 5 vjeçar nga 7 dhe 10 që ishin më parë. Duhet theksuar se, pjesa prej 133.29 milion Euro e këtij eurobond-i është përdorur për blerjen mbrapsht të një pjese të Eurobondit (2018) i cili maturohet në vitin 2025, dhe pjesa e mbetur prej 466.71 milion Euro ka kaluar si mbështetje buxhetore, për rrjedhojë nuk ka rezultuar të jetë një procedure efektive në mënyrë të tillë që të reduktonte riskun e rifinancimit i cili është i lartë për vitin 2025.

Nga auditimi në MF lidhur me borxhin e jashtëm të garantuar ka rezultuar se, Buxheti i Shtetit për vitin 2023, ka paguar principal 2,477.92 milion lekë për rastet e garancive të huaja kur përfituesit e garancive nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre, situatë kjo e njëjtë edhe për shpenzimet e interesit, ku nga Buxheti i Shtetit janë paguar 427.38 milion lekë. Mungesa e aftësisë paguese nga njësitë përfituese të garancive edhe gjatë vitit 2023 tregon për tendencën e akumulimit të detyrimeve të tyre ndaj buxhetit të shtetit si në vitet e kaluara, mangësi kjo dhe MF për të kryer verifikimin e aftësisë paguese të huamarrësve, me veprime monitoruese për të ndjekur shlyerjen e plotë të detyrimit.

Shpenzimet për interesa përgjatë vitit 2023, kanë rezultuar në rritje në krahasim me vitin e kaluar duke shënuar vlerën prej 47,591 milion lekë, përkundrejt 39,624 milion lekë që rezultuan një vit më parë, pra një rritje prej 7,967 milion lekë ose me rreth 20%. Rritja e normave të interesit ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e kostos së borxhit publik, duke rritur treguesin e shpenzimeve buxhetore të interesave ndaj stokut të borxhit publik në 3.5 % në 2023, nga 2.9 % në 2022, duke rënduar shpenzimet publike. Duhet theksuar se shpenzimet për interesa janë më të lartat që pas vitit 1993.

Interesat e borxhit të brendshëm rezultojnë me rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2022 kryesisht të interesave të bonove të thesarit veçanërisht ato me maturim njëvjeçar, por edhe ato 3 dhe 6-mujore. Rritja e shpenzimeve për interesa nga obligacionet është më e vogël me afat maturimi 6-10 vjet dhe mbi 15 vjet, dhe me rënie për shpenzimet për interesa në obligacionet me afat maturimi nga 1 deri 5 vjet.

Shpenzimet e interesit të borxhit të jashtëm kanë ardhur në rritje në krahasim me një vit më parë në masën 24 %, ku shpenzimet për interesa për huamarrje afatgjatë nga institucionet ndërkombëtare pothuajse dyfishohen, dhe kanë një rënie të lehtë shpenzimet për interesa huamarrje afatgjate nga qeveri te huaja dhe huamarrje të tjera afatgjatë të jashtme.
Nga auditimi në MF konstatohet se, është rritur ekspozimi ndaj riskut të normave të interesit për shkak të emetimit të eurobondit në tregjet ndërkombëtare për vitin 2023, përfshirë dhe ato të viteve të kaluara, si dhe nga efektet e ndryshimit të normave bazë të interesit në tregjet ndërkombëtare për huatë të cilat janë me norma të ndryshueshme interesi, duke sjellë për pasojë riskun e pagesave të rritura aktuale dhe të pritshme për shpenzime interesi për shërbimin e borxhit të jashtëm.

Sipas Raportit “Analiza e borxhit publik (viti 2023)” të MF, kompozimi i portofolit të borxhit shtetëror sipas valutave, rezulton se pjesën më të madhe e zë monedha vendase me 54.4% të totalit, ndjekur nga EUR me 36.2 % (nga 46.8 % në 2022) dhe USD me 6.8%. Megjithëse niveli i borxhit në monedhë të huaj është mbajtur nën kufirin maksimal strategjik prej 55% ndaj totalit, sipas SAMB 2022 – 2026.

Për vitin 2023 gjendja e detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është ulur nga 19,654 milion lekë në 19,131 milion lekë, me një ulje vjetore prej (-522) milion lekë. Niveli i kthimeve nga garancitë, vlerësohet i ulët për sa i përket detyrimit për të përmbushur kushtet e marrëveshjeve përkatëse, pasi nga 25 projekte për të cilat Buxheti i Shtetit ka të drejta për të arkëtuar, përgjatë vitit 2023 janë arkëtuar vetëm për 7 prej tyre në shuma të vogla.

Niveli i kthimeve nga nënhuatë, vlerësohet i ulët për sa i përket detyrimit për të përmbushur kushtet e marrëveshjeve përkatëse nga institucionet huamarrëse, pasi nga 103 projekte për të cilat buxheti i shtetit ka të drejta për të arkëtuar, rezulton se janë krijuar detyrime të reja në vlerën prej 2,474 milionë lekë.

Nga auditimi i marrëveshjes së huasë midis MF-së dhe Albcontrol SHA nr. 23714/1 prot., datë 27.12.2023, në shumën prej 3,000 milion lekë, me një skedul shlyerje të kredisë i cili shtrihet me 3 (tre) këste të barabarta gjashtëmujore, me kështin e parë që bëhet i pagueshëm në datë 31.07.2025, rezulton se është e regjistruar në "Stokun e nënhuave në 31.12.2023". Sipas Drejtorisë së Borxhit në MF, mbi bazën e memo-s nr. 23714 prot, datë 27.12.2023 për miratim Ministrit të Financave, në lidhje me mbështetjen financiare në formën e huadhënies buxhetore për shoqërinë "Albcontrol SHA" për vitin 2023 në zbatim të Aktit Normativ nr. 6, datë 14.12.2023, është specifikuar se alokimi i këtij fondi në ligjin e rishikuar të buxhetit 2023 mbështetet në kërkesat zyrtare të adresuara në MF përmes shkresave të Albcontrol nr. 30, datë 27.09.2023 dhe nr. 2 650, datë 06.12.2023. Sipas të dhënave të Albcontrol SHA, përafërsisht gjatë periudhës 2021-2023 fondi i akumuluar dhe bllokuar pranë Eurocontrol është në vlerën 90,539,688 Euro. Që prej dhjetorit 2020 si dhe me gjasa deri në tremujorin e parë të vitit 2025, shoqëria për shkaqe të cilat nuk kushtëzohen nga menaxhimi dhe performanca e saj financiare, nuk mund të përdorë të ardhurat e realizuara pranë Eurocontrol, që janë edhe burimi primar i aktivitetit. Për pasojë, në kushtet e bllokimit të fondeve pranë Eurocontrol, projeksionet e treguesve financiarë të shoqërisë dëshmojnë vijimësinë e një gjendje likuiditeti negative.

Nga sa më sipër, konstatohet se, vlera e huasë prej 3,000 milion lekë dhënë Albcontrol SHA do të vijojë për një kohë të gjatë të jetë kosto për buxhetin e shtetit, bazuar kjo dhe në mos kryerjen e pagesës së parë të interesit deri më 31.07.2024.

E. MBI KONTABILITETIN E SEKTORIT PUBLIK, SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE MENAXHIMIN FINANCIAR, SI DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM

A. Kontabiliteti i sektorit publik dhe sistemi i raportimit financiar në institucionet e qeverisjes së përgjithshme.

KLSH në funksion të përmbushjes së rolit të saj në forcimin dhe përmirësimin e përgjegjshmërisë publike dhe llogaridhënies institucionale dhe në zbatimin e direktivave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë të datës 20.7.2023, ka realizuar vlerësimin e përgjithshëm të sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik për vitin 2023, nëpërmjet kryerjes së auditimeve financiare e të kombinuara në MF dhe njësitë e tjera të sektorit publik.
Bazuar në rezultatet e auditimeve, sistemi i përgjithshëm i kontabilitetit dhe raportimit financiar në institucionet e qeverisjes së përgjithshme ka një zbatim gradual, ku progresi ka qenë më i ngadaltë nga pritshmëritë për kalimin në sistem kontabilitetit të bazuar në të drejta dhe detyrime, dhe ende evidentohen disa mangësi, të cilat janë shprehur dhe në vlerësimin e institucioneve ndërkombëtare si SIGMA dhe BE:

a. Vonesa në hartimin dhe miratimin e Kuadrit Ligjor në fushën e kontabilitetit publik:

Rezulton se nuk janë hartuar e miratuar aktet e detyrueshme që synojnë të vendosin në zbatim Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP-të/IPSAS) mbi kontabilitetin me bazë të drejtat e detyrimet e konstatuara, që është korniza rregullatore për çdo nivel qeveritar, duke sjellë për pasojë vonesa në procesin e vënies në zbatim të këtyre standardeve.

Për më tepër, konstatohet se si pasojë e mungesës së miratimit të kuadrit rregullator për standardet kontabël, në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, struktura e thesarit nuk shqyrton apo konfirmon pasqyrat financiare për t'u siguruar mbi saktësinë dhe cilësinë e informacionit financiar, si dhe që nuk ka dublikime në transaksione apo transaksione të ndërsjellta me njësitë e varësisë.

Zbatimi i paketës së standardeve të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara SNKSP është një sipërmarrje e ndërlikuar, ndonëse ky projekt shumëfazësh ka filluar që në vitin 2018 dhe shtrihet sipas dokumenteve strategjikë deri në vitin 2027, periudhë kjo relativisht shumë e gjatë.

Përgatitja e kuadrit ligjor të kontabilitetit në bazë të drejtash dhe detyrimesh mbetet përparësi në Strategjinë e MFP-së, megjithëse për një hark kohor më të gjatë nga sa ishte parashikuar, *pasi ky objektiv ishte përfshirë edhe në strategjinë e mëparshme sektoriale*. Strategjia për menaxhimin e financave Publike 2023-2030 dhe Plani i Veprimit 2023-2026[8], në lidhje me Masën 4.2.2 "Zhvillimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për reformat e kontabilitetit" ka parashikuar objektivin që nga tremujori i katërt i vitit 2024 deri në fund të vitit 2026 të realizohet aktiviteti "*Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri të kontabilitetit publik që prezanton reformat e kontabilitetit".*

[8] Strategjia Sektoriale për Menaxhimin e Financave Publike 2023-2030 dhe Plani i Veprimit 2023-2026, miratuar me VKM nr.390, date 12.06.2024, Tiranë, 2024, (faqe 38)

b. Përgatitja dhe publikimi i pasqyrave financiare të konsoliduara për sektorin publik për vitin edhe për vitin 2023 nuk është bërë i mundur.

Në Raportin e Zbatimit të Buxhetit për vitin 2022 të depozituar në Kuvendin e Shqipërisë, KLSH ka theksuar se, "*Strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nuk kanë hartuar pasqyrat financiare përmbledhëse, të konsoliduara për sektorin publik, për periudhën objekt auditimi 1.1.2022-31.12.2022, duke mos u dhënë kështu mundësinë përdoruesve të interesuar, të brendshëm dhe të jashtëm të marrin informacion të saktë e të besueshëm si dhe të nxjerrin konkluzione të arsyeshme."*

Lidhur me përgatitjen, paraqitjen dhe miratimin e pasqyrave financiare të konsoliduara për sektorin publik për vitin 2023, evidentohet e njëjta gjendje me atë të vitit paraardhës 2022. Ndonëse kuadri nënligjor përcakton detyrimin për përgatitjen, paraqitjen dhe miratimin e pasqyrave financiare të konsoliduara, rezulton se nuk kryhet procesi i konsolidimit të pasqyrave financiare në nivel njësie mëmë dhe pasqyrimi në sistem i tyre në nivel të konsoliduar, jo vetëm në nivel NJQP, por edhe për sipërmarrje të përbashkët ku shteti ka interesa pjesëmarrje në kapital përmes konsolidimit në formën e investimeve afatgjata apo konsolidimit total në varësi të raportit të ushtrimit të ndikimit mbi vendimmarrjen për këto të fundit. Si rrjedhojë, nuk mund të ofrohet siguri mbi saktësinë dhe cilësinë e informacionit kontabël, edhe për ato raste kur ky informacion është përmbledhur në nivel grupi (ministrie, bashkie etj.), pasi në shumë raste pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore kanë shfaqur pasaktësi dhe mospërputhje. Edhe për vitin 2023, pasqyrat financiare të sektorit publik, nuk janë përshirë në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit të shtetit, të përgatitur nga ana e Ministrisë së Financave.

Problematika të ngjashme kanë vijuar të mbarten edhe gjatë vitit 2023, pasi nga auditimi në MF rezultojnë 48 njësi të cilat nuk kanë dorëzuar ose kanë dorëzuar më vonesë pasqyrat financiare individuale të tyre për t'u reflektuar më pas në SIFQ dhe për të vijuar me procedurat e konfirmimit me degët e thesarit dhe konsolidimin, duke krijuar problematika në lidhje me afatet dhe produktin përfundimtar (pasqyrat financiare të konsoliduara), në kundërshtim me përcaktimet e nenit 62 "Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit" të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar. Pasqyrat fizike individuale të dorëzuara manualisht nga institucionet buxhetore në degët e thesarit dhe pasqyrat financiare të gjeneruara elektronikisht nga SIFQ kanë diferenca në kuadër të shpenzimeve dhe të të ardhurave.

Në kuadër të mbajtjes së llogarive kontabël për pasqyrat financiare, nga auditimi rezulton se shpenzimet njihen dhe mbahen në një llogari ekstrakontabël për raportimin e tyre në grupin e llogarive 468 dhe nuk njihen në momentin e ndodhjes së tyre.

Strategjia për menaxhimin e financave Publike 2023-2030 dhe Plani i Veprimit 2023-2026 në lidhje me Shtyllën 4 "Kontabiliteti dhe monitorimi i zbatimit të buxhetit", kanë parashikuar që "*Synimi për vitin 2030 është përgatitja dhe publikimi i pasqyrave financiare (të konsoliduara) në përputhje me SNKSP, pas shtrirjes së SNKSP në të gjitha institucionet e qeverisë qendrore".*
Nga misionet e auditimit është evidentuar se nuk janë përgatitur, paraqitur e miratuar pasqyrat financiare të konsoliduara të njësive publike, veprime në kundërshtim me përcaktimet e Paragrafit nr. 20, shkronja "c", të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.2.2022, i cili ka parashikuar se:
"Konsolidimi i Pasqyrave Financiare Vjetore deri në nivelin e Qeverisjes së Përgjithshme kryhet nëpërmjet grupimit të informacionit (duke bërë eliminimet dhe mënjanuar dublimet) dhe duke kaluar nivelet e mëposhtme:

c. Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel qeverisje qendrore përfshirë të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore (ministri, institucione të tjera qendrore, fondet speciale të krijuara prej tyre, njësitë e menaxhimit dhe zbatimit të projekteve), informacionin e llogarisë qendrore të qeverisë, të llogarive të tjera speciale si dhe informacionin për borxhin qeveritar publik".

Neni 63 i ligjit nr. 9936/ 2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor " i ndryshuar, ndër të tjera ka parashikuar se "Kontrolli i Lartë i Shtetit shqyrton dhe *certifikon pasqyrat e konsoliduara vjetore* për transaksionet financiare të shtetit dhe i paraqet Kuvendit një raport të plotë për zbatimin e buxhetit të vitit të mëparshëm fiskal".

Në kushtet që nga MF nuk janë përgatitur, paraqitur e miratuar pasqyrat e konsoliduara financiare vjetore për institucionet e qeverisjes se përgjithshme, ky raport e ka të pamundur të marrë përsipër një proces të certifikimit të pasqyrave financiare.

c. Aksesi i drejtpërdrejtë dhe përdorimi i SIFQ si dhe lidhja me arkivën elektronike nga ana e institucioneve buxhetore:

Sipas analizave strukturore të kryera nga ana e Ministrisë së Financave si dhe vlerësimet e SSMFP është evidentuar *shkallë e kufizuar e shtrirjes së transaksioneve dhe balancave financiare në SIFQ*. Referuar dokumentit të Strategjisë Sektoriale të fushës, nga afërsisht 1020 Institucione Buxhetore gjithsej, vetëm 20 institucionet më të mëdha buxhetore janë të lidhura drejtpërdrejt me SIFQ, (ku bëjnë pjesë ministri, tre bashki të mëdha dhe disa institucione të tjera të mëdha publike). Institucionet e tjera buxhetore nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në SIFQ, por i dorëzojnë dokumentet e tyre kontabël në format elektronike përmes modulit të SIFQ "arkiva elektronike" pranë Degëve të Thesarit për përpunim të mëtejshëm.
Përafërsisht 300 institucione buxhetore janë të lidhura me sistemin e arkivës elektronike deri në fund të vitit 2022 dhe ministria përgjegjëse për financat ka planifikuar që numri i institucioneve buxhetore që kanë akses, të arrijë gjithsej në 642 në vitin 2023 dhe 728 në vitin 2024."[9]

d. Mungon një regjistër i konsoliduar dhe një inventar i plotë i aktiveve për njësitë e qeverisjes së përgjithshme të sektorit publik:

Regjistrimi dhe administrimi i aseteve të njësive publike ka evidentuar të ketë mangësi materiale lidhur me: plotësinë, ekzistencën, përkatësinë, si dhe pasaktësi në hartimin e regjistrit të aseteve, ç'ka përbën një faktor risku potencial në mirëadministrimin e pronës publike, krahas mungesës së një metodologjie të caktuar për matjen dhe inventarizimin e aktiveve.

II. Efektiviteti i kornizës së sistemit të kontrollit të brendshëm

Kapitulli 32 "Kontrolli financiar" i procesit të negociatave për integrimin me BE mbulon çështje të rëndësishme dhe shtyllat kryesore të ndërtimit të një sistemi financiar të shëndoshë, themelet e të cilit janë transaparenca, llogaridhënia dhe përgjegjshmëria menaxheriale. Në këtë kuadër dy raportet themelore të përgatitura nga institucionet ndërkombëtare (KE dhe BE) nënvizojnë rëndësinë e përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik.

[9] Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2023-2030 dhe Plani i Veprimit 2023-2026, Tiranë 2024, faqe 36-37.

Pyetjes se si ka evoluar dhe cili është progresi në vlerësimin e SKB të sektorit publik në vend për vitin 2023, analizuar në raport me vitet 2021 e 2022, mbështetur në raportimet e ministrisë përgjegjëse për financat, KLSH i përgjijgjet në këtë mënyrë:

Është përdorur i njëjti formulim sintaksor dhe i njëjti vlerësim apo rankim për të tre periudhat e analizuara (2021-2023) në lidhje me grupin e indikatorëve të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm publik në Shqipëri, duke u bazuar në analizën e detajuar të 17 parimeve të kontrollit të brendshëm, konkluduar nga struktura përgjegjëse me cilësimin "pjesërisht efektiv". Pra, është përdorur i njëjti rankim, për vitin 2021, 2022 dhe 2023 (trajtuar hollësisht në kapitullin e Anekseve të Raportit).

Mbi mekanizmin e vlerësimit të zbatimit të 17 parimeve te COSO mbi KB:

Në raportin që MFE ka përgatitur për vitin 2021, nga analiza e përgjigjeve të dhëna në pyetësorët e vetëvlerësimit, bazuar në vlerësimin e 17 (shtatëmbëdhjetë) parimeve rezulton se *13 (trembëdhjetë) parime janë pjesërisht efektive dhe 4 (katër) prejt tyre janë efektive,* duke theksuar nevojën për marrjen e masave konkrete për përmirësimin e gjendjes së sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në vitin 2022 raporti ka parashikuar se, nga analiza e detajuar e 17 parimeve të kontrollit të brendshëm konstatojmë se, *sistemi i kontrollit të brendshëm për vitin 2022 paraqitet pjesërisht efektiv, ku një sërë faktorësh kanë ndikuar në realizimin e ciklit të kontrollit të brendshëm*. Gjithashtu, ky vlerësim vjen si rezultat i moskonkludimit të procesit të lidhjes së objektivave strategjikë dhe operacionale si dhe detajimit të objektivave në plane konkrete veprimi duke përcaktuar linjat e qarta të përgjegjshmërisë për përmbushjen dhe raportimin e tyre nga të gjithë menaxherët.
Zhvillimi i këtij procesi përcjell impaktin e tij në planifikimin dhe dokumentimin e risqeve për të realizuar në tërësi një proces të strukturuar të menaxhimit të riskut. Ndërkohë, kufizimet në zbatimin e mekanizmave monitorues dhe vlerësues të sistemit të kontrollit të brendshëm ndikojnë në cilësinë e raportimit të informacionit duke sjellë vështirësi në trajtimin e problematikave dhe propozimin e masave korrigjuese. Pra, *2 parime me vlerësim efektiv dhe 15 pjesërisht efektiv.*

Në raportin e vitit 2023, s*ipas trajtimit që Ministria e Financave ka bërë në Raportin përmbledhës mbi gjendjen e SKB për vitin 2023, (faqe 7) cilësohet se: "*Nga analiza e detajuar e 17 parimeve të kontrollit të brendshëm konstatojmë se, sistemi i kontrollit të brendshëm për vitin 2023 paraqitet *pjesërisht efektiv*. Ky vlerësim vjen si rezultat i moskonkludimit të procesit të lidhjes së objektivave strategjikë dhe operacionale, si dhe detajimit të objektivave në plane konkrete veprimi duke përcaktuar linjat e qarta të përgjegjshmërisë për përmbushjen dhe raportimin e standardizuar të tyre nga të gjithë menaxherët.

Ndërkohë, janë marrë masa në zhvillimin e proceseve që lidhen me mjedisin e kontrollit, aktiviteteve të kontrollit dhe menaxhimin e riskut". *Pra, 13 parime me vlerësimin pjesërisht efektiv, 2 me vlerësimin efektiv dhe 2 me vlerësimin pjesërisht efektiv por shumë afër të qenit efektiv".*

Tabela nr .14 Vlerësimi i komponentëve të MFK për sistemin sipas 17 parimeve dhe 5 komponenteve.

Elementi	Vlerësimi 2021	Vlerësimi 2022	Viti 2023
Mjedisi i kontrollit	**Pjesërisht efektiv**	**Pjesërisht efektiv**	**Pjesërisht efektiv**
Parimi 1: Njësia Publike demostron angazhim për integritet dhe vlerat etike	Efektiv	Efektiv	Pjesërisht efektiv por shumë afër efektivitetit
Parimi 2: Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 3: Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 4: Njësia publike demostron angazhim në realizimin e kompetencave	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 5: Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Menaxhimi i riskut	**Pjesërisht efektiv**	**Pjesërisht efektiv**	**Pjesërisht efektiv**
Parimi 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv lehtësisht afër të qenit efektiv
Parimi 7: Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	**Efektiv**
Parimi 8: Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 9: Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	Nivele mesatare (pjesërisht efektive)
Aktivitetet e kontrollit	**Efektiv**	**Pjesërisht efektiv**	**Pjesërisht efektiv por shumë afër të qenit efektiv**
Parimi 10: Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit	Efektiv	Efektiv	Efektiv
Parimi 11: Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrolli mbi teknologjinë	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 12: Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave	**Efektiv**	**Pjesërisht efektiv**	**Pjesërisht efektiv**
Informimi dhe komunikimi	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 13: Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 14: Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm	**Efektiv**	**Pjesërisht efektiv**	**Pjesërisht efektiv**
Parimi 15: Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Monitorimi	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 16: Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 17: Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Total	**Pjesërisht efektiv**	**Pjesërisht efektiv**	**Pjesërisht efektiv**

Burimi: Të dhënat nga MF, përpunuar nga KLSH.

Bazuar në sa më sipër rezulton:

- Nga krahasimi i rezultateve të përgjithshme të vlerësimit të parametrave të komponentëve dhe parimeve të sistemit të kontrollit të brendshëm për periudhën 2012-2023 evidentohet se ky vlerësim për pesë komponentët e modelit është i njëjtë e i pa ndryshuar për tre vitet e analizuara, rankuar "Pjesërisht efektiv".
- Një komponent i modelit COSO, "Aktivitetet e Kontrollit", nga vlerësimi *"efektiv"* në vitin 2021, është vlerësuar në rënie në *"pjesërisht efektiv"* në v. 2022 dhe *"pjesërisht efektiv por shumë afër të qenit efektiv"* për v.2023.
- Vetëm 1 (një) nga 17 parimet e vlerësuara ka shënuar progres dhe paraqitet në përmirësim nga viti i kaluar, *Parimi 7: "Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave"*, ku ka kaluar nga vlerësimi pjesërisht efektiv në v. 2022 në efektiv për v. 2023. Institucionet publike vijojnë të paraqesin vështirësi në hartimin apo zbatimin e instrumentave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, (të tilla si regjistër risku, plani i menaxhimit të risqeve, manuali i proceseve të punës, gjurmë auditimi).
- Paqëndrueshmëri dhe dobësi nga ana e disa strukturave përgjegjëse të njësive publike, në lidhje me:

a-hartimin dhe dërgimin në strukturën përgjegjëse për financat të pyetësorëve të vetëvlerësimit mbi MFK

Kështu, nga 1510 njësi publike, të cilave i'u është *dërguar në v.2023* për plotësim *pyetësori i vetëvlerësimit* mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, 140 njësi (ose 91.5 %) kanë raportuar pranë Ministrisë së Financave. Ndërsa, *në v.2022* evidentohet se nga 152 njësi të cilave i'u është dërguar për plotësim pyetësori i vetëvlerësimit 146 njësi ose 96% kanë raportuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Referuar raporti të SKB të MF *për v.2021*: del se nga 154 njësi publike të cilave i'u është dërguar për plotësim pyetësori i vetëvlerësimit mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, 138 kanë raportuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Nga analizat e pyetësorëve te administruar për v.2023, vlerësohet se *14 NJQP kanë shfaqur dobësi në raportim apo nuk kanë raportuar fare nga ana e institucioneve publike, si dhe nuk janë depozituar 16 pyetësorë vetëvlerësimi të shpërndarë në shoqëritë tregtare të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, si dhe nga 29 të depozituara 12 prej tyre ishin me mangësi;*

Evidentohet se 5 njësive të qeverisjes së përgjithshme nuk kanë raportuar në mënyrën e duhur duke pasur mangësi në dokumentacionin e dërguar (*Bashkia Delvinë, Bashkia Rogozhine, Bashkia Kurbin,Bashkia Librazhd,Bashkia Finiq),* ndërsa 9 NJQP nuk kanë raportuar në MF *(Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar, Qarku Lezhë, Bashkia Cërrik, Bashkia Tropojë, Bashkia Vlorë, Bashkia Konispol, Bashkia Vau Dejës, Bashkia Himarë, Bashkia Vorë).*

Pranë MF, janë depozituar 29 pyetësorë vetëvlerësimi nga 45 pyetësorë të shpërndarë në shoqëritë tregtare të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme.

b- hartimi dhe dërgimi i deklaratës dhe raportit vjetor mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik, si dhe planit të veprimit për ngritjen e tij, të depozituara nga këto njësi sipas dispozitave ligjore në fuqi.

[10] *-Pyetësori i vetëvlerësimit i'u është dërguar nga ana e MF për plotësim 140 njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe 13 njësive shpenzuese me buxhet të madh me qëllim sigurimin e një pamje më të qartë të funksionimit dhe progresit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2023*

Përgjatë vitit 2023, në mbështetje të nenit 18, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, i'u është dërguar kërkesë 198 njësive publike, prej të cilave kanë raportuar 169 njësi. Nga verifikimet e kryera nga MF, rezulton se, detyrimin për depozitimin e *deklaratës dhe raportit mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm* e kanë përmbushur 123 njësi nga 140 njësi të qeverisjes së përgjithshme, të cilat kanë ushtruar veprimtarinë e tyre gjatë vitit 2023.
Më gjerësisht,
Një numër i Sh.a-ve publike, (10 të tilla), raportuan në mënyrë të paplotë e të mangët, ose nuk kanë raportuar në mënyrën e duhur mbi SKB, duke pasur mangësi dokumentacioni, përkatësisht:
Albpetrol sh.a Fier, Regjistri Detar Shqiptar,Ujësjellës Kanalizime sh.a Korcë, Ujësjellës Kanalizime sh.a Gjirokastër, Ujësjellës Kanalizime sh.a Lushnjë, Ujësjellës Kanalizime sh.a Vlorë, Rezidenca Studentore Universitare nr 1 sh.a Tiranë, Klubi shumësportësh "Partizani", Klubi i Shumësporteve , Klubi Futbollit Teuta.

Nga ana tjetër, 15 prej tyre, nuk raportuan në MF:
Prodhim Mobilje, sh.a Tiranë,Posta Shqiptare sh.a ,Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve sh.a Korçë,Agrokredit sh.a Tiranë,Ujësjellës Kanalizime sh.a Durrës,Ujësjellës Kanalizime sh.a Dibër, Ujësjellës Kanalizime sh.a Kukës, Ujësjellës Kanalizime sh.a Elbasan, Ujësjellës Kanalizime sh.a Berat, Ujësjellës Kanalizime sh.a Sarandë, Klubi Sportiv Tirana,Klubi Sportiv Studenti Tiranë, Qendra Kulturore dhe Klubi i Sportit Lushnjë, Klubi i Futbollit Gramozi, Klubi Skëndërbeu,
Si konkluzion, vetëm 17 sh.a nga 45 të njoftuara kanë raportuar në mënyrë e duhur lidhur me deklaratën dhe raportin vjetor të KBFP, kurse, lidhur me instrumentin e planit të veprimit të MFK, vetëm 16 Sh.A kanë dorëzuar plane veprimi të sakta mbi zbatimin dhe përmirësimin e kontrollit të brendshëm.

c- nga vlerësimi i 18 indikatorëve të performancës për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, janë evidentuar dobësi nga institucionet publike në zbatim të Urdhrit të ministrit përgjegjës për financat nr. 117, datë 01.04.2019, (ku *73 prej këtyre institucioneve, ose 48 % e tyre), janë vlerësuar me tregues të përkeqësuar të performancës për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.*
Gjatë vitit 2023 janë angazhuar strukturat e MF në kryerjen e analizave për gjenerimin e të dhënave për 18 (tetëmbëdhjetë) treguesve të performancës të lidhura me aspektet e planifikimin, zbatimin dhe ekzekutimin e buxhetit, si dhe me treguesit për implementimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm. *Nga shqyrtimi i vlerësimeve të kryera nga ana e KLSH-së mbi këto indikatorë të raportit të SKBFP, përgatitur nga MF, rezulton se nga 153 institucione të vlerësuara, 73 prej tyre, (ose 48 % e tyre), janë vlerësuar me tregues të përkeqësuar të performancës për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022*, më hollësisht**:**

- Rankimi i *Institucioneve të pavarura* sipas treguesve të performancës për vitin 2023 dhe krahasimi me vitin 2022, nga 34 institucione të vlerësuara, 16 prej tyre janë vlerësuar në rënie;
- Rankimi i *institucioneve të Grupit 87 në varësi të Kryeministrisë*: nga 22 institucione të vlerësuara, 12 prej tyre janë me tregues në rënie;
- Rankimi i *ministrive të linjës*: nga 11 institucione të vlerësuara, 4 prej tyre janë me tregues të përkeqësuar të performancës:
- Rankimi i *bashkive në qendra qarku* : nga 12 institucione të vlerësuara, 5 prej tyre janë vlerësuar me tregues të përkeqësuar, kurse *rankimi i bashkive të tjera* evidentohet se nga 49 institucione të vlerësuara, 22 prej tyre janë me tregues të përkeqësuar:

- Rankimi i *Këshillave të Qarkut*: nga 12 institucione të vlerësuara, 8 prej tyre janë me tregues të përkeqësuar të performancës:
- Rankimi i *institucioneve me buxhet të madh* nga 13 institucione të vlerësuara, 6 prej tyre janë me tregues të përkeqësuar të performancës:

d-dobësitë e evidentuara nga proceset e vlerësimeve të jashtme të cilësisë *ku* nga 18 NJQP të testuara, *në 7 prej tyre sistemi i kontrollit të brendshëm është vlerësuar jo efektiv.*

V. Për vitin 2023 vlerësimi sipas çdo parimi të MFK-së ka konsideruar: 13 parime me vlerësimin *pjesërisht efektiv*, 2 me vlerësimin *efektiv* dhe 2 me vlerësimin *pjesërisht efektiv por shumë afër të qenit efektiv"*. Konstatohet një ulje e vlerësimit për efektivitetin e kontrolleve dhe cilësinë e menaxhimit financiar për 3 (tre) prej parimeve, kundrejt viteve të mëparshme të analizuara 2021 dhe 2022, përkatësisht: në *Parimi 1: Njësia Publike demostron angazhim për integritet dhe vlerat etike*; *Parimin 12: Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave* dhe *Parimin 14: Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm*, që janë pjesë e komponentëve "Mjedisi i kontrollit", "Aktiviteteve të Kontrollit" dhe "Informimit e Komunikimit".

Nga analiza e detajuar e 17 parimeve të kontrollit të brendshëm konstatojmë se, sistemi i kontrollit të brendshëm për vitin 2023 në 169 njësi publike paraqitet *pjesërisht efektiv.* Sipas raportit vjetor 2023 të KBFP, ky vlerësim vjen si rezultat i moskonkludimit të procesit të lidhjes së objektivave strategjikë dhe operacionale, si dhe detajimit të objektivave në plane konkrete veprimi duke përcaktuar linjat e qarta të përgjegjshmërisë për përmbushjen dhe raportimin e standardizuar të tyre nga të gjithë menaxherët. Gjithashtu, nga analiza e pyetësorëve të vetëvlerësimit për të gjitha grupet e njësive të marra në analizë (ministri linje, njësi të vetëqeverisjes vendore, institucione të pavarura, njësi shpenzuese me buxhet të madh dhe Sh.A me kapital shtetëror) rezulton se vlerësim më të lartë merr grupi i ministrive të linjës, ndërkohë që situata vijon të paraqitet në nivel më të ulët në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe tek njësitë e reja raportuese (Sh.A-të me kapital shtetëror). Nevojitet zhvillim i mëtejshëm i funksionit të menaxhimit të rrezikut, duke përfshirë menaxhimin e aseteve dhe investimeve *(koncensioneve e PPP)*, për të përmirësuar aktivitetet e kontrollit në këto fusha në të ardhmen.

Konkluzioni i përgjithshëm i KLSH për SKBFP për vitin 2023:

Sipas vlerësimeve të KLSH-së, bazuar në:
- analizën e përgjithshme të indikatorëve të konsoliduar që tregojnë dhe shkallës së maturimit të 17 Parimeve të Kontrollit të Brendshëm;
- shqyrtimin e shkallës së suksesit në zbatimin praktik nga njësitë shpenzuese të dispozitave ligjore dhe kuadrit rregullator;
- në vlerësim të gjetjeve të raportit të paraqitur nga Qeveria mbi funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, të konsoliduar përmes informacioneve mbi vetë-vlerësimin e statusit të KBFP-së në pesë komponentët e Kornizës COSO, rishikimet e cilësisë së synuar të menaxhimit financiar dhe AB në institucione individuale;

Performanca e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2023 konsiderohet "pjesërisht efektiv", ndonëse vlerësojmë progresin në efektivitetin e kontrollit të brendshëm, pasi ka mangësi në menaxhimin e riskut, aktivitetet e mjedisin e kontrollit dhe vlerësimin e raportimin në kohën e duhur të problematikave të sistemit të kontrollit të brendshëm, dobësi që kërkojnë adresim nëpërmjet thellimin e reformave strukturore në fushat e

kontrollit të brendshëm. Në këtë kuadër, inkurajojmë strukturat menaxheriale dhe njësitë e Auditimit të Brendshëm për një kontribut të vijueshëm e të pa ndërprerë në përmirësimin e këtij sistemi të kontrollit të brendshëm përmes angazhimit të tyre dhe raportimit vjetor.

III. Mbi veprimtarinë e njësive të auditimit të brendshëm publik:

Në kuadër të procedurave të vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, KLSH ka kryer edhe vlerësimin e eficenses së funksioneve të njësive të auditimit të brendshëm të sektorit publik, për të cilat vlera e shtuar e tyre, ndonjëherë, mund të jetë e vështirë të matet apo përcaktohet në parametra sasiorë.

Përgjatë periudhës 2018-2023 numri i njësive të Auditimit të Brendshëm ka ardhur në rritje (nga 127 në 136), por numri i auditimeve të kryera ka ardhur në rënie (nga 1210 në v.2019 në 971 në fund të vitit 2023), edhe pse numri i tyre është i konsiderueshëm. Sipas raporteve zyrtare të MF konstatohet se numri i audituesve të brendshëm është rritur si në plan (505 në vitin 2023 kundrejt 469 në vitin 2018), edhe në fakt (441 në vitin 2023 kundrejt 429 në vitin 2018).

Kapacitetet dhe burimet njerëzore në njësitë audituese, në mënyrë të vazhdueshme u nënshtrohen proceseve të zhvillimeve dhe edukimeve të vijueshme, konform standardeve ndërkombëtare të edukimit. *Por ajo që vihet re nga auditimet e KLSH është numri i lartë i audituesve të pa certifikuar, e cila ka impaktin e saj në cilësinë e raporteve të auditimit të brendshëm (86 në vitin 2023 kundrejt 59 në vitin 2018)*; si dhe *numri i pozicioneve vakante vijon të jetë i ndjeshëm (nga 40 të tillë në v.2018, ka arritur në 64 në vitin 2022 dhe 2023*[11]).

Legjislacioni për praktikën e auditimit të brendshëm është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Funksioni i auditimit të brendshëm në sektorin publik është krijuar dhe kontribuon në një efiçencë më operacionale, buxhetore e disiplinën fiskale dhe pajtueshmërinë ligjore e rregullatore në entet e sektorit publik duke kërkuar çdo subjekti t'i nënshtrojë operacionet, të dhënat dhe sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të rregullt, sistematik dhe auditime të brendshme gjithëpërfshirëse

Funksioni i AB është zhvilluar në një numër parametrash përkatës, (të tilla si numri i njësive që mbulohen nga shërbimi i AB, numri i audituesve publike apo i atyre të certifikuar sipas detyrimeve ligjore, numri i auditimeve të realizuara sipas planit, vlera totale e gjetjeve krahasuar me vitet e mëparshme, niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve të AB nga subjektet publike), duke theksuar dhe boshllëqet në ushtrimin dhe përmbushjen e përgjegjësive të këtyre strukturave të auditimit të brendshëm.

- Nga auditimet e KLSH, shërbimi i auditimit të brendshëm ka gjetur zbatim në pjesën më të madhe të njësive të qeverisjes së përgjithshme nëpërmjet krijimit të 136 strukturave audituese, në ministritë e linjës, institucione të pavarura, institucione qendrore, njësitë e vetëqeverisje vendore, shoqëritë aksionere publike, agjenci të nivelit të dytë si dhe njësi të tjera shpenzuese të cilat përmbushin kriteret për krijimin e auditimit te brendshëm brenda vetë njësisë shpenzuese. Pjesa tjetër e njësive të qeverisjes së përgjithshme, *bashki dhe agjenci të nivelit të dytë të qeverisjes janë mbuluar nëpërmjet lidhjes së 6 marrëveshjeve ndërinstitucionale apo kontraktimit të shërbimit, ndër të cilat 4 institucione të pavarura dhe 2 bashki.*

[11] *-Referuar sistemit te evidencave statistikore te MF, del se vendet vakante të 64 audituesve janë: 15 në ministritë e linjës, 13 në njësitë e vetëqeverisjes vendore, 12 në institucionet qendrore, 4 institucionet që përfaqësojnë fondet speciale, 4 në institucionet e pavarura, 2 në universitetet publike, 2 në qendrat spitalore dhe 12 në shoqëritë aksionere.*

• Raporti Vjetor është mbështetur në konsolidimin e të dhënave të raporteve vjetore të veprimtarisë së *126 njësive të auditimit të brendshëm* që janë funksionale në sektorin publik, nga 136 te krijuara. Treguesit e raportuar japin informacion mbi strukturat audituese dhe kapacitetet e tyre, realizimin e planit të angazhimeve, vlerësimin e risqeve, sistemet dhe fushat ku gjetjet e auditimit kanë treguar të kenë dobësi materiale, rekomandimet e dhëna nga auditimi lidhur me to, nivelin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit, si dhe kufizimet me të cilat janë përballur audituesit e prioritetet për të ardhmen.

• *Në lidhje me plotësimin e kritereve për përvojën profesionale: për vitin 2023:* janë të punësuar 441 audites dhe struktura profesionale e audituesve të brendshëm konsiston në: *348 ekonomistë, 69 juristë dhe 24 me profesione të tjera specifike sipas sektorëve të ekonomisë*. Kriteri i eksperiencës përmbushet nga *246 audites të brendshëm që kanë vjetërsi pune mbi 5 vjet dhe 195 kanë vjetërsi në auditim deri në 5 vjet;* Ligji për AB, në Nenin 11, 2/ c) audituesi i brendshëm duhet të këtë përvojë pune jo më pak se 3 vjet në profesion dhe të jetë i certifikuar si "Audites i brendshëm në sektorin publik". *Në v.2022* kriteri i eksperiencës përmbushet nga *245 audites të brendshëm që kanë vjetërsi pune mbi 5 vjet dhe 190 kanë vjetërsi në auditim deri në 5 vjet*; Në v.*2021* Kriteri i eksperiencës përmbushet *nga 251 audites të brendshëm që kanë vjetërsi pune mbi 5 vjet dhe 182 kanë vjetërsi në auditim deri në 5 vjet;*

Dobësitë në planifikimin e veprimtarisë dhe ndryshimet e shpeshta gjatë vitit, mbartin riskun që veprimtaria audituese të mos realizohet në mënyrë sistematike dhe të disiplinuar, duke vazhduar të jetë e orientuar nga teknika të inspektimeve financiare, ndërsa auditimet duhet të fokusohen tek sistemet me risk më të lartë. Konstatohet se vlerësimi i riskut të sistemeve, edhe pse është një element thelbësor mbi të cilin mbështetet çdo fazë e procesit audites dhe ka impakt të rëndësishëm në arritjen e objektivave të auditimit, është në nivele jo të kënaqshme. Nga njësitë audituese konstatohet se sistemet e kontrollit të brendshëm në subjektet e audituara nuk janë efektive dhe nuk kanë të miratuara procedura për funksionimin e tyre.

Nga krahasimi i rezultateve të 3-vjeçarit të fundit 2021-2023 mbi shërbimin e auditimit të brendshëm, konstatohet se ndërsa numri i përgjithshëm i gjetjeve nga NJABSP është rritur (nga 7,660 në 8,772), vlera e përgjithshme e zbulimeve ka ardhur në rënie me 120 milionë lekë (nga 593 milionë lekë në 473 milionë lekë). Edhe pse niveli i pranimit të rekomandimeve është rritur, konstatohet se zbatueshmëria e tyre e shtrirë në dy vjet (2022 -2023) vlerësohet të jetë 61.5%.

Nga një analizë e të dhënave mbi vlerësimin e jashtëm të veprimtarisë (VJC) së njësive të auditimit të brendshëm nga MF sipas viteve 2018-2023, lidhur me zbatimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, evidentohet se, janë konsideruar dhe grupuar në kategorinë *"Veprimtaria e AB në mospërputhje të pjesshme dhe mospërputhje të plotë me SNA"* 58 % të njësive të auditimit të brendshëm. Pra, kategoria e NJAB që ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me SNAB zë një peshë të ulët, që konkretisht në vitin 2023 është vetëm 21%.

Niveli i përputhshmërisë së krijimit dhe funksionimit të strukturave audituese dhe respektimi i kritereve të punësimit dhe kualifikimit profesional të audituesve të brendshëm me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale të pranuara në fushën e auditimit të brendshëm publik në shoqëritë publike, *ndonëse shfaq problematika vlerësohet që kërkon përmirësim, si dhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm mbetet në nivele të ulta ndër vite.* Cilësia e raporteve të auditimit edhe pse është vlerësuar, duhet të përmirësohet më tej në të ardhmen.

F. ANEKSE

Aneksi a. Përmbledhje e rezultateve të auditimeve në fushën e buxhetit

1. Performanca fiskale e DPT dhe DPD

Sipas Raportit të zbatimit të buxhetit të përgatitur nga MF, të ardhurat nga "Tatimet dhe Dogana" janë burimi kryesor i të ardhurave të përgjithshme dhe janë realizuar në vlerën 561.7 miliardë lekë, në masën 99.7% të planit vjetor të rishikuar, 10.3% ose 52.4 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe kontribuojnë në buxhetin e shtetit me rreth 18.3% të PBB.

Këto të ardhura, të cilat administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), përfshijnë Tatimin mbi vlerën e shtuar; Tatimin mbi fitimin; Tatimin mbi të ardhurat personale; Akcizat; Taksat Doganore dhe Taksa të tjera kombëtare. DPT administron edhe mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

a) Sipas MF, të ardhurat nga Administrata tatimore (përfshirë kontributet DPT) rezultojnë 344.9 miliardë lekë nga 286.3 miliardë lekë të një viti më parë, me një rritje vjetore prej 20.5% ose 58.7 miliardë lekë më shumë. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të mbledhura nga DPT kanë pësuar rritje në bazë vjetore me 20.8 miliardë lekë. Krahasuar me të dhënat e një viti më parë, pothuajse të gjitha llojet e të ardhurave tatimore kanë pasur një tendencë në rritje, në krahasim me buxhetin fillestar 2023 si dhe me realizimin e një viti më parë.

Sipas auditimit të KLSH në DPT rezulton se nga 340,034 milion lekë të ardhura gjithsej neto të planifikuara janë realizuar 344,260 milion lekë, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ose 1.2 % më shumë se plani dhe 58,699 milion lekë më shumë se viti i kaluar.

Duke i analizuar sipas përbërjes: të ardhura tatimore dhe kontribut të sigurimeve rezultojnë sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela nr. 15 Të ardhurat e planifikuara dhe të realizuara nga DPT 2023

Në milion lekë

Nr	Emërtimi	Realizimi 2022	Realizimi 2023	Plani 2023	Diferenca plan- fakt	Plan - fakt %	Diferenca 2023 – 2022
A	Të Ardhurat Tatimore gjithsej	167,095	205,005	200,134	4,871	102%	37,910
B	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	118,465	139,255	139,900	-645	100%	20,790
	D P Tatimeve gjithsej (Neto)	285,560	344,260	340,034	4,226	101%	58,699

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga KLSH

Nga sa më sipër rezulton se MF ka pasaktësi raportimi në të ardhurat gjithsej në krahasim me DPT me 0.6 miliard lekë më shumë se sa rezulton në fakt.

Të ardhurat nga kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nuk janë realizuar për 645 milion lekë.

Të ardhurat tatimore gjithsej neto rezultojnë me tejkalim në vlerën 4,781 milion lekë në krahasim me planin përfundimtar, gjë e cila ka gjasa të ketë ardhur dhe për shkak të mangësive në planifikim, pasi për shkak se rritja mesatare është 23 % në krahasim me një vit më parë. Edhe nga auditimi në DPT konstatohet se, plani i të ardhurave është përgatitur nga MFE, dhe është përcjellë për njohje dhe zbatim pranë DPT, pa pjesëmarrjen dhe kontributin e DPT në këtë drejtim. Veç sa më sipër MF, me shkresën nr. 2703 prot., datë 08.02.2023 ka dërguar në DPT planifikimin vjetor dhe të ndarë sipas muajve të të ardhurave dhe për kontributet e sigurimeve dhe me shkresën nr. 19768 prot., datë 30.10.2023 është përcjellë plani vjetor dhe mujor i rishikuar, duke ndryshuar planin edhe te muajve të kaluar të periudhës janar-tetor, duke bërë të pavlefshme veprimtarinë monitoruese dhe përgjegjshmërinë e administratës tatimore për mbledhjen e të ardhurave.

Duhet theksuar se një ndër tre treguesit e të ardhurave me mosrealizim është TVSH neto, për shkak të tejkalimit të ndjeshëm të TVSH-së rimbursuar në krahasim me planin e dërguar nga MFE.

Nga auditimi në DPT është konstatuar se në realizimin e të ardhurave tatimore janë përfshirë edhe arkëtimet për tarifat jo tatimore në vlerën 2,786 milion lekë, si dhe të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin në vlerën 62 milion lekë, të cilat nuk kanë qenë të planifikuara. Gjithashtu, nga ana e DPT, në realizmin e të ardhurave tatimore janë raportuar dhe penalitet të aplikuara në vlerën 2,371 milion lekë për vitin 2023, në zërat respektiv në të cilët është konstatuar mungesa e të ardhurave, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018. Nga sa më sipër, është konstatuar se raportimi nga DPT zërave të mësipërm si të ardhura, në kushtet kur nga MFE përfshihen në planifikim, sjell për pasojë një tregues realizimi të të ardhurave të deformuar, që nuk shfaq performancën reale të administratës fiskale në mbledhjen e të ardhurave.

Gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në fund të vitit 2023 rezulton në vlerën rreth 155,165 milion lekë, nga i cili: detyrim 61%, gjobë 34% dhe interesa 5%. Ky detyrim ju përket 182,490 subjekteve, me një rritje vjetore prej rreth 8,397 milion lekë dhe me një ulje prej 1,467 subjekte debitorë. Detyrimet më të mëdha i përkasin TVSH-së dhe në vijim Tatim fitimi, sigurimet etj. 55 % e detyrimeve të prapambetura tatimore janë të periudhës mbi 5 vjeçare dhe vetëm 10 % është deri në 1 vit. Ka një vështirësi të konsiderueshme në vjeljen e këtij borxhi, pasi 74 % e vlerës ju përket subjekteve pasive dhe vetëm 26 % atyre aktive. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka një vlerë detyrimi tatimor të papaguar prej 2,352 milion lekë jashtë sistemit C@TS, i cili paraqitet me ulje krahasuar me vitin paraardhës. Situata e mësipërme është si pasojë edhe se DPT ka ushtruar masa shtrënguese të pakta duke marr parasysh numrin e subjekteve me detyrime të prapambetura dhe se këto masa shtrënguese janë të përsëritura për një numër të konsiderueshëm rastesh.

Nga auditimi ka rezultuar se, DPT ka një stok i lartë të kontrolleve të papërfunduara nga viti 2017, ku deri më 31.12.2023 janë gjithsej 805 kontrolle të pezulluara, të pafilluara ose që vijojnë në proces: 109 kontrolle të pafilluara, 47 kontrolle të pezulluara, 432 kontrolle në fazë projekt raporti, 201 kontrolle dërguar projekt raporti, 14 kontrolle pritet observacion nga subjekti dhe 2 kontrolle në fazë raporti përfundimtar.

DPT rezulton se në fund të vitit 2013 ka detyrime të prapambetura gjithsej në vlerën 311 milion lekë, nga të cilat 298 milion lekë për vendime gjyqësore: 20 % për ish punonjës dhe 80 % subjekte.

Nga auditimi ka rezultuar se DPT nuk ka arritur të përmbyllë në vitin 2023 procesin e ristrukturimit organizativ të përcaktuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 69, datë 26.05.2023. Në dhjetor të vitit 2023 administrata tatimore ka pasur 338 vende pune vakante nga 1450 gjithsej ose 23 % të pa plotësuar organikën përkatës. Gjithashtu, konstatohet se DPT ka 71 procese gjyqësore të hapura për largimet nga puna.

b) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka pasur në administrim grumbullimin e të ardhurave për TVSH në import, akcizë, rentë dhe taksë doganore që për vitin 2023 plani përfundimtar i rishikuar në ulje ka qenë 223,677 milion lekë dhe është realizuar 216,804 milion lekë ose në masën 96.9 %, 6,873 milion lekë më pak.

Tabela nr.16 Të ardhurat e planifikuara dhe të realizuara nga DPD 2023

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2022	Plani 2023	Fakti 2023	Diferenca fakt-plan	% realizim	Diferenca me 2022
1	TVSH në import	156,898	152,677	146,386	(6,291)	95.9	(10,512)
2	Akcizë neto	53,547	59,000	58,394	(606)	98.9	4,847
3	Rentë minerare	4,198	3,200	2,891	(309)	90.3	(1,307)
4	Taksë doganore	8,447	8,800	9,133	333	103.8	686
	Total	223,090	223,677	216,804	(6,873)	96.9	(6,286)

Burimi: Të dhëna të DPD të përpunuara nga KLSH

Në krahasim me vitin 2022 performanca nuk ka qenë pozitive, pasi rezulton se të ardhurat janë realizuar në vlerën 6,286 milion lekë më pak (rënie në masën 2.8%), ku veçanërisht rënia më e madhe vjen nga të ardhurat e realizuara nga TVSH të cilat rezultojnë 6.7% më pak se viti 2022 ose 10,512 milion lekë më pak.

Sipas DPD mos realizimi i të ardhurave për TVSH është rezultat i mungesës së importit të energjisë elektrike, rënia e çmimit të karburanteve, gazit ,metaleve bazë, rënia e kursit të këmbimit etj., dhe efekt pozitiv importi i auto veturave të përdorura. Duhet shtuar se në rastin e TVSH, nga auditimi në DPD rezulton se ka mangësi në zbatimin e plotë të legjislacionit për regjimin e përjashtimit të TVSH në importin e makinerive për projekte investimi me vlerë të caktuar.

Për akcizën kanë ndikuar rritja e sasisë së karburanteve dhe nga rritja e të ardhurave për njësi për gazin dhe për cigaret.
Të ardhurat nga renta janë ndikuar nga rënia e të ardhurave nga nafta brut edhe për efekt të sasisë edhe të çmimit, rënia e çmimit të mineraleve, ndërsa për taksën doganore konsiderohen si faktorë të rritjes importi i konstruksioneve metalike, produkteve të shportës etj.

Në fund të vitit 2023 rezulton një nivel detyrimi i papaguar doganor gjithsej në shumën 47,594 milion lekë, i cili krahasuar me vitin paraardhës ka pasur një rritje prej 903 milion lekë ose me 1.9 %. Duhet theksuar se nga detyrimet e prapambetura gjithsej vetëm 27 % janë detyrime doganore dhe pjesa e tjetër janë penalitete dhe kamatëvonesa.

Referuar moshës së detyrimeve të prapambetura konstatohet se 61 % e tij është krijuar para 5 viteve, duke e vështirësuar ndjeshëm mbledhjen e tyre.
Lidhur me masat e marra nga DPD për vjeljen dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore, konstatohet se për 58 % të vlerës gjithsej janë nxjerrë urdhrat e ekzekutimit, pjesa e tjetër në proces gjyqësor dhe në ndjekje të procedurave përkatëse.
Nga auditimi në DPD konstatohet se nuk ekziston një databazë e plotë e cila të mund të evidentojë numrin e subjekteve që kanë detyrime doganore sipas statusit juridik aktiv, pasiv apo të çregjistruar në QKB, duke shfaqur mungesë efektiviteti në vjeljen e detyrimeve të prapambetura.

Nga auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore është konstatuar se administrata doganore ka pasur 118 pozicione vakante pune gjatë vitit 2023 nga 1074 në strukturë gjithsej ose 11 %, me rritje krahasuar me 2022, si dhe 278 transferime të përkohshme punonjësish, duke cenuar ndjeshëm performancën e institucionale të administratës fiskale doganore.

2. Auditimet në institucionet qendrore etj.

Nga auditimi i çështjeve të planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore kanë rezultuar disa mangësi si: kërkesa buxhetore të PBA-së në të dy fazat strategjike dhe teknike janë paraqitur në tejkalim të tavanit të miratuar, të cilat ndryshonin *nga faza strategjike në fazën teknike*, duke shtuar politika te reja dhe duke ndryshuar vlerat e politikave ekzistuese për të cilat nuk ka argumente dhe analiza të ndryshimit të këtyre kërkesave; zërat e investimeve të parashikuara në PBA kan mospërputhje të ndarjes së tyre mes politikave të reja dhe atyre ekzistuese; në PBA nuk janë përgatitur tregues përformance gjinore; projektet që janë kërkuar/planifikuar në PBA-në e vitit 2022-2024, të cilat nuk janë miratuar dhe realizuar në buxhetin vjetor 2022, nuk janë kërkuar si projekte për tu realizuara në 2023-2025, por janë shtuar projekte të reja; janë përdorur të ardhura të trashëguara për shpenzime korrente dhe për investime pa marrë më parë autorizim nga Ministria e Financës; ka përfituar donacione nga subjekte vendas që i ka pasur objekt hetimi (Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale); nuk ka dokumentacion të hartuar mbi projekt - buxhetin vjetor (Akademia e Shkencave); nga kryqëzimi dhe krahasimi i të dhënave midis PBA 2022-2024 dhe PBA 2023-2025, u konstatuan se 14 projekte investimi, si projekte të reja në vlerë më të ulët, duke ruajtur tavanet buxhetore të miratuara, e më pas në PBA 2023-2025 rriten me një vlerë të konsiderueshme (Ministria e Brendshme); nuk ka funksionuar Ekipi i Menaxhimit të Programit, për përgatitjen e PBA-ve, si dhe nuk ka dokumentim të mbledhjeve të EMP- së; nuk ka zbatuar afatet e vendosura nga vete ky institucion ne planin vjetor 2022, për projektin CENS; rishikimet buxhetore nuk kanë argumentim (INSTAT); mosrealizim të theksuar të investimeve (Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë); tejkalim i afateve për kryerjen e pagesave dhe mos respektim i parimit FIFO (Këshilli Lartë i Prokurorisë).

Për raportimin dhe monitorimin e shpenzimeve buxhetore është konstatuar se: nuk janë hartuar raportet e monitorimit si dhe relacionet shpjeguese 4-8-12 mujore (Ministria e Mbrojtjes, KLP, Ministria e Brendshme, etj.); mangësi në përllogaritjen e detyrimeve tatimore në të ardhurat nga punësimi dhe shpërblimin e punonjësve (Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale) etj.

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2023, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë rezultoi se në seksionin e të drejtave dhe të detyrimeve, nuk janë të kontabilizuara vendime të gjykatave të arbitrazhit ndërkombëtar për vlera që i paguhen RSH penalitetet për vonesa në shumën 1,693,157 Euro. Gjithashtu, nga auditimi në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, në një rast tribunali Arbitrazhit i ka dhënë të drejtë palës shqiptare, ku nga përllogaritja e grupit të auditimit deri me datë 31.12.2023 totali i vlerave të arkëtueshme në favor të Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit janë në shumat 5,418,883.31 Euro, 1,472,635.27 USD dhe 265,458.19 GBP.

Në lidhje me stokun dhe raportimin e detyrimeve të prapambetura ka rezultuar se: Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka akorduar shtesën për kualifikim me fuqi prapavepruese duke krijuar një detyrim të prapambetur, i cili nuk është evidentuar në pasqyrat financiare të institucionit e nuk është paraqitur në strukturën përgjegjëse për Thesarin; AKBN megjithëse ka kontabilizuar detyrimet që rrjedhin nga vendime të arbitrazhit ndërkombëtar nuk është marrë asnjë masë lidhur me likuidimin apo planifikimin për likuidim të këtij detyrimi, si dhe nga MIE nuk janë të kontabilizuara dy vendime të gjykatave të arbitrazhit ndërkombëtar; ka dy vendime për detyrime të pa ekzekutuara dhe tre vendime të mbartura të GJEDNJ; Nga auditimi në Ministrinë e Brendshme është konstatuar se rivlerësimi i listë pagesave mujore të gjyqëfituesve në vite ka gjeneruar detyrime në sistemin tatimor për detyrimet në kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore në vlerën 17,399 mijë lekë; INSTAT ka detyrime në kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe detyrime për tatimin nga të ardhurat personale në vlerën 1,633 mijë lekë;

Në shpenzimet për Prokurimet me fondet publike problematikat e konstatuara konsistojnë në: mangësitë e mbajtjes së Regjistrit të parashikimi dhe realizimit, duke mos marrë në konsideratë llogaritjen e grup – mallrave apo shërbimeve të ngjashme në procedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla (Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale); nuk ka një regjistër parashikimi (Akademia e Shkencës); regjistri i realizimeve për prokurimet publike nuk pasqyron të dhëna të plota (INSTAT); në procedurat e prokurimit përfshihet nëpunësi zbatues; përfshirja e të njëjtëve zyrtarë në faza të ndryshme të procedurës së prokurimit (INSTAT); parregullsi përsa i përket dokumentimit të mënyrës së përllogaritjes së vlerës së fondit limit (Ministria e Mbrojtjes, Akademia e Shkencave etj.); nuk janë argumentuar teknikisht në një procesverbal në referim të grafikut, volumeve, natyrës së punës apo zërave të preventivit të cilat do të justifikonin dhe ligjëronin vendosjen e secilit kriter, specifikimeve teknike etj.; nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave (Ministria e Mbrojtjes, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale etj.); parregullsi e shkelje në drejtim të zbatimit të kontratave të lidhura për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve publike si mungesa e komisionit për marrjen në dorëzim të shërbimit etj. (INSTAT).

Nga auditimet janë evidentuar dëme financiare në fushën e shpenzimeve në Ministrinë e Mbrojtjes ku gjatë zbatimit të kontratave mos llogaritja e kostove përfundimtare të ndërtimit dhe rrjedhimisht edhe kostove të shërbimit të projektimit; përllogaritje të gabuara të rimbursimit të TVSH në dëm të buxhetit të buxhetit të shtetit; në zbatimin e projekteve tek Akademia e Shkencave etj; përfitime të kontraktorëve për punë të pakryer.
Mangësi në dokumentacionin shoqërues të projekteve (Akademia e Shkencave); mosarkëtimi i detyrimeve tatimore për të ardhurat nga punësimi nga AKBN; pagesat e gjyqfituesve etj.

3. Auditimet në njësitë e vetëqeverisjes vendore

Nga auditimet e pasqyrave financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore, çështjet kryesore të konstatuara, konsistojnë në: pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë; llogari të pa justifikuara nga ana e dokumentacionit të nevojshëm kontabël; mangësi në rakordimet me Thesarin; mos përgatitja e dokumentacionit për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme; diferenca në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare në të cilat nuk janë përfshirë në inventarizim llogari të ndryshme; mungesa e një regjistri kontabël; mangësi në regjistrimet kontabël të kryera gjatë vitit duke rezultuar me diferenca në pasqyrat financiare; llogari të pa justifikuara me dokumentet e nevojshme kontabël e ligjorë; diferenca në rakordimet me thesarin; mungesa e evidentimit në pasqyrat financiare të masave të shpërblimit të dëmit; aktive të pa regjistruara në ASHK; mungesa e dokumenteve të pronësisë për objektet e trashëguara nga njësitë vendore që u shkrinë me reformën territoriale; mungesa të inventarit fizik dhe të regjistrit të aktiveve; mangësi në normat e aplikuara të amortizimeve për aktive mbi bazë të të dhënave historike; mos pasqyrim i faturave me vlerën reale të tyre; mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve në pasqyrat financiare, ku konkretisht konstatohen mangësi në drejtim të njohjes së detyrimeve për debitorët e qirave, taksës së infrastrukturës, biznesit apo familjarëve; hidrokarbureve, etj.
Konstatohet se planifikimet e angazhimeve buxhetore nuk janë të mbështetura në planifikime realiste të të ardhurave të bashkive nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe ky planifikim nuk rishikohet gjatë vitit duke mos u përshtatur me shpenzimet buxhetore të miratuara, krahas të ardhurave reale të realizuara; nuk është kryer analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit Qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor i vitit 2023; nuk analizohen rastet e vendimeve gjyqësore objekt ekzekutimi, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore; ndërmarrja e angazhimeve kontraktuale pa patur fonde në dispozicion, ku për investimet disa vjeçare nuk është garantuar financimi minimal në masën 20% të vlerës totale të kontratës; mangësi në planifikimin buxhetor për ekzekutimin e detyrimeve të prapambetura bazuar në grafikut e likuidimit të tyre, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit; mos likuidimi në kohë i të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke mos paraqitur pranë degës së thesarit të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30/60 ditor nga momenti i lëshimit të faturës.
Nuk janë marë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta, për të kryer sistemimet e nevojshme në llogarinë 486.

Nga auditimet lidhur me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave janë konstatuar mangësi në lidhje me: mos ndjekjen e procedurave ligjore për dokumentimin e planifikimit të të ardhurave; mos zbatimin e detyrimeve kontraktuale për kontratat e qirasë; mungesën e pajisjes me certifikatë/autorizim të subjekteve që zhvillojnë aktivitet në fushën e shitjes me pakicë të karburanteve dhe nënprodukteve të tyre për konsumatorët fundorë ,etj.
Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk kanë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme ligjorë për vjeljen e detyrimeve ndaj subjekteve debitorë, si: bllokimi i llogarive bankare, vendosja e barrës siguruese në Drejtoritë Rajonale të Transportit (për mjetet), apo ASHK (ish- ZVRPP), mos aplikim të gjobave për mos pagesën në afat, dhe në asnjë nga bashkitë e audituara, nuk evidentohet të jetë ndërmarrë hapa të tjerë ligjor ndaj tatimpaguesve.

Në fushën e shpenzimeve, për zbatimin e procedurave të prokurimit publik disa nga problematikat që kanë rezultuar konstatohen se: nuk është përcaktuar saktë objekti i prokurimit;

janë zhvilluar prokurime edhe pse Autoriteti Kontraktor nuk ka dokumentuar nevojën reale për mallra, punë apo shërbime; në disa raste janë zhvilluar procedura prokurimi pa patur fonde në dispozicion, ku është konstatuar se nuk janë depozituar në Degën e Thesarit dokumentacionet për fillimin e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave të punimeve dhe mallrave kanë rezultuar problematika si: mos zbatim i rregullave në fushën e ndërtimit, kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të punimeve të ndërtimit; projekte me mangësi teknike, të hartuara nga zyrat projektuese pa studiuar terrenin apo reflektimin e ndryshimeve thelbësore që mund të ndodhin gjatë zbatimit të punimeve; mospërputhje e preventivit fillestar me volumet e projektit; çmime të preventivit të cilat nuk shoqërohen me analiza çmimi; shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve pa argumente teknike; devijime nga volumet e situacionuara etj., duke shkaktuar për pasojë dëme ekonomike dhe efekte negative në përdorimin e fondeve publike.

Nga auditimi i çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin dhe zhvillimin e Territorit ka rezultuar se nuk janë përcaktuar saktë volumet e punimeve në projektet e ndërtimit, për të mundësuar saktësimin e vlerës të taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe respektimin e kritereve sipas pasaportës së njësive strukturore.

Në fushën e administrimit të pronave publike ka rezultuar se: nuk janë bërë pasqyrimet në inventar dhe kontabilitet të të gjitha aseteve publike sipas njësive përkatëse; nuk janë ngritur grupet e punës për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) dhe nuk ka rakordim me to për asetet pronë e Komunave, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Komunës; mangësi në administrimin e të dhënave të plota dhe kryerjen e rakordimeve për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronave shtetërore të zaptuara, etj.

4. Auditimet e shoqërive publike dhe projekteve me investime të huaja

Nga auditimi i shoqërive publike në fushën e buxhetit kanë rezultuar planifikime të pasakta buxhetore; në shpenzimet për investime pagesa për punë të pakryer; përllogaritje të gabuara të fondit limit; mangësi në menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, pasi mungojnë deklaratat dhe raportet për cilësinë e funksionimit sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe rregullorja e brendshme (Spitali Rajonal Elbasan); llogaritë e të ardhurave të shoqërisë vijojnë të mbeten të bllokuara; janë nënshkruar 5 kontrata huamarrje nga subjektet e tjera të cilat nuk janë të përfshira në Programin e Zhvillimit Ekonomik 2021-2023; shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve që vijnë prej aktiveve dhe detyrimeve financiare: risku i kreditimit, risku i tregut, risku i likuiditetit; NjAB për vitin 2023 ka funksionuar vetëm me Specialistin e sektorit të auditimit të brendshëm deri në datën 1 Nëntor 2023 (Albcontrol SHA); vendosje kriteresh të paargumentuara në procedura prokurimi; shpenzim i fondeve pa efektivitet në zbatimin kontratave publike; mungesë analize në procedurat e marrjes me qira (Agjencia për Efiçencën e Energjisë); nuk janë kryer zhvlerësimet e aktiveve financiare të bartura në pasqyrat financiare të shoqërisë mëmë; janë paguar gjoba dhe interesa për pagesa të vonuara me efekt financiar negativ në buxhetin e saj; (Shoqëria Rajonale e Ujesjellës Kanalizime Elbasan).

Nga auditimi i projektit me financim të huaj “Ndërtimi i Linjës se Transmetimit 400 kv Shqipëri-Kosovë”, “Linja 400 kv Shqipëri-Maqedoni” dhe “Ndërtimi i Linjës së Transmetimit me dy

qarqe 220 kv Tiranë-Rrashbull dhe Unaza 110 kv e Tiranës, Loti 1 & 2" ka rezultuar: -Projektet nuk kanë përfunduar në kohë duke sjellë efekte negative në vazhdim, si rritjen e tarifës së angazhimit apo rritjen e kostove për mbikëqyrësit dhe konsulentët, rritjen e vlerës së kostos, rritjen e shtrirjes në kohë të përfundimit të Projektit; komisionet e kolaudimit të punimeve kanë në përbërje, punonjës të OST SHA të pa licencuar për këtë qëllim.

5. Auditimet e Teknologjisë së Informacionit

Në përfundim të auditimeve të sistemeve të teknologjisë së informacionit në disa institucione, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka identifikuar një numër çështjesh kritike që prekin performancën, sigurinë dhe besueshmërinë e sistemeve. Mungesa e dokumentacionit të qartë, procedurave të standardizuara dhe kapaciteteve teknike janë të përhapura në disa institucione, si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Transportit Rrugor dhe Radio Televizioni Shqiptar. Në disa raste, pajisjet dhe infrastruktura e sistemeve janë të vjetruara, me hapësira të kufizuara dhe mungesë investimesh, duke rrezikuar vazhdimësinë e funksionimit dhe sigurinë e të dhënave.
Auditimi i Teknologjisë së Informacionit në këto institucione dhe e infrastrukturës përkatëse ka nxjerr në pah problematika si:
- Për shkak të infrastrukturës së vjetruar dhe mungesës së hapësirës, disa sisteme janë të rrezikuara për ndërprerje të papritura dhe humbje të të dhënave kritike. Ky rrezik është vlerësuar i pranishëm në DPT me sistemin e-Taxation dhe RTSh me sistemet e tij të informacionit.
- Sistemi e-Taxation ku bazohet aktiviteti kryesor i DPT-së dhe Sistemi Informatik i Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave, nuk rezultojnë të klasifikuar si infrastruktura kritike të informacionit, megjithëse cenimi ose shkatërrimi i tyre do të kishte pasoja serioze për ekonominë në vend dhe shëndetin e qytetarëve.
- Sistemet kritike në DPSHTRR, KQZ, dhe AKBPM janë të pambrojtura përballë sulmeve kibernetike për shkak të mungesës së strukturave të dedikuara për sigurinë e informacionit dhe identifikimit e dokumentimit të përgjegjësive.
- Institucionet që u konstatuan me vakanca në pozicionet kritike të dedikuar për Sigurinë e Informacionit u konstatua tek DPT, DPPSH dhe DPSHTRR.
- Mungesa e politikave dhe procedurave për menaxhimin e përdoruesve janë konstatuar në institucione si UKSh dhe AKBPM duke rritur rrezikun për akses të paautorizuar në sisteme dhe të dhëna të ndjeshme.
- Mungesa e planeve për vazhdimësinë e punës në raste katastrofash, duke i lënë të pambrojtura në situata emergjente u konstatua ne institucionet si DPT, DPShTRr, dhe RTSh.
- Në strukturat e Auditit të Brendshëm, u konstatua se disa institucione, si KQZ, ShSSh, DPShTRr dhe RTSh, nuk kanë audituesIT dhe nuk kanë zhvilluar auditime të sistemeve të TI, ndërsa Policia e Shtetit ka kryer auditime të kufizuara duke përdorur specialistë të IT nga strukturat e brendshme.

6. Auditimet e performancës

Disa nga problematikat më të spikatura që identifikojë dobësitë në menaxhimin e fondeve publike me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike ndaj qytetarit janë:
Në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies: (i)Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë së saj, nuk kanë mundësuar përmirësimin e shërbimit të trajtimit të sëmundjeve tumorale; shërbimet radiologjike, radioterapi e disa kimioterapi, ofrohen vetëm në

Spitalin Onkologjik; (ii) nuk është planifikuar auditimin dhe monitorimi i zbatimit të kontratave të shërbimit të hemodializës; nuk ka studiuar dhe analizuar, kapacitet profesionale, teknike dhe infrastrukturore, të institucioneve shëndetësore publike dhe jopublike. (iii) Infrastruktura vendore nuk nxit përfshirjen e grave rurale në tregun e punës, pasi në zonat rurale mungojnë çerdhet, ndërsa shërbimi i kopshteve nuk ofrohet në të gjitha njësitë administrative rurale si dhe mungon transporti publik nga njësia qendër drejt të gjitha njësive administrative. (iv) Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë nuk kanë arritur të minimizojnë kostot e menaxhimit të mbetjeve për të përfituar të ardhura nëpërmjet metodologjisë së trajtimit të tyre. (v) Mbetjet spitalore dhe trajtimi i tyre për vetë rreziqet që shfaq mbeten një sfidë e vazhdueshme për institucionet shëndetësore si prodhuesit kryesor të tyre, sepse përveç se nuk respektohen standardet mjedisore, shkaktojnë probleme serioze shëndetësore në komunitet si dhe efekte negative në ekonominë lokale. (vi) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka garantuar fondet e mjaftueshme buxhetore dhe infrastrukturën e duhur për të trajtuar e akomoduar sipas standardeve pacientët me probleme të shëndetit mendor; (vii) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse kanë mundësuar të nxisin një qasje bashkëkohore ndaj menaxhimit të pajisjeve mjekësore. Mungesa e vlerësimit të investimeve të kryera, analizave kosto përfitim, kostove të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore e vënien në punë të atyre ekzistuese, nuk mund të garantojnë mirë funksionimin gjatë gjithë ciklit normal të jetës së tyre. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka iniciuar asnjë inspektim, monitorim apo auditim mbi Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi", Spitalin Universitar të Traumës dhe sistemin spitalor publik, në fokus të së cilit të jenë pajisjet mjekësore. (viii) Laboratori i Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Barnave nuk funksionon me kapacitet të plotë, për shkak të pengesave burokratike si dhe të mungesës së investimeve në laborator. Kështu që janë dhënë fonde për laboratorin e kontrollit në vitin 2020, e në vijim për të tre vitet e tjera nuk i është dhënë asnjë fond për investime në pajisje, mjete dhe materiale të tjera laboratorike, ndërkohë që gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, kjo agjenci ka realizuar dhe ka arkëtuar për llogari të buxhetit të shtetit të ardhura dytësore.

Në fushën e arsimit: (i) Ministria e Arsimit dhe Sportit me strukturat e saj të varësisë, nuk kanë garantuar respektimin e detyrimeve kontraktuale të nënshkruara nga të dy palët Student-Ministri Arsimi dhe Sporti sipas akt marrëveshjeve për një periudhë 10 vjeçare;

Në fushën e mjedisit: (i) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave nuk kanë bashkëpunuar sa duhet me njëra tjetrën për të siguruar financime për promovimin e shkarkimeve zero nga mjetet rrugore, shkarkime të ulëta, automjete me karburant të pastër, alternativ, etj.; (ii)Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, nuk ka që marrë masa për të unifikuar pagesën e rentës minerare bazuar në emërtimin e mineralit; dhe për të kryer dy herë në vit monitorimin e veprimtarisë minerare të çdo subjekti;

Në fushën e bujqësisë: (i) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e varësisë të nuk koordinojnë të dhënat në kohë reale me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për importet dhe eksportet e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;

Në fushën sociale dhe barazisë gjinore*:* (i) Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk kanë qenë plotësisht efektive në realizimin e objektivave mbi Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor; nuk është realizuar monitorimi, gjurmueshmëria si dhe vlerësimi e matja e ndikimeve të shpenzimeve buxhetore; (ii) Institucionet Rezidenciale Publike për të moshuarit nuk kanë kapacitete të mjaftueshme, staf të punësuar për të moshuarit, kushte për të moshuarit dhe nuk plotësojnë nevojat e tyre sipas standardeve; sistemi i shërbimit social shtetëror nuk ofron qendra rezidenciale për persona jo-autosuficientë, për trajtimin e tyre nuk është angazhuar asnjë mjek psikiatër;

Në fushën e drejtësisë, zvogëlimit pabarazisë dhe ndërtimit të institucioneve të forta*:* (i) sistemi i numrit 112 funksionon për administrimin e thirrjeve emergjente vetëm në Tiranë dhe niveli i realizimit të angazhimeve financiare për ngritjen dhe vendosjen në funksion të numrit unik 112 është 54%; (ii) nuk është kryer analizë për përcaktimin e kriterit të pamjaftueshmërisë financiare dhe përfitimit të ndihmës juridike falas; (ii) Shërbimi Përmbarimor Shtetëror haset në vështirësi në rastet e vendosjes së urdhër sekuestros nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor; (iii)Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk ka analizë dhe shpërndarje proporcionale të paraburgosurve, sipas kapaciteteve dhe IEVP-ve; kushtet që ju ofrohen personave të paraburgosur në IEVP-të nuk përmbushin standardet kombëtare e ndërkombëtare, në respektim të dinjitetit njerëzor;

Në fushën e ekonomisë dhe sigurisë*;* (i) Ministria e Mbrojtjes nuk ka përfshirë në dokumentet politikë (strategji kombëtare/sektoriale, direktivat e ministrisë për mbrojtjen civile etj., rezervën materiale të shtetit; struktura aktuale e rezervës materiale të shtetit është jo e plotë dhe e pamjaftueshme për të përmbushur qëllimin për të cilin është krijuar.

Aneksi b. Lista e auditimeve që kanë shërbyer për raportin e zbatimit të buxhetit

Nr	Auditime
	Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja
1	Agjencia për Eficencën e Energjisë
2	Albcontrol SHA
3	Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës
4	Mbi disponibilitetin në treg dhe trajtimin në linjën e tretë të mjekimit të pacientëve të diagnostikuar me Luecemi Limfoide Kronike (LLC), me barin "Ibrutinib 140 mg"
5	Ndërtimi i Linjes se Transmetimit 400 kv Shqipëri-Kosovë; Linja 400 kv Shqipëri-Maqedoni"; Ndërtimi i Linjës së Transmetimit me dy qarqe 220 kv Tiranë-Rrashbull dhe Unaza 110 kv e Tiranës, Loti 1 & 2".
6	Per dhenien me koncesion te sherbimit te kontrollit ligjor te instrumenteve matese, nepermjet verifikimit te instrumenteve shperndarese te karburantit dhe gazit te lengshem dhe miratimin e bonusit ne proceduren konkurruese qe i jepet shoqerise
7	Spitali Rajonal, Elbasan
8	Ujësjellës-Kanalizime, Elbasan
	Departamenti i Auditimit IT
9	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
10	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
11	Drejtoria e Përgjithshme te Policise per Kundravajtjet rrugore
12	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
13	Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale/Ne fokus Skema e Ndihmes Sociale
14	Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sh.A
	Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit
15	Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të pakthyera
16	Dega e Doganës Kakavijë
17	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
18	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
19	Drejtoria Rajonale Tatimore, Fier
20	Drejtoria Rajonale Tatimore, Vlorë
21	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
22	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)
23	Ministria e Financave
	Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore
24	"Mbi përputhshmërinë e zbatimit të kontratës koncesionare për Markimin e Karburanteve"
25	Agjencia e Prokurimit Publik
26	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
27	Akademia e Shkencave
28	Gjykata Kushtetuese
29	Instituti i Statistikave (INSTAT)
30	Këshilli i Lartë Gjyqësor
31	Keshilli i Larte i Prokurorise
32	Komisioneri për të drejtën për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale
33	Ministria e Brendshme
34	Ministria e Mbrojtjes

35	Prokuroria e Përgjithshme
36	Universiteti Politeknik i Tiranë
37	Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
	Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetqeverisjes Vendore
38	Bashkia Belsh
39	Bashkia Berat
40	Bashkia Bulqizë
41	Bashkia Cërrik
42	Bashkia Delvinë
43	Bashkia Devoll
44	Bashkia Dimal
45	Bashkia Divjakë
46	Bashkia Dropull
47	Bashkia Durrës
48	Bashkia Fier
49	Bashkia Finiq
50	Bashkia Fushë Arëz
51	Bashkia Gjirokastër
52	Bashkia Gramsh
53	Bashkia Has
54	Bashkia Himare
55	Bashkia Kamëz
56	Bashkia Kavajë
57	Bashkia Këlcyrë
58	Bashkia Klos
59	Bashkia Kolonjë
60	Bashkia Konispol
61	Bashkia Korçë
62	Bashkia Krujë
63	Bashkia Kuçovë
64	Bashkia Kurbin
65	Bashkia Lezhë
66	Bashkia Libohovë
67	Bashkia Librazhd
68	Bashkia Malësi e Madhe
69	Bashkia Maliq
70	Bashkia Mallakastër
71	Bashkia Mat
72	Bashkia Memaliaj
73	Bashkia Patos
74	Bashkia Peqin
75	Bashkia Përmet

76	Bashkia Prrenjas
77	Bashkia Pukë
78	Bashkia Rrogozhinë
79	Bashkia Shijak
80	Bashkia Shkodër
81	Bashkia Skrapar
82	Bashkia Tepelenë
83	Bashkia Vau i Dejës
84	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik
85	Prefektura e Qarkut Fier
86	Prefektura e Qarkut Shkodër
87	Prefektura e Qarkut, Korçë
88	Prefektura e Qarkut Vlorë
89	Tematik: Berat, Skrapar, Librazhd, Krujë
	Departamenti i Auditimit të Performancës
90	Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlore, Gjirokastër
91	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonal rurale, përmes përfshirjes ne tregun e punës
92	Efektiviteti dhe siguria e barnave që qarkullojnë në Shqipëri
93	Efektiviteti i Pajisjeve mjekësore ne sistemin spitalor publik
94	Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)
95	Politikat dhe respektimi i te drejtave te personave me probleme te shëndetit mendor ne shërbimin spitalor psikiatrik
96	Procesi i Birësimit të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirërritje dhe edukim
97	Respektimi i Standardeve ne Menaxhimin e Mbetjeve Urbane, Sfide e Qëndrueshme ne zvogëlimin e ndotjes se mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit te popullsisë
98	Respektimi i Standardeve ne Trajtimin dhe Eliminimin e Mbetjeve Spitalore, ne parandalimin e rrezikut per shëndetin e personelit shëndetësor, pacienteve dhe mbrojtjen e mjedisit

Aneksi c- Përmbledhja e dëmit ekonomik dhe efekteve financiare negative, për buxhetin 2023

Në mijë lekë

Dëmi ekonomik	Viti 2023
Shpenzime	**104,374**
Shpenzime operative	3,069
Shpenzime të Tjera	14,966
Zbatim punimesh / investime	86,338
Të Ardhura	**16,935**
Te ardhura nga administrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palët e treta	-
Te Ardhura nga aktiviteti tatimor dhe doganor	-
Te Ardhura të Tjera	-
Të ardhurat nga sektori i tatimeve në qeverisjen lokale	16,935
Gjithsej të ardhura të munguara, për vitin 2023	**121,309**

Në mijë lekë

Efekte negative në buxhetin e shtetit	Viti 2023
Shpenzime	**3,339,276**
Shpenzime operative	1,206,478
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	30,785
Shpenzime të Tjera	651,235[12]
Shpenzime për investime	1,450,777
Të Ardhura	**1,866,121**
Te ardhura nga keq administrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palët e treta	571,639
Te Ardhura të Tjera	142, 906[13]
Të ardhurat nga sektori i tatimeve në qeverisjen lokale	1,151,575
Gjithsej efekte ne zbatim të buxhetit të shtetit, viti 2023	**5,205,396**

[12] Në këtë zë janë përfshirë shpenzime gjyqesore/mbrojtje ligjore per proceset gjyqesore ne Gjykaten Nderkombetare te Arbitrazhit/GJEDNJ, si dhe likujdime pë vendime gjyqësore për punonjës të larguar nga puna

[13] Në këtë zë janë përfshirë të ardhura si pasojë e mosarkëtimit të gjobave/penaliteteve si dhe mangësi të konstatuara në aktivitetin kontrollues tatimor me ndikim negative në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore dhe doganore

www.klsh.org.al

+355 4 2247294

klsh@klsh.org.al

“Abdi Toptani", Tiranë